



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:081233

Datë: 03.11.2023

Numri i dokumentit: 04871717

PS.nr.42/23,

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Violeta Namani-Hajra –kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Suzana Çerkini dhe Vesel Ismajli si anëtarë të trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Rilinda Kadriu, në çështjen penale kundër të pandehurve I.A., K.K., B.B., R.T., T.C., N.K. dhe Xh.R., për shkak se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.53/2013, të datës 17.05.2014, të ri cilësuar me datë 06.10.2022 në fjalën përfundimtare nga Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 17.10.2023, në prezencën e palëve në procedurë gjykata me datë 20.10.2023, mori dhe shpalli publikisht dhe përpiloi me datë **25.10.2023** këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1.I.A., nga babai N. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë K., i lindur me datë ... në fshatin ..., Sh., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin juridik, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R. së M.

2.K. K., nga babai I. dhe nëna R., mbiemri i vajzërisë A., i lindur me datë ... në fshatin ..., Sh., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin drejtim administratë publike, i punësuar në kompani private, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R. së M.

3.B.B., me nofkën "...", nga babai Q. dhe nëna M., mbiemri i vajzërisë K., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e K., me vendbanim në rrugën “...” p.nr. në ..., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, shofer në kompaninë “...”, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R.së Kosovës.

4.R.T., me nofkën "...", nga babai B. dhe nëna F., mbiemri i vajzërisë D., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e H. E., me vendbanim në rrugën “...”, pn. në H. E., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal të letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i R.së Kosovës.

5.T.C., nga babai Sh. dhe nëna N., mbiemri i vajzërisë L., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e H.në E., ku edhe jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal të letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

6.N.K., nga babai Sh. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë V., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna H. E., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

I. Të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K.,

Në bazë nenit 363 par.1 nen par. 1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Ne periudhën kohore prej vitit 2011 deri me 23.12.2013, të pandehurit e lartcekur se bashku edhe me të pandehurit Q. K. dhe B. R. të cilët gjenden në arrati, me qëllim që vetes apo personit tjetër ti mundësojnë shmangien nga pagesa e tarifave doganore apo tarifave të tjera ose detyrime ve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, në periudhën kohore në fjale, duke kontrabanduar mallin e cekur në pikën I. të dispozitivit si *“pas marrëveshjes paraprake në bashkëkryerje janë marrë me kontrabandimin e mallrave duke kaluar vijën kufitare në mes M. dhe K. dhe anasjelltas e duke shmangur kontrollin doganor, ashtu që në mënyrë të vazhdueshme kane bartur mallra dhe atë veshmbathje dhe duhan, ndërsa për eksportim dhe importim të duhanit dhe cigareve sipas ligjit kërkohet leje e posaçme”*, me rastin e kontrabandimit të mallit kane bërë Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore në vlerë prej rreth **112,915.64 Euro,-**

-Me këtë në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishin për të kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

-Pasi që nuk është provuar se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIMI

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë PPS.nr.53/2013, me datë 17.05.2014, kundër të pandehurve I.A. dhe K.K. për shkak të veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KPRK-së lidhur me veprat penale nënpikën I (h) Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nënpikën I (i) Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurve I.A. dhe K.K. në bashkëkryerje kanë kryer edhe tri vepra penale Dhënia e

ryshfetit nga neni 429 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të përshkruara si në pikën I (c) dhe I (e) dhe I (g) të dispozitivit të kësaj aktakuze, kundër të pandehurve H. K., B. S. dhe S. B. kanë kryer veprat penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprat penale Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1 i KPRK-së, dhe veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK-së, të përshkruar në pikat I(a), I(b), I(d), I(f), të dispozitivit të kësaj aktakuze, kundër të pandehurve B.B., R.T., T.C., N.K. dhe Xh.R. për shkak të veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK-së, lidhur me veprat penale nën pikën I (h), Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nën pikën I (i) Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurit B.B. në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e përshkruar nën pikën 1(c) të dispozitivit të kësaj aktakuze, kundër të pandehurve N.G., G. Sh., A. K., në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurve N. G., G. Sh., A. K., Rr. L., J. L. dhe I. L. për shkak të veprës penale: Shmangia nga tatimi nga neni 313 par.1 i KPRK-së, kundër të pandehurve N. L. dhe I. A. kanë kryer veprën penale të kryer veç e veç Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par 1 i KPRK-së, kundër të pandehurve B. G. dhe B. G. për shkak se në bashkëryerje kanë kryer veprën penale: Shmangia nga tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së, kundër të pandehurve K.K. dhe T.C. për shkak të veprës penale të kryer veç e veç: Kalim i paautorizuar i vendkalimit kufitar ose vijës kufitare në vazhdim nga neni 146 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 81 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 24.07.2014, i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, i ka udhëzuar të njëjtët në vështrim të nenit 248, mbi të drejtën e deklarimit ose jo të pranimit të fajësisë. Të pandehurit I.A., K.K., H. K., B.S., S.B., B.B., R.T., T.C., N.K., K.K., Xh.R., N.G., G.Sh., A.K., Rr.LL, J.L., N.L., I.L., I.A., B.G. dhe B.G., se cili veç e veç kanë deklaruar se aktakuzën e kanë kuptuar në tërësi, dhe e kanë mohuar fajësinë për kryerjen e veprës penale që i ngarkon kjo aktakuzë.

Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit të dytë më datë 17.09.2014, për elaborimin e kërkesave për hedheje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave të paraqitura nga mbrojtja e të pandehurve I.A., K.K., H.K., B.S., S.B., B.B., R.T., T.C., N.K., K.K., Xh.R., N.G., G.Sh., A.K., Rr.L., J.L., N. L. dhe I.A., ku është marr edhe përgjigja e Prokurores së Prokurorisë Speciale, të njëjtën seancë të pandehurit B.G., B.G. dhe I. L. e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, andaj sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.275/2017, të datës 22.09.2014, është veçuar procedura penale ndaj të pandehurve B.G., B.G. dhe I. L.

Më datë 22.09.2014, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, mori Aktvendimin PKR.nr.275/2014, me të cilin refuzoi si të pabazuar Kërkesat për hedhje të Aktakuzës dhe Kundërshtimin ndaj Provave, të parashtruar nga Mbrojtësit e të pandehurve I.A., K.K., H.K., B.S., S.B., B.B., R.T., T.C., N.K., K.K., Xh.R., N.G., G.Sh., A.K., Rr.L., J.L., N.L. dhe I.A.

Me datë 30.09.2014, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, mori Aktvendim PN.1.nr.1904/14, ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtësit të pandehurit H.

K., të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Krime të Rënda, PKR. nr.275/14, të datës 22.09.2014, me datë 09.10.2014, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, mori Aktvendim PN.1.nr.1956/14, ku ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtësit të pandehurit T.C., të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentin për Krime të Rënda, PKR. nr.275/14, të datës 22.09.2014, me datë 30.10.2014, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, mori Aktvendim PN.1.nr.2117/14, ku ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtësit të pandehurit K.K., të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentin për Krime të Rënda, PKR. nr.275/14, të datës 22.09.2014, me datë 30.10.2014, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, mori Aktvendim PN.nr.526/14, ku ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtëseve të pandehurve H.K., R.T., K.K., I.A., N.G., Rr.L., G.Sh., S.B., A.K. dhe T.C., të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentin për Krime të Rënda, PKR. nr.275/14, të datës 22.09.2014.

Sipas Aktvendimit të Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PKR.nr.275/14, i datës 05.11.2021, kundër të akuzuarve K.K. dhe T.C., hudhet pjesërisht aktakuza për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare në vazhdim nga neni 146 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale që shkakton përjashtimin e ndjekjes penale, si dhe kundër të pandehurve N.G., G.Sh., A.K., Rr.L., dhe J.L. hudhet pjesërisht aktakuza për veprën penale të kryer veç e veç Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.1 i KPRK-së, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale që shkakton përjashtimin e ndjekjes penale.

Gjykata, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 18.01.2022, i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre ligjore, ku palët heqin dorë për leximin e aktakuzës nga prokurori i Prokurorisë Speciale, të pandehurit I.A., K.K., H.K., B.S., S.B., B.B., R.T., T.C., N.K., K.K., Xh.R., N.G., G.Sh., A.K., N. L. dhe I.A., nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, dhe meqenëse të pandehurit e lartcekur nuk e kanë pranuar fajësinë për këto vepra penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Gjykata ka vazhduar me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.04.2022, nuk ka qenë prezent i pandehuri K.K., mbrojtësja e tij av. S. M. e ka njoftuar gjykatën se i mbrojturi im ka probleme shëndetësore, si dëshmi ka bashkangjitur edhe dokumentacioni mjekësor, ku trupi gjykues pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave, me pajtimin e palëve në procedurë mori Aktvendimin PKR.nr.275/14, të datës 19.04.2022, për veçimin e procedurës penale ndaj të pandehurit K. K., me qëllim të efikasitetit dhe të mos prolongohet me tutje kjo çështje penale.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special me datë 08.11.2022, mori Aktgjykim me PKR.nr.275/14, për të pandehurit I.A., K.K., H.K., B.S., S.B., B.B., R.T., T.C., N.K., Xh.R., N.G., G.Sh., A.K., N. L. dhe I.A., për veprat penale për të cilat ngarkohen me aktakuzë.

Kjo çështje penale është proceduar sipas Aktgjykimi të gjykatës së Apelit APS.nr 12/23 të datës 31.07.2023, gjykata, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 17.10.2023, i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre ligjore, ku palët heqin dorë për leximin e aktakuzës nga prokurori i Prokurorisë Speciale, të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C., N.K., nuk e kanë pranuar fajësinë se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe meqenëse të pandehurit e lartcekur nuk e kanë pranuar fajësinë për këtë

vepër penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 325 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Gjykata ka vazhduar me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me datë 17.10.2023, nuk ka qenë prezent i pandehuri Xh.R., sipas të dhënave të siguruar nga stacioni policor në Gj., familjarët e tij e njoftojnë policin se i pandehuri Xh. jeton dhe punon në F., ku trupi gjykues pas analizimit dhe vlerësimit të njoftimit, me pajtimin e palëve në procedurë mori Aktvendimin PS.nr.42/23, të datës 17.10.2023, për veçimin e procedurës penale ndaj të pandehurit Xh.R., me qëllim të efikasitetit dhe të mos prolongohet me tutje kjo çështje penale.

Prokurori i Prokurorisë Speciale në fjalën përfundimtare deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, ku janë dëgjuar dëshmitarët, është bërë administrimi i provave materiale të siguruara me urdhër të Gjykatës, me aplikimin e masave të fshehta të vëzhgimit e të hetimit-përgjim i telekomunikimeve, fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, ekspertizës financiare, të gjitha prova të pranueshme të siguruara konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale si dhe është paraqitur mbrojtja nga ana e të pandehurve dhe mbrojtjen e kanë dhënë të akuzuarit: H.K., B.S., S. B., R.T. dhe Xh.R., kurse të akuzuarit: I.A., K.K., B.B., T.C., N.K., N.G., G.Sh., A.K., N. L. dhe I.A., pas konsultimit me mbrojtësit e tyre të autorizuar apo të angazhuar sipas detyrës zyrtare, kanë deklaruar se e shfrytëzojnë të drejtën e mbrojtjes në heshtje. Pas administrimit të provave dhe analizimit të tyre kam ardhë në përfundim se në këtë çështje penale nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KPRK-se, për arsye se nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale siq janë, ekzistimi i hierarkisë, ekzistimi i zingjirit të udhëheqjes me pushtet të udhëheqësit të grupit veçori-karakteristike këto që kanë grupet e krimit të organizuar, por është vërtetuar se të pandehurit veprën e kanë kryer në bashkëkryerje dhe vazhdimësie e disa prej tyre secili veç e veç. Andaj do të bëhet rikualifikimi i veprave penale të cilat ju vihen në barrë të akuzuarve në bazë të veprimeve të tyre si në vijim: Të pandehurit: I.A., K.K., B.B., R.T., T.C., K.K., N.K. dhe Xh.R., të përshkruar rrethanat si në dispozitiv I.(a) të aktakuzës të ndryshuar, me këtë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, të pandehurit e lartcekur të përshkruar rrethanat si në dispozitiv I.(b) të aktakuzës, me këtë në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se. Të pandehurit I.A., K.K. dhe B.B., të përshkruar rrethanat si në dispozitiv II. të aktakuzës, me këtë të pandehurit I.A. dhe K.K. në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, ndërsa i pandehuri B.B., në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I pandehuri H.K., të përshkruar rrethanat si në dispozitiv III. të aktakuzës, me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-se në bashkim real me veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK-së. I pandehuri B.S. të përshkruar rrethanat si në dispozitiv IV. të aktakuzës, me këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-se në bashkim real me veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK-së. I pandehuri S. B. të përshkruar rrethanat si në dispozitiv V. të aktakuzës, me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-se në bashkim real me veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK-së. I pandehuri N.G. të përshkruar rrethanat si në dispozitiv VI.(a) dhe (b) të aktakuzës, me këtë ka kryer veprën penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së si dhe veprën penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-se. I pandehuri G.Sh. të përshkruar rrethanat si në

dispozitiv VII.(a) dhe (b) të aktakuzës, me këtë ka kryer veprën penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së si dhe veprën penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par 1 të KPRK-së. I pandehuri A.K. të përshkruar rrethanat si në dispozitiv VIII.(a) dhe (b) të aktakuzës, me këtë ka kryer veprën penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së si dhe veprën penale Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par 1 të KPRK-së. I pandehuri N.L. të përshkruar rrethanat si në dispozitiv IX. të aktakuzës, me këtë ka kryer veprën penale Shmangje nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. I pandehuri I.A. të përshkruar rrethanat si në dispozitiv X. të aktakuzës, me këtë ka kryer veprën penale Shmangje nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Edhe pse të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor në mbrojtjen e tyre nuk e pranojnë fajësinë apo e shfrytëzojnë të drejtën e mbrojtjes në heshtje, nga provat te cilat i janë bashkangjitur aktakuzës vërtetohet përtej dyshimit te bazuar mire se të akuzuarit i kane kryer veprat penale si në aktakuzën e përmirësuar sa i përket kualifikimit juridik të veprave penale. I akuzuari H.K., në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor e mohon në tërësi kryerjen e veprës penale duke deklaruar se puna e tij në Policinë e Kosovës është vlerësuar dhe është shpërblyer me mirënjohje të shumta si polic i dalluar. I akuzuari deklaroi se personat I.A. dhe Q. K., i njeh se ata jetojnë afer kufirit dhe qe e kalojnë kufirin çdo dite kurse B.B. e njeh se e ka fqinj është mik i familjes dhe është rritur me të. Nuk e mohon se ka pasur kontakte telefonike me te akuzuarin B.B. dhe shumicën e rasteve në interes te shërbimit pasi na ka dhënë informata të dobishme. Lidhur me veprën penale që i vihet në barrë e mohon se e ka vene në lajthim kolegun H. B., me rastin e intervistimit të personave I.A. dhe Q.K., në cilësi të dëshmitareve e mohon te ketë pranuar para apo ndonjë dhurate nga të akuzuarit ne këtë rast. Kësaj mbrojtje nuk duhet falur besimin pasi bie në kundërshtim me provat e administruara, dëshminë e dëshmitarit H. B. dhe provat e siguruara me urdhër të gjykatës pas zbatimit të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit – përgjimi ligjor dhe nga transkriptat e këtyre përgjimeve telefonike vërtetohet gjendja faktike. Edhe pse nga Prokuroria Themelore në F. ishte bërë kërkesë për sigurim të dëshmive për rastet që ishin hapur ndaj NN personave për shkak të dyshimit se janë të përfshirë në kryerje të veprës penale Kontrabandim i mallrave por pa dhënë ndonjë urdhër, se në çfarë cilësie duhet të dëgjohen personat e caktuar, pas njoftimit nga ana e tij përmes të pandehurit B.B.t që të pandehurit I.A. dhe Q. K. të lajmërohen në ora 18:00 në piken kufitare Kosove – Maqedoni, se kane për tu intervistuar, dëshmitari H. B. ka deklaruar në dëshminë e tij te datës 23.01.2014 se i pandehuri para se të filloj intervistimi se bashku me H. B. i ka thënë se këta persona I.A. dhe Q.K. “është urdhër gojor i prokurorit kujdestar në Prokurorin Themelore në F. se këta duhet të intervistohen në cilësi të dëshmitarit”, duke e vënë në lajthim kolegun e tij. Prokuroria Themelore në Ferzaj, Prokurori qe ka qene kujdestar me datën 01.11.2013, në Njoftimin e datës 12.03.2014 për Prokurorinë Speciale, në mënyrë të qarte e ka mohuar se si prokuror të japin urdhër që personat e dyshuar të intervistohen në cilësi të dëshmitarëve e aq me pak të intervistohen si dëshmitarë ata qe janë të dyshuar për Kontrabandim me mallra. I akuzuari i mohon se ka pranuar ndonjë dhurate nga të akuzuarit por kjo mbrojtje bie në kundërshtim me provat e administruara. Me datën 01.11.2013 pas intervistës me I.A. dhe Q.K., i pandehuri H.K. derisa në një lokal ishte se bashku me H.B., aty kishte shkuar edhe i akuzuari B.B. por H.B. ka kërkuar qe ky person mos të ulet se bashku me ta pasi njeh si person i dyshuar. Se i akuzuari ka kërkuar shpërbllim për intervistimin e I.A. dhe Q.K. në cilësi të dëshmitareve vërtetohet nga bisedat qe ka zhvilluar i pandehuri B.B. me të pandehurin I.A. me datën 02.11.2013, do të thotë të nesërmen e intervistës, dhe biseda ka këtë përmbajtje “b:...kesh te ai shoqi (qe i referohet H.K.) um thirrri qysh um ka thirr ma herët po shkova, I.: jo bre çka tha , B.: edhe um tha për at shoqin, për vete tha kurgjo hiq me qeta a për at shoqin me ma neru diqka, I.: po sa a e sjelli hiq a jo, B.: e sjelli kallxoj vet I.: sa B.: po ishin do telefona qasi Samsunga S3 a xa po din ka 170-180 euro tha e merr njeri, I.: hajt se ja qoj nuk është problem.hajt se foli i kallxoj edhe Q.it (Q.K.t)”. Nga biseda e datës 14.12.2013 në mes të pandehurve B.B. dhe I.A., B. e njofton I.n se “është duke shkuar dikun me

shoqin (H.K.) dhe I. i thotë, se nëse ske para të merr dikun tja qet naj dreke, paret i merr prej neve “. Ne bisedën e datës 16.12.2013 në ora 23:54:59, në mes të B.B.t dhe I.A.t, B. e njofton I.n se “ ai shoki HK e sillke do kundra të mira sum dalin paret me i ble janë shtrejt, me shku në Prishtinë, I. qfare o daje, B.: ku e di 70-80 euro a sdi sa ishin q... nenën po thojke shkojna bashk a din se thojke janë deri në 140 euro, I: ani de shko kur të asi ska problem hajt, B.: qka thu a me shku me to a , I. : po more po hajt pra”. Nga transkripta e përgjimit ligjor e datës 18.12.2013 në ora 10:35:00 në mes të B.B.t dhe të pandehurit H.K. i cili perdor numrin e telefonit 045/692-087, zhvillohet kjo bisede” B.: u je o kush, H.: qe qka ka të re., B.: jo veq të thirra a shkojna ka Prishtina, H.: , pse , B.: për qef i marrmi ka nipar qizme qato, H.: ku te ato gugjarta, B.: ha, H.: ani bre shkojmë po a ki pune a qka ki me ba, B.: jo se sot pushim ska kurgjo, H.: ok nhajt hajde e pim një kafe këtu masandej shkojna”, i pandehuri H. në këtë rast nuk e refuzon premtimin e dhuratës. I pandehuri nuk e mohon se B.B. ja ka blere disa libra në Prishtinë në shumë prej 37 euro sipas tij dhe se një familjar i I.A. , ja ka paguar kablllovakun në Shkup por thot se për këto i ka paguar paratë, por nga bisedat në mes të pandehurit B.B. dhe I.A., dëshmohet se ai i ka marr paret për këto pagesa për H.K.n. I akuzuari në mbrojtjen e tij thotë se ndoshta B.B. ka përfituar për veti në emër të tij prej të akuzuarve I.A., K.K., Q. K. etj. dhe i pyetur a ka kërkuar ndonjëherë sqarim nga i akuzuari B.B. se pse në emër të tij ka kërkuar diçka nga të tjerët pa qene në dijeni, i akuzuari është përgjigjur “nuk kam kërkuar asnjëherë sqarim dhe nuk kam raporte shoqërore vetëm sa përshëndetemi”. Të gjitha këto janë dëshmi qe vërtetojnë se i akuzuari H.K., ka pranuar dhurata për shërbimet qe ju ka bere të akuzuarve përndryshe ai do të kërkonte llogari se pse B.B., ka thënë se i ka dhënë dhurata e ai si ka pranuar, andaj nuk duhet falur besimin mbrojtjes se tij pasi nga këto që u cekën vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barre në aktakuzë. Në shqyrtim gjyqësor e ka dhënë mbrojtjen e tij i akuzuari B.S., i cili e ka mohuar veprën penale e cila i vihet në barrë, duke deklaruar se në punën e tij 20 vjeçare sa ka punuar në Policinë e Kosovës asnjëherë asnjë kafe nuk e ka pire nga dikush që do ta dëmtonte imazhin e policisë. Nuk duhet falur besimin mbrojtjes se të akuzuarit B.S., pasi është përpjekje për t'i ikur përgjegjësisë penale, i akuzuari nuk e mohon se e ka përdorur numrin e telefonit 045/528-945, dhe i pyetur a njeh të akuzuarin K.K. dhe a keni biseduar me të apo këmbyer sms me datën 29.11.2013, nuk e mohon këtë fakt dhe pasi i prezantohen bisedat e transkriptove të përgjimit ligjor sms e këmbyer mes tij dhe të akuzuarit K.K. me datën 29.11.2013 prej orës: 00:04:46 deri 01:47:06 gjithsej 11 sms të cekur edhe në dispozitivin dhe arsyetimin e aktakuzës, i akuzuari edhe tani si edhe më parë deklaroi se, K.K. jeton afër zonës kufitare dhe se ai kinse i ka thënë “se a mundet me dalë me do shoke në pjesën e M. me bo grill” dhe i kam thënë “po mundesh me kalu se kurgjo nuk na ka dëmton” mirëpo kësaj mbrojtje gjykata nuk duhet falë besimin për më tepër kur nga Sms- i këmbyer në ora 00:32:10 “ata tuten me ardh dil nalt me kon je “ dhe sms i orës 00:39:13 “ato nuk vin tu kon aty kerri dil dikun tjetër se tuten dil nalt kallxom”, këta sms tregojnë qëllimin e vërtetë të bisedës se nuk ka pas të bej asgjë me dalje për grill, pas mesit të natës, kur asnjëherë me parë nuk ka pas një kërkesë të tillë, por e vërteta është se në atë kohe ishin në pritje kontrabanduesit e mallit që do të kalonin kufirin në atë zone dhe i akuzuari K.K. kërkonte nga i akuzuari B. që të largohej nga ai vend dhe kontrabanduesit në mesin e tyre T.C. (nga bisedat e përgjimeve) të kalonin me mall, dhe për këto shërbime ai pas disa ditësh respektivisht me datën 17.12.2013 pranon nga K.K. dhe I.A. shumen prej 50euro. I akuzuari ka pasur edhe biseda të tjera ku kërkon “ndonjë kafe” prej të akuzuarit K.K. siç vërtetohet nga biseda e datës 14.12.2013, e orës 20:09:38 ku bisedojnë që B. thot “nashta na kishe qit dikun naj kafe a ta kisha qit” por kjo “naj kafe” është veten në mënyrë figurative se në këtë mënyrë ai e njofton se është në punë dhe K. i thot “nashta bahet najsen ma vone” pra do të mund të vepronin me kontrabande të mallrave pasi B. është në ndërrim. Andaj nga këto dëshmi pa mëdyshje vërtetohet se i akuzuari B.S. ka keqpërdorur detyrën e tij në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës dhe në veprimet e tij manifestohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. I pandehuri S. B. në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor e ka mohuar kryerjen e veprës penale e

cila i vihet në barrë, ai deklaroi se ka punuar në polici nga viti 2000 dhe për 14 vite ka punuar në qytet në polici të rendit me zyre në E. H., asnjëherë nuk ka punuar në dogan dhe as në Polici kufitare, e mohon se ka kërkuar para nga të akuzuarit K.K. dhe I.A. por nuk e mohon faktin se ka kërkuar para 20 euro nga S. D. por ja ka kthyer vet. Kësaj mbrojtje gjykata nuk duhet falur besimin pasi nga provat e administruara transkriptet e bisedave të përgjimit ligjor të datës 10.12.2013, në ora 20:23:06 kur S.i bisedon e K.K. dhe kërkon prej tij që ti thot S. D. tja jap 20 euro që i kishin thënë me heret. Nga biseda e zhvilluar në mes të K.K.t dhe S. D., K. i thot “ jepja 20 euro, ti jap me vone” dëshmitari S. i thot “ ku je K. se skam veq parat e bukës pasha zotin” K. i thotë “jam në E. H., qe ti bi qetash”. Ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.05.2015, dëshmitari S. D., pas ballafaqimit me deklaratën e tij të dhënë me parë e pranon se “te njëjtën dite K. mi ka kthye 20 euro që ja dhashë S.”.Edhe nga transkripta e bisedave të përgjimit ligjor në mes të pandehurve I.A. që përdor telefonin 044/299-619 dhe K.K. që përdor telefonin 044... e datës 14.11.2013 ne ora 19:53:53 ata bisedojnë dhenien e parave te akuzuarit S. B. dhe biseda është si në vijin: “ I.: a tu lajmru S., K.; kush, I.; S., K.; jo more sja qela hiq, I.; e pomire kur i ke dhëne masmrami bre, K.; po kur këna punu o burr si kom dhan mo, I.; epo mire jepja 20 euro, jepja se gjith ditën me lloj lloj numri (nuk kuptohet biseda) , jepja se nesër prama pasnesër prama thuj “mos na nguc, mos na nguc nja 3-4 dite, ose thuaj “qe nja 20 euro, nja një jave o kush mos na nguc se s’jena tu punu, sa tu pas pune”, edhe nga kjo bisede dëshmohet se i akuzuari S. B. ka qene në dijeni se të akuzuarit I.A. dhe K.K. janë kontrabandues të mallit pasi me parë i kishte zënë duke kontrabanduar mall njërin në B. dhe tjetrin te “Uji i tharte”, përkundër kësaj ai nga të njëjtit ka kërkuar para ose ka kërkuar qe tja paguajnë paratë qe ai i ka marr nga të tjeret, siq ka vepruar me paratë e marra nga dëshmitari S. D. Andaj në veprimet e tij manifestohen elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë në aktakauze. I akuzuari R.T. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor e mohon veprën penale e cila i vihet në barre duke deklaruar se ai është marre me tregti e ka pasur një lokal të të pijeve me shumice dhe pakice , por ka mundur të shes edhe mallra tjera. I pyetur se a i njeh të akuzuarit tjerë Q.K. që gjendet në arrati, I.A., K.K., K.K., B.B. etj. deklaroi se shumicën i njeh nga shkolla pasi qe ane gjenerata e përafërta dhe i kam njohur, dhe i pyetur a e din se me çka janë marre të akuzuarit tjerë në ketë rast dhe a ka zhvilluar ndonjëherë ndonjë biznes apo ka bashkëpunuar me ta, i akuzuari deklaroi se këta persona nuk ka njohuri se me çka merren, ata kane ardhur në lokalin e tij, kane marre pije dhe kane shkuar, nuk ka pasur kurrfarë bashkëpunimi me ta , nuk ka pranuar mall të tyre në depon e tij, dhe nuk kane lëne mall në depon e tij, e pranon se ka pasur automjetin e markës “Mercedes” me targa ... dhe se B.B. e njeh si taksist dhe shpesh e ka thirr për të dërguar nënën e tij te mjeku e nuk i kujtohet ta ketë dërguar B.B. që me automjetin e tij me marr mall në F. K. Kësaj mbrojtje të akuzuarit nuk duhet fal besimin pasi është përpjekje për tui shmangur përgjegjësisë se vet penale edhe bashkëveprimin me të tjerët. Nga provat e propozuara e që janë administruar në shqyrtim gjyqësor e sidomos nga raportet e përgjimeve ligjore të zbatuara me urdhër të gjykatës, nga transkriptet e bisedave në mes tij dhe të akuzuarve K.K., I.A., B.B., N.K. etj, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari R.T. e ka ditur fare mire se me çfarë veprimtarie merren të akuzuarit tjerë K.K., I.A. etj. ai ka bashkëvepruar me ta, lokali i tij shume shpesh ka shërbyer si vend ku sillet malli i kontrabanduar nga M. në drejtim të K. e pastaj është shpërndarë, ose malli që është grumbulluar që të kontrabandohet në M., ai shpesh ka bartur mall të kontrabanduar, ka dhënë automjetin e tij për të bartur këto mallra, ai ka percjellur të akuzuarit tjerë gjatë rrugës qe ti informoj se ku janë të stacionuar apo ku lëvizin veturat e policisë, që të akuzuarit tjerë që ishin në lëvizje me mallra të kontrabanduara të mos ndalen nga ana e policisë. Te akuzuarit tjerë të njëjtit në të shumtën e rasteve i janë drejtuar me “R.”, duke cekur “qoje te R. leje te R., a i more te R., etj”. Nga transkriptet e përgjimeve ligjore të datave 06.12.2013, 20.12.2013, 21.12.2013, R.- Q., 11.12.2013, K.K.- R., 20.12.2013, 21.12.2013, 14.12.2013 I.A. – R., 08.10.2013, 12.12.2013, 14.12.2013, janë këto vetëm disa prej shume transkripteve që e vërtetojnë pa mëdyshje se i akuzuari R. T. ka bashkëvepruar me të akuzuarit tjerë në kryerje të veprës

penale e cila i vihet në barrë andaj ne veprimet e tij manifestohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. I akuzuari Xh.R., e ka dhënë mbrojtjen në shqyrtimin gjyqësorë ku e ka mohuar kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barre dhe i pyetur se me të akuzuarit tjerë a keni pasur ndonjë biznes i njëjti është përgjigjur jo asnjëherë nuk kam pasur biznes unë vetëm njëherë kam qene në K. dhe nuk kam pasur të bej asgjë me ta dhe nuk e kam njohur asnjërin prej tyre para se të filloj ky proces dhe kurrë nuk i kam parë. I akuzuari nuk e mohon se në Gj. e ka shtëpinë se bashku me oborr e cila është e rrethuar dhe janë afër me shtëpinë e vëllait të tij. Ai deklaron se nuk ka pasur informate se personi B.R. të cilin e ka kushëri të ketë mund të leje diçka në oborrin e tij pa dijeninë e tij, ai kurrë nuk ka biseduar me të akuzuarit tjerë dhe nuk i ka njohur, por kjo përgjigje e tij bie në kundërshtim me provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor të propozuara nga prokuroria. I akuzuari e pranon faktin se e ka pasur në përdorim telefonin me numër ..., dhe nga provat e siguruara me zbatimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit- përgjim i telekomunikimeve vërtetohet se i akuzuari Xh.R., me datën 21.12.2013 ne ora 22:43:52 ka pasur bisede telefonike me telefonin e tij numër ... me te akuzuarin K.K. i cili ka përdor numrin ... dhe biseda ka kete përmbajtje “Xh., alo, K., aga Xh. a je në shpi, Xh., po, K., hej, Xh., ha, K., jena tu ardh dhe asi, Xh., ha, K., ngo njani qe vjen i pari, Xh. aha, K., mos te marri vesh se çka kom unë, Xh. , u kry, K., hajt veq shkarkoj edhe ec hajt, Xh., hajde u kry, K., masanej vi unë, Xh., hajde tung”. Nga kjo bisede e cila bie në kundërshtim me mbrojtjen e të akuzuarit Xh.R., vërtetohet se i akuzuari Xh. e ka njohur shume mire të akuzuarin K.K. i cili e quan “aga Xh.”, dhe ka bashkëvepruar me të. Nga Raporti i vëzhgimit i datës 18.12.2013 i kryer me urdhër te gjykatës PPR.kr.204/13 i datës 15.11.2013, është filluar vëzhgimi ku te dyshuarit K.K., I.A., K.K. kane dërguar një sasi të mallit në Gj. e që ka qenë duhan ka shkuar në dy vende, në njërin vend është në rrugën “...” nr.46, në pronësi të Xh.R., dhe fotografitë qe janë bashkangjitur dëshmohet se malli është shkarkuar në pronën e të akuzuarit Xh.R.. Nga këto prova dëshmohet se i akuzuari Xh.R. ka bashkëvepruar me te akuzuarit tjerë dhe në veprimet e tij formësohen elementet e veprës penale e cila i vihet në barre. Të akuzuarit I.A., K.K., B.B., T. C., N.K., N.G., G.Sh., A.K., N. L., dhe I.A., pas konsultimit me mbrojtësit e tyre e kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore të mbrojtjes në heshtje. Të akuzuarit I.A., K.K., B.B., T. C., N.K., edhe pse janë mbrojtur në heshtje nga provat e propozuara për administrim në shqyrtim gjyqësor vërtetohet fajësia e tyre. Gjatë fazës se hetimeve me kërkesë të prokurorisë e me urdhër të gjykatës janë zbatuar masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit- Përgjimi i telekomunikimeve përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike. I akuzuari I.A. ka pasur në përdorim telefonin me numër ..., K.K. ka pasur në përdorim telefonin me numër ..., B.B. ka pasur në përdorim telefonin me numër ..., T. C. ka pasur në përdorim telefonin me numër ..., N.K. ka pasur në përdorim telefonin me numër ..., kane pasur edhe numra të tjerë të telefonit në përdorim. Këta numra të telefonit iu kane nënshtruar masave te fshehta të përgjimit ligjor dhe me raportet e përgjimeve ligjore nga data 02.10.2013 deri me raportin sipas urdhëresë 15.11.2013 që përfshin periudhën nga 01.12.2013-23.12.2013, të cilat i janë dorëzuar gjykatës si prova për administrim nga transkriptet e panumërta të cilat u janë bashkangjitur këtyre raporteve të akuzuarit bisedojnë për kontrabandim të mallrave duke përfshirë edhe mallra për qarkullimin e të cilave kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente- Dogana e Kosovës, e në shumë nga këto transkripte vërtetohet se të akuzuarit kane kontrabanduar duhan dhe cigare, destinimi final i të cilave ka qene besohet kontrabandimi jashtë Kosovës si në Serbi e gjetiu. Vetëm në Raportin e fundit të datës 29.01.2014,që i referohet përgjimit të telefonit të akuzuarit K.K. ,numrit ..., janë përfshirë mese 420 transkripte në të cilat ne detaje përshkruhen veprimet e ndërmarra nga të akuzuarit në mes vete e pothuaj të gjitha kane të bëjnë me veprime rreth kontrabandimit të mallit.Edhe nga Raportet e vëzhgimit të datës 02.12.2013 dhe datë 30.12.2013 vërtetohen veprimet e të akuzuarve kur K.K. ka dërguar mall në Gj., pastaj me datën 23.12.2013 kane shkuar në Gj. për të dërguar mall duhan, fotografia e të pandehurit K.K. në stacionin e autobusëve në Prishtine kur është zënë duke dorëzuar 250 kg duhan nga vetura e tij në autobusin

me targa të N. P. Edhe nga raportet e kontrollit nga ana e Doganës dhe Administratës së Kosovës kur me datën 23.12.2013 janë sekuestruar mallra në firmat e të pandehurve të përfshirë në aktakuzë e të cilët mallra janë kontrabanduar nga këta të akuzuar. Në baze të transkriptave respektivisht bisedave në mes të akuzuarve dëshmohet sasia e mallit të kontrabanduar të cekur si në aktakuzë. I akuzuari N.G., edhe pse i njëjti ka kontrabanduar mallra, nuk ka prova se ka kontrabanduar mallra eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar i kufizuar apo kërkohet leje të posaçme nga organi kompetent andaj në rastin e tij kualifikimi behet sipas nenit 317 par.1 të KPRK-se, për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, e duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprës penale me datën 23.12.2013, kur është bërë kontrolli në firmën e tij rezulton se për këtë veprë ka parashkrim të veprës penale. Edhe për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 të KPRK-së, duke pasur parasysh se në bazë të ekspertizës financiare e datës 21.12.2015, e kryer me Urdhër të gjykatës, vlera e mallit të kontrabanduar është vlerësuar në shumë 9,407.00Euro dhe vlera e pagesës se shmangur nuk tejkalon 15,000.00Euro, kjo veprë penale kualifikohet sipas par.1 të nenit 318 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet. Nuk është kontestuese se i akuzuari ka mund të ketë kontrabanduar mall në vlerë shumë më të madhe por në këtë rast mëdyshjet për ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij –neni 3 par.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, andaj për këto vepra penale të kryera nga ana e të akuzuarit N.G., ka arritur parashkrimi veprës penale. I akuzuari G.Sh., edhe pse i njëjti ka kontrabanduar mallra, nuk ka prova se ka kontrabanduar mallra eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar i kufizuar apo kërkohet leje të posaçme nga organi kompetent andaj në rastin e tij kualifikimi bëhet sipas nenit 317 par.1 të KPRK-se, për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, e duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprës penale me datën 23.12.2013, kur është bërë kontrolli në firmën e tij, rezulton se për këtë veprë ka parashkrim të veprës penale, edhe për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 të KPRK-se, duke pasur parasysh se në bazë të ekspertizës financiare e datës 21.12.2015, e kryer me Urdhër të gjykatës, vlera e mallit të kontrabanduar është vlerësuar në shumë 2,508.88Euro dhe vlera e pagesës se shmangur nuk tejkalon 15,000.00Euro, kjo veprë penale kualifikohet sipas par.1 të nenit 318 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet. Nuk është kontestuese se i akuzuari ka mund të ketë kontrabanduar mall në vlerë shumë më të madhe por në këtë rast mëdyshjet për ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij –neni 3 par.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Andaj për këto vepra penale të kryera nga ana e të akuzuarit G.Sh., ka arritur parashkrimi i veprës penale. I akuzuari A.K. edhe pse i njëjti ka kontrabanduar mallra, nuk ka prova se ka kontrabanduar mallra eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar i kufizuar apo kërkohet leje të posaçme nga organi kompetent andaj në rastin e tij kualifikimi behet sipas nenit 317 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet, e duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprës penale me datën 23.12.2013, kur është bërë kontrolli në firmën e tij rezulton se për këtë veprë ka parashkrim i ndjekjes penale. Edhe për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 të KPRK-së, duke pasur parasysh se në bazë të Ekspertizës financiare e datës 21.12.2015, e kryer me Urdhër të gjykatës, vlera e mallit të kontrabanduar është vlerësuar në shumë 2,843.00 Euro dhe vlera e pagesës se shmangur nuk tejkalon 15,000.00Euro, kjo veprë penale kualifikohet sipas par.1 të nenit 318 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet. Nuk është kontestuese se i akuzuari ka mund të ketë kontrabanduar mall në vlerë shumë më të madhe por në këtë rast mëdyshjet për ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij –neni 3 par.2 i Kodit të Procedurës

Penale të Kosovës, andaj për këto vepra penale të kryera nga ana e të akuzuarit A.K., ka arritur parashkrimi veprës penale. I akuzuari N.S., edhe pse i njëjti e ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje dhe nuk është deklaruar lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë nga provat e siguruara gjate fazës së hetimeve – kontrolli Doganor dhe Administratës Tatimore të Kosovës të kryera në firmën e tij e pastaj edhe në bazë të ekspertizës financiare, është vërtetuar se i akuzuari N.S., e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë në mënyrën e përshkruar si në aktakuzë Shmangie nga tatimi neni 313 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së. I akuzuari I.A., edhe pse i njëjti e ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje dhe nuk është deklaruar lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë nga provat e siguruara gjate fazës së hetimeve – kontrolli Doganor dhe Administratës Tatimore të Kosovës të kryera në firmën e tij e pastaj edhe në baze të ekspertizës financiare, është vërtetuar se i akuzuari I.A. i ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë në mënyrën e përshkruar si në aktakuzë Shmangie nga tatimi neni 313 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha provat që u cekën më lartë e të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor e duke i vlerësuar ato në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën vërtetohet përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarve manifesto hen të gjitha elementet e veprave penale që ju vihen në barrë si në aktakuzë të përmirësuar. Të akuzuarit janë fajtor pasi veprat penale i kanë kryer më dashje dhe dijeni, ata janë penalisht përgjegjës meqë nuk ekziston asnjë rrethanë e cila e përjashton përgjegjësinë e tyre penale andaj propozoj që të njëjtët të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, njëkohësisht të detyrohen të kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe shpenzimet e procedurës penale dhe rastin e matjes së dënimit të vlerësohen kontributi më i madh që kanë pasur të akuzuarit I.A. dhe K.K., sidomos shkalla e lartë e pjesëmarrjes së tyre në kryerje të veprës penale, shkallën e lartë të dashjes dhe paramendimit të tyre.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.A., av. H. P. në fjalën përfundimtare deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, se Aktakuza e Prokurorisë Speciale kundër të mbrojturit tim I.A. juridikisht dhe faktikisht nuk mund të qëndroj sepse mungojnë provat, faktet dhe argumentet relevante për të mbështetur pretendimet e tilla të Prokurorisë Speciale, pasi që Aktakuza nuk i përmbush obligimet ligjore konform nenit 241 par. 1 nën par. 5 të KPPRK-së, vepra penale për të cilën akuzohet i mbrojturi im edhe të tjerët është parashkruar, sa i përket veprës penale “Kontrabandim me mallra” nga neni 317 par. 2, të KPRK-së, meqë nga data e kryerjes së veprës penale siç ceket në aktakuzë në fillim të vitit 2011, tani jemi në vitin 2022, pra kanë kaluar 11 vite dhe kemi të bëjmë me parashkrim absolut, po edhe nëse merret viti 2013 si fillim për parashkrim kjo vepër penale duhet të ricilësohet nga ana e gjykatës dhe atë në nenin 317 par 1 të KPRK-së, meqë në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mallra të rrezikshme që ndalohet eksportimi apo importimi i tyre, meqë sipas aktakuzës vetëm njërit nga të akuzuarit i është zënë një sasi malli me cigare në vlerë prej 800.00 €, e që nuk është mall i rrezikshëm as i ndaluar meqë cigaren e konsumojnë njerëzit, e nëse i referohemi aktakuzës sa i përket veprës penale “Shmangia nga tarifët e detyrueshme doganore nga neni 318 par. 3 të KPRK-së, gjykata në bazë të provave të ofruara nga ana e prokurorisë duhet të bëjë ricilësimin juridik të veprës penale dhe atë nga neni 318 pika 3 në pikën 1 të KPRK-së, që i bie që dënimi është paraparë me gjobë dhe burgim deri në tre vite, andaj edhe kjo vepër është parashkruar, pra ka arritë parashkrim absolut nga neni 107 pika 8 e KPRK-së. Po ashtu gjatë procedurës gjyqësore janë dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga ana e prokurorisë, nëse i analizojmë deklaratat e dëshmitarëve por edhe mbrojtjen e të akuzuarve tjerë, vërtetohet pa mëdyshje fakti se i akuzuari I.A. nuk është i ndërlidhur se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale siç pretendohet nga ana e prokurorisë, dhe asnjëri prej tyre as që e njeh dhe nuk e involvon në këtë çështje penale, andaj në mungesë të provave relevante propozojmë që konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të merr aktgjykim lirues për faktin se nuk është provuar se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilat është akuzuar, më pas shton se nëse i referohemi ekspertizës, i mbrojturi im I.A., nuk është

vërtetuar se i njëjti i është shmange tarifave të detyrueshme doganore, dhe nuk ka asnjë prove dhe asnjë fakt se i mbrojturi im ka kryer veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuari I.A. në fjalën përfundimtare deklaron: E mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.K., av. R. D. në fjalën përfundimtare deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, ku ka theksuar se Prokuroria Speciale të mbrojturim e tij K.K., e akuzon pa bazë ligjore për veprat penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, që do të thotë së duhet të ri cilësohet me paragrafin 1 e jo 2, nga se i mbrojturi i tij nuk ka kaluar në kufi asnjë mall që importi apo eksportimi është i ndaluar, i kufizuar apo ti ketë kërkuar leje të posaçme nga organi kompetent, andaj duhet të bëhet ri cilësimi juridik më par. 1 dhe automatikisht konform nenit 106, par. 1, 1.5 të KPRK-së, ka të bëjë më parashkrim absolut, ngase sipas par.1 dënimi parashihet deri në 3 vjet, duke qenë se nga data 23.12.2013 e deri më datën 09.08.2022, mbushën plot 8 vite e 7 muaj e 15 ditë, ku afati i parashkrimit relativ për këtë veprë penale është 3 vite, e ai absolut është 6 vite, ndërsa sipas mbrojtjes prokuroria veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e cilëson më par.2, ku vlera e pagesës së shmangur e tejkalon shumë prej 15.000 euro, a në rastin konkret sipas diapozitivit të aktakuzës për cigaret e kapura K.K.t, ceket 250 kg cigare në vlerë prej 800 euro, andaj duhet të bëhet ri cilësimi juridik më par. 1, dhe automatikisht konform nenit 106, par. 1, 1.5 të KPRK-së, ka të bëjë më parashkrim absolut, ngase sipas par. 1 dënimi parashihet deri në 3 vjet, duke qenë se nga data 23.12.2013 e deri më datën 09.08.2022, mbushën plot 8 vite e 7 muaj e 15 ditë, ku afati i parashkrimit relativ për këtë veprë penale është 3 vite, e ai absolut është 6 vite si dhe tri vepra penale: Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 paragrafi 2. lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilat sipas dispozitës së Kodit Penal të Republikës së Kosovës, bazuar në vlerën dhe cilësimin juridik, janë parashkruar dhe atë parashkrimi absolut, ngase nga data 23.12.2013 e deri më datën 09.08.2022, mbushën plot 8 vite e 7 muaj e 15 ditë, ku afati i parashkrimit relativ për këtë veprë penale është 3 vite, e ai absolut është 6 vite dhe vepra penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare në vazhdim nga neni 146 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, lidhur më nenin nenit 106, par. 1, 1.5 të KPRK-së, e cila veprë më aktvendim të formës së prerë është konstatuar së është parashkruar sipas parashkrimit absolut. Ndër të tjera ka theksuar se pas një studimi dhe analize të mirëfilltë të Aktakuzës, shkresave të lëndës dhe provave në të cilat prokuroria ka pretenduar dhe tani pretendon ta mbështet aktakuzën e ngritur dhe i ka propozuar për administrim në shqyrtimin gjyqësor, ku pas administrimit të tyre dhe analizës së dispozitave ligjore konkrete që lidhën më parashkrim të veprës penale, sipas tij më të drejtë konstaton së nuk janë asgjë tjetër në raport me të mbrojturim e tij, përveç një tentim Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për ta akuzuar më aktakuzë të pa bazë ligjore, nga se nuk ka mbështetje në asnjë provë të pa kontestueshme, sa i përket edhe vetë cilësimit juridik të veprave penale, ngase më shumë ka të bëjë më Kundërvajtje doganore, e mos të flasim për veprën penale, pra sipas mbrojtjes provat në të cilat prokuroria e mbështet aktakuzën e cila është më shumë mangësi ligjore, janë prova që nuk kanë të bëjnë fare me të mbrojturim tij e as më çështjen penale siç pretendon prokuroria, andaj sipas mbrojtjes provat në të cilat prokuroria pretendon ta materializon aktakuzën në raport me të mbrojturim e tij K.K., nuk kanë të bëjnë fare më të, pasi që në procedurën e provave janë administruar dhe dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga ana e Prokurorisë, andaj sipas mbrojtjes nëse analizohen deklaratat e dëshmitarëve, qartë shihet së i mbrojturi i tij nuk është i ndërlidhur në bashkëkryerje siç pretendon prokuroria në aktakuzë, nga së edhe dispozita ligjore e nenit 9. paragrafi 2 i KPPRK-së, rregullon të drejtën e

të pandehurit në procedurën penale për ti ndërmarr të gjitha veprimet për interes të mbrojtjes së tij që të mblidhen dhe të vërtetohen provat të cilat shkojnë në favor të pandehurit e jo vetëm ato që shkojnë në disfavor të pandehurit. Ndër të tjera ka theksuar se nga edhe vetë provat e propozuara nga ana e prokurorisë vërtetojnë faktin e pa mohueshëm së në rastin konkret nëse ka shkelje të ligjit ka të bëjë me kundërvajtje doganore dhe kalim ilegal kufirit e asgjë tjetër e cila vepër penale është parashkruar me aktvendim të formës së prerë të nxjerr nga gjykata dhe atë jashtë seance. Kjo sipas mbrojtjes sepse raportet e vëzhgimit dhe fotot e të pandehurit, nuk e materializojnë aktin akuzues ngase nga raportet e vëzhgimit dhe fotot nuk vërtetohet asnjë veprim inkriminues sa i përket veprave penale. Ndër të tjera ka theksuar se dispozitivi i aktakuzës respektivisht përshkrimi i rastit, veprimi i mjetit, mënyra e kryerjes, motivi i kryerjes, pasoja dhe në fund cilësimi juridik i veprave penale si edhe provat në të cilat është bazuar aktakuza në të cilat janë propozuara nga ana e prokurorisë në këtë aktakuzë, që të administrohen lidhur me K.K.n janë krejtësisht të pa qëndrueshme nga së asgjë nuk vërtetohet më to dhe njëherë janë të pa pranueshme, andaj mbrojtja e të akuzuarit K.K., më të drejtë kërkon që në bazë të nenit 364, paragrafi 1 pika 1.3, të KPPK-së, në mungesë të provave të nxjerr aktgjykim lirues për të pandehurin K.K.

I akuzuari K.K. në fjalën përfundimtare deklaron: E mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av. B. A. në fjalën përfundimtare deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, ku ka deklaruar se nga shkresat e lëndës, përkatësisht ajo që është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve në seancat gjyqësore dhe vet përshkrimi faktik i dispozitivit të aktakuzës është në kundërshtim të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës të mbajtura në këtë gjykatë, pasi që me asnjë veprim të cekur nuk mund ta ngarkojnë të pandehurin B.B., pasi që roli i të njëjtit ka qenë vetëm si taksist, gjegjësisht i angazhuar nga të tjerët për të bërë transportin e mallrave të caktuara dhe ato sipas porosisë përkatësisht urdhërave të personave tjerë, pasi që Prokurori i shtetit nuk ka prezantuar asnjë provë materiale me çka do të vërtetohej se i akuzuari B.B. ka kryer ndonjë vepër penale për të cilat ngarkohet i njëjti, pavarësisht faktit se i njëjti është gjendur në shoqërim me ca njerëz, prapë se prapë i njëjti ka vepruar vetëm si transportues i mallrave pasi që atëherë dhe tani e ushtron veprimtarinë e njëjtë, qëndron fakti se i akuzuari ka qenë në shoqëri me të akuzuarit, pasi që ka punuar për të njëjtit lidhur me transportimin e mallrave të ndryshme, po ashtu vlen të theksohet fakti se i akuzuari B.B. ka vepruar në shërbim, gjegjësisht në cilësinë e informatorit, me këtë veprim i njëjti duke bashkëpunuar në cilësinë e informatorit me personat zyrtar të doganës, ka ndihmuar shërbimin doganor që të zbulohen shumë raste të kontrabandimit të mallrave dhe njerëzve për çka është vërtetuar përkatësisht pohuar në procedurë gjyqësore nga dëshmitarët - inspektorët policor A. H. dhe H.B., për këtë çështje ka pohuar në mbrojtjen e tij i pandehuri H.K. Andaj i propozoj gjykatës që konform dispozitës së nenit 364 par. 3 të KPPRK-së, të bien aktgjykim lirues ashtu që të pandehurin B.B. ta liroj nga aktakuza.

I akuzuari B.B. në fjalën përfundimtare deklaron: E mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.T., av. V. H. në fjalën përfundimtare deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, ku ka deklaruar se në kuptim formal juridik kjo aktakuzë si e tillë është e paqëndrueshme për këto arsye: Pra nga aspekti i së drejtës materiale dhe Ligjit Penal lidhur me veprën penale që akuzohet i mbrojturi im R.T., shihet qartë se aktakuza u përpilua konform dispozitave dhe nenit 241 të KPPRK-së, sepse përshkrimi faktik apo me thanë ndryshe dispozitivi i aktakuzës është i pa qartë dhe

kontradiktor me arsyetimin si në vijim: i mbrojturi im R.T. merret në cilësinë e transportuesit të mallrave të kontrabanduara në vazhdimësi thuhet se ka organizuar kontrabande të ndryshme nga M. për K., dhe atë produkte të ndryshme, lidhur me këtë nga provat e siguruar gjatë fazës së hetimit. Lidhur me veprat bazë, veprën “Kontrabandim i mallrave” nga neni 317 par. 2 lidhur me par 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së edhe nënpikën I(i) “Shmangie nga pagesa e detyrueshme doganore” nga neni 318 par. 3 lidhur me par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prokuroria për këto vepra nuk ka dhënë përshkrim të veçantë, përkatësisht dispozitiv të veçantë në veprimet e të mbrojturit tim që do të formësojnë elementet e këtyre veprave penale, pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prova materiale që do të bindet gjykata se i mbrojturi im R.T. ka kryer veprën penale e cila figuron në aktakuzë, sepse nga përgjimet telefonike përveç supozimeve nuk ka asnjë provë materiale që do të vërtetonte inkriminimin e të mbrojturit tim R.T., pasi që nga përgjimet telefonike jo që nuk vërtetohet por nuk ka asnjë shkresë në drejtim të veprës penale, për të cilën akuzohet i mbrojturi im, pasi që aktakuza mbështetet kryesisht në përgjime telefonike edhe në sekuestrimin e mallrave sipas prokurorisë të kontrabanduara, kështu i quan këto mallra, edhe me supozime kanë përcaktuar sasinë, vlerën dhe dëmin, konsideroj se kjo është e paqëndrueshme në çdo aspekt. Nga vlerësimi i drejt i provave në këtë rast nga ana e gjykatës, konsideroj do të vërtetohet se i mbrojturi im R.T. nuk i ka kryer këto vepra të pretenduara me aktakuzë nga prokuroria, sepse e njëjta nuk arrin ta vërtetoj tezën e aktakuzës, andaj i propozoj gjykatës që në pajtim me nenin 364 par. 1 nën par 1.3 të KPPR-së, ta liroj të mbrojturin tim R.T. sepse nuk është provuar se ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

I akuzuari R.T. në fjalën përfundimtare deklaron: E mbështes deklaratën e mbrojtësit tim dhe shton se të gjitha tatimet i kam të paguar në ATK dhe kjo mund të vërtetohet lehtë nga ATK dhe gjithçka ka qenë në rregull.

Mbrojtësi i të akuzuarit T.C., av. A. I. deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, ku mbrojtja konsideron se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri T.C. nuk përmban veprën penale, sepse vepra penale “Kontrabanim me mallra” nga neni 317 të KPRK-së ekziston vetëm kur shuma e detyrimit doganor të mallrave të importuara apo për të eksportuar ilegalisht kalon shumë prej 5.000 €, e në rastin konkret objektivisht nuk qëndrojnë situatë e tillë përkitazi me të pandehurin T.C., ndërsa vepra penale “Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore” nga neni 318 par. 1 të KPRK-së ekziston vetëm po që se me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, me qëllim që veti ti mundësoj shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose nëse doganës i paraqet dokumente të rrejshme lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikave të tjera të mallit. Përderisa nuk është kontestuese se mallrat janë objekt i kontrabandimit duke u transportuar për rreth vijës së gjelbër të kufirit, assesi nuk mund të shërbejnë si bazë për ekzistimin e veprës penale shmangia e pagesave të detyrimeve doganore dhe tarifave tjera, siç pretendohet në aktakuzën e prokurorisë në rastin konkret. përkatësisht, gjësendet ose vlera e tyre si për nga sasia dhe nga shuma në të holla e cila është përcaktuar në përshkrimin faktik në shumë prej 175.688.50 € që pretendohet se rezulton nga kontrabandimi të determinon se kinse është shkaktuar shmangie na pagesa të detyrimeve doganore në shumë prej 112.915.64 €, sepse kemi të bëjmë me veprime të kundërvajtjes doganore jo vepra penale siç pretendon prokuroria, sepse objektivisht është e pamundur që me një veprim të transportimit të mallrave veshmbathjes me një kalë të shmanget obligimi doganor në vlerë më shumë se 5.000 €, përkatësisht 30.000 €, si pa bazë pretendon prokuroria në aktakuzën e saj. Po ashtu koha e kryerjes së veprave penale është që nga viti 2011 deri më 23.12.2013, e nga provat e

administruara në shqyrtimin gjyqësor, nuk vërtetohet se i pandehuri T.C. gjatë vitit 2011, 2012 dhe 2013, përveç muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2013, nuk ka pasur asnjë kontakt, takim, komunikim në çfarëdo mënyrë me persona të tjerë si I.A., K.K., ndërsa me personat të tjerë si B.B., R.T., K.K., N. K. e të tjerë, disa prej të cilëve as që i njeh, nuk ka komunikuar e as takuar ndonjëherë për të ndërmarrë ndonjë veprim të transportimit të mallrave siç pretendohet në akuzën e prokurorisë, ndërsa dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor në çështjen konkrete penale, vërtetojnë faktin se nuk kanë njohuri e as që kanë dëgjuar ndonjëherë se T.C. është person që është marr me transportimin e mallrave në vijën e gjelbër të kufirit K. – M., rezulton se nuk ka asnjë provë që vërteton se i pandehuri T.C. ka kryer veprat penale, andaj i propozoj që i pandehuri T.C. në mungesë të provave se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë të lirohet nga aktakuza.

I akuzuari T.C. në fjalën përfundimtare deklaron: E mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.K., av. N. A. në fjalën përfundimtare deklaron: mbesim pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit të më hershëm gjyqësor, ku në bazë të shkresave të lëndës dhe provave në të cilat prokuroria ka pretenduar dhe pretendon të mbështet akuzën e ngritur dhe i ka propozuar për administrimin në shqyrtimin gjyqësor, ku pas administrimit të tyre dhe analizës së dispozitave ligjore konkrete që lidhen me parashkrim të veprës penale, me të drejtë konstatojmë se nuk janë asgjë tjetër në raport me të mbrojturin tim, përveç një tentim i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për ta akuzuar me aktakuzë të pa bazë ligjore, ngase nuk ka mbështetje në asnjë provë të pakontestueshme, sa i përket edhe vet cilësimit juridik të veprave penale, ngase më tepër ka të bëjë me kundërvajtje doganore, dhe as që bëhet fjalë për vepër penale. Mes provave të dorëzuara së bashku me aktakuzën, të cilat po ashtu në procedurën e provave janë administruar dhe dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga ana e prokurorisë, andaj nëse i analizojmë deklaratat e dëshmitarëve, shihet qartë se i mbrojturi im nuk është i ndërlidhur në bashkëkryerje siç pretendon prokuroria në aktakuzë, nuk janë asgjë tjetër vetëm supozime dhe dihet mirëfilli se në bazë të supozimeve nuk mund të ngritet aktakuzë, vlen të ceket se nëse prokuroria pretendon se i mbrojturi im ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë duke u bazuar në provat materiale të cilat janë jo vetëm të pa pranueshme por janë prova me të cilat nuk justifikohet kryerja e veprës penale të kontrabandimit, shmangies së taksave dhe tarifave doganore ngase edhe vet provat e propozuara nga ana e prokurorisë vërtetojnë faktin e pamohueshëm se në rastin konkret nëse ka shkelje të ligjit ka të bëjë me kundërvajtje doganore. Pasi që dispozitivi i aktakuzës, respektivisht përshkrimi i rastit, veprimi i kryerjes, mjeti i kryerjes, mënyra e kryerjes, motivi i kryerjes, pasoja dhe në fund cilësimi juridik i veprave penale si dhe provat në të cilat është bazuar aktakuza dhe të cilat janë të propozuara nga ana e prokurorisë në këtë aktakuzë, që të administrohen lidhur me i mbrojturin tim N.K.n, janë krejtësisht të paqëndrueshme ngase asgjë nuk vërtetohet me to dhe njëherësh janë të pa pranueshme, e mbështetur në prova dhe në rrethanat e çështjes mbrojtja e të akuzuarit N.K. kërkon nga gjykata të nxjerr aktgjykim lirues, në mbështetje të dispozitave të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, pra në mungesë të provave.

I akuzuari N.K. deklaron: E mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

I pandehuri I.A., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mos deklarohet, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-DHKO në Prishtinë më datë 27.02.2014, ka deklaruar se jeton në fshatin ...-M., unë e posedoj numrin e telefonit ..., afërsisht 2 vite, vozit

veturën e markës “Golf IV”, me tabela të M., i njoh Q.K. dhe K.K. i kam bashkë vendas- kojshi, nuk kam pasur biznes me K., i njoh K.K., T.C., R.T. dhe N.K. jemi në lidhje fafaisnore me ta, nuk kam pasur raporte biznesi me ta, ndërsa sa i përket rastit që N.K. zihet me mall nga dogana, unë e marr përgjegjësi se ja kam dhënë N. këpucët në F. për mi dërgua në E. H. për mi shitë në pazar në sasi 30-40 palë, i njëjti është ndalur nga policia dhe unë kam shkuar dhe ju kam treguar se malli është i imi me faktura dhe kupon fiskal i kam dërguar në dogana deri me tani nuk më kanë njoftuar asgjë doganat, ndërsa N. ka qenë i angazhuar vetëm si taksi, ndërsa H. K. nuk e njoh, e njoh vetëm një here pa dijeninë ton na kanë ndalur në kufi dhe na ka marr në pyetje mua dhe Q.K., nuk e njoh policin B.S. dhe nuk kam pasur kontakt me K.K. për me ja dhanë 50 euro B., e njoh S. B. si qytetar të H. E. dhe nuk kam pasur kontakt me K.K. për me ja dhanë 20 euro S., e njoh personin B.R. me ka dërguar një i familjes Xh. për ma ja marr parat në shumë prej 1300 euro, jam shkuar dhe ja kam marrë ato para në ditën e arrestimit, gjatë marrjes në pyetje i lexohen traskriptet e bisedave të realizuar me B.B., ku shumica prej bisedave nuk ju kujtohet vetme deklaron se B. e ka angazhuar si taksistë për me shkua me marrë mall në F. dhe për një turr e ka paguar 10-20 euro.

Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit I.A. në deklaratën e dhënë në polici, ku ka deklaruar se njoh Q.K., K.K., T.C. R.T. dhe N.K. jemi në lidhje fafaisnore me ta, nuk kam pasur raporte biznesi me ta, e njëjta deklarata është në kundërshtim me provat materiale konkretisht me raportet e përgjimeve të realizuar në mesë të pandehurve të lartcekur, ndërsa pjesa e deklaratës se e njoh B. L. e ka angazhuar si taksistë për me shkua me marrë mall në F. dhe për një turr e ka paguar 10-20 euro, gjen mbështetje në raportet e përgjime në komunikimet e realizuara mes tij dhe të pandehurit B.B., ndërsa në pjesën e deklaratës ku ka deklaruar se nuk e njoh policin B.S. dhe nuk kam pasur kontakt me K.K. për me ja dhanë 50 euro B., ka deklaruar se e njoh S. B. si qytetar të H. E. dhe nuk kam pasur kontakt me K.K. për me ja dhanë 20 euro S., gjykata vlerëson se i pandehurit I. mohon që ndonjë here ju ka ofruar para me ndërmjetësimin e të pandehurit K.K. të pandehurve B.S. dhe S. B.

I pandehuri K.K., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mos deklarohet, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-DHKO në Prishtinë me datë 19.02.2014, ka deklaruar se unë e posedoj numrin e telefonit ..., nga muaji qershor i vitit 2013, unë e vozis veturën e vllaut e markës “Golf III”, caravan, dhe në ditën e arrestimit kam pasur duhan në veturë në sasi prej 250 kg duhan, i njoh I.A., B.B., R.T., N.K., K.K., nuk kam asnjë raport biznesi me ta ndërsa Q. e kam vlla, jetojmë në një shtëpi dhe nuk kemi lokal apo biznes me të, e njoh policin B.S., e njoh H.K. kur më ka marrë në pyetje më ka zënë me këpucë dhe ma ka marrë kerrin, ato këpucë prej 9 palë i kam blerë në Sh. dhe kam dashtë mi dërgua në F. nëpër lokale, e njoh B.R. në ditën kur jam arrest kam qenë duke ja dërguar duhanin këtij personi, duheni ma ka sjell një person që nuk e njoh në shtëpinë time në fshatin ..., më ka thënë këtë duhan duhet me ja dërgua B. nga Gj., dhe e kam kaluar kufirin vetëm nëpër male i kam pasur 250 kg duhan, unë kam pasur mi marr 40 cent për një kg duhan për kalimin ilegal, dhe në Gj. nga kerri kam pasur me ja dhan duhanin B., nuk e njoh personin Xh.R. nga Gj., e njoh B.S., unë i kam disa shok të Sh. dhe kanë dëshirë me dale për gjueti dhe e kam pyetur B. a muj me dal a kam të drejtë, data nuk më kujtohet por e di që ka qenë pas darke, të njëjtit i lexohen traskriptat e bisedës të realizuar me B. me datë 29.11.2013, deklaron se kanë qenë biseda për gjueti, i kam ndihmuar një her B. ja kam dhënë 50 euro borxh se mi ka kërkuar por nuk mi ka kthyer asnjëherë, një here i kam ndihmuar B. kam shkuar në spitalin S. se i njëjti nuk e ka ditur gjuhen, i kam ndihmuar edhe kur ka kërkuar barna dhe nuk i ka gjet në barnatore e K. ja kam sjell prej M., e njoh S. B. si police dhe nuk i kam thane asnjë herë që të shkoni në marketin e S. D. që të

merr para në vlerë prej 20 euro, dhe nuk me kujtohet biseda telefonike e datës 10.12.2013, ndërsa me datë 20.11.2013, në K. jam ndaluar nga policia kam qenë me B.B. u konfiskua vetura “Golf” pronë e B. dhe malli dhe është hapur rast për kontrabandim me mall, një herë kamë dërguar dy paket këpuca R.T., ndërsa në lokalet e F. nuk ka dërguar as një mall, të njëjtit i prezantohen lexohen traskriptet e bisedave në mes tij dhe I.A., mes K.K. dhe K.K. dhe K. K. dhe B.B. , i njëjti deklaron se nuk ju kujtohen , nuk është e vërtetë, nuk di asgjë, i prezantohen vëzhgimi me foto me datë 15.11.2013, me veturën me targa SK 2131 jeni fotografuar ku me pas kenë dërgua mallin te Xh.R. dhe jeni taku me personi F. L., deklaron se me F. njihemi, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës, me datë 23.12.2013, ka deklaruar se sot jam dal nga shtëpia dhe vllau imë F. K. më tha shko merr ata në H. E., unë shkova e morr duhanin në depon e R.T. dhe u nis me shokun tim I.A. ma tregonte rrugën për në Gj. për me ja dërgua një personit me emrin R. mbiemrin nuk ja di, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e lartcekur.

Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit K.K. deklaratën e dhënë në polici ku ka deklaruar se i njoh I.A., B.B., R.T., N.K., K.K., nuk kamë as një raporte biznes me ta, gjykata vlerëson e njëjta deklarata është në kundërshtim me provat materiale konkretisht raportet e përgjimeve të realizuar në mesë të pandehurve të lartcekur, ndërsa në deklarinim se e njoh B.R. në ditën kur jam arrestua kamë qenë duke ja dërguar duhanin këtij personi, duheni ma ka sjell në person që nuk e njoh në shtëpinë time në fshatin ..., më ka thënë këtë duhan duhet me ja dërguar B. nga Gj., dhe e kamë kaluar kufirin vetëm nëpër male i kamë pasur 250 kg duhan, unë kamë pasur mi marr 40 cent për një kg duhan për kalimin ilegal, gjykata gjen se me këtë e pranon se ka kryer veprën penale Kontrabandim me mall që i vihet në barrë, ndërsa në Gj. duhanin ja ka dërguar të pandehurit B. e jo të pandehurit Xh. që pretendon prokuroria, me pas ka deklaruar se e njoh B.S., unë i kamë disa shok të Sh. dhe kanë dëshirë me dale për gjueti dhe e kamë pyetur B. a muj me dal a kamë të drejtë, data nuk më kujtohet por e di që ka qenë pas darke, të njëjtit i lexohen traskriptat e bisedës të realizuar me B. me datë 29.11.2013, deklaron se kanë qenë biseda për gjueti, gjykata gjen se i njëjti deklarim nuk qëndron për arsye se gjueti nuk bëhet në errësirë por ditën, ndërsa pjesa e deklaratës se i kamë ndihmuar një herë B. ja kamë dhënë 50 euro borxh se mi ka kërkuar por nuk mi ka kthyer asnjëherë, gjykata vlerëson së një njërën nga provat material është cekur kjo shifër e parave, ama a i ka marr parat i pandehuri B. nuk ka dëshmi që e mbështetin këtë rrethanë, ndërsa në pjesën se deklarimit se një here i kamë ndihmuar B. kamë shkuar në spitalin S. se i njëjti nuk e ka ditur gjuhen, i kamë ndihmuar edhe atëherë kur ka kërkuar barna dhe nuk i ka gjet në barnatore e K. ja kamë sjell prej M., këtë rrethanë e ka dëshmuar edhe i pandehuri B. në mbrojtjen e tij, po ashtu në deklaratën e tij mohon se S. B. i ka thane që të shkon në marketin e S. D. që të merr para në vlerë prej 20 euro, pjesa e deklaratës që një herë kamë dërguar dy paket këpuca R.T., ndërsa në lokalet e F. nuk ka dërguar as një mall, gjykata gjen se nuk qëndron se është në kundërshtim me provat material që e mbështetin aktakuzën për arsye se në bazë të raporteve të përgjimeve ka pas komunikim të vazhdueshme me të pandehurit R., Imer, K., B. dhe i ka njoftuar të njëjtit për dërgimin e mallit në firmat e ndryshme në F., pjesa e deklaratë se vllau imë F. K. më tha shko merr ata në H. E., unë shkova e morr duhanin në depon e R.T. dhe u nis me shokun tim I.A. ma tregonte rrugën për në Gj. për me ja dërgua një personit me emrin R. mbiemrin nuk ja di, gjykata gjen se i njëjti ka marrë mallin- duhanin në depot të pandehurit R. dhe e ka dërguar në Gj., e ka pranuar se në vazhdimisht ka kontrabandu mall bashk me të pandehurit tjerë, andaj gjykata gjen se i njëjti deklarim është pjesërisht i bazuar, ndërsa në pjesën që mohon në kryerjen e veprimeve që gjen mbështetje në provat material i pandehur K. ka për qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale Kontrabandim me mall.

I pandehuri B.B., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mos deklarohet, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-DHKO në Prishtinë me datë 03.01.2014, ka deklaruar se jetoj në fshatin ..., Komuna e K., posedoj numrin e telefonit ..., me shumë se 6 vite, posedoj edhe numrin e telefonit ..., qe dy vite, veturën që e përdor është e markës "Passat", ngjyrë vishnje me traga ..., përdori edhe veturën e markës "Jette", ngjyrë vishnje me traga ..., këto vetura i përdori zakonisht unë dhe vëllezërit e mi, e njoh Q.K. i njëjti është nga fshati ..., punon taksist i sjell pasagjer nga M. në kufi të K. me thirret mua e unë i marr ata pasagjer i dërgoj në distancën të caktuar, nuk kamë numër të telefonit të tij, e njoh I.A. e kam djalë të tezes, numrin e tij të telefonit është ..., e njoh K.K., K.K. jemi në lidhje farefisnore, e njoh R. T. dhe për të kamë punuar në sezon kur ka fituar tendera ose kamë shpërnda pije dhe më ka paguar 10 euro ditën, ndërsa në deklaratën e dhënë në Prokurorin Speciale e Republike së Kosovës me datë 07.03.2014, ka deklaruar se për R.T. kam transportua mall prej viti 2013, për K.K. nuk kamë kam transportua vetëm kur ka pas nevoja me dërgua me kerr diku, gjithashtu as për I.A. nuk kamë transportuar mall, ndërsa për Q.K. kamë transportua tekstil dhe këpucë për dy vite, kur kemi shkuar me veturën time në tregun në F. K. dhe F., kur Q. ka blerë tekstil dhe kpuc ata mall e kemi vendosur në veturën time dhe e kemi dërguar në H. të E. te motra e Q., dhe më ka paguar 20 euro, nuk e kemi dërguar mallin e Q. në depon e R.T., mallin kur e ka blerë R. në F. nga firma "Studenti", "Alpina", "Hit Shoes", "Luta", "Kopollo", i kam dërguar në E. H. në depon e tij, nuk ka ndodhur me dërgua mall pa faktur, dhe nuk kamë dërguar mall në as një lokal dhe as një depo në F., gjatë intervistomi i lexohet traskriptat e bisedave të realizuara me R.T., Xh.R., S. M. deklaron se nuk ju kujtohen, më pas deklaron se e njeh H.K. e kamë shok të fëmijërisë, e kam kojshi, e kam takuar rastësisht në tregun e F. K. apo e kamë thirre në telefon nuk me kujtohet, atë ditë më ka njoftuar se e ka dërguar veturën zyrtare për servis dhe është kthyer në treg, po ashtu me kujtohet se kemi qenë se bashku me H. në vjeshtë të vitit 2013, në P. në "... H. i ka blerë një pale çizme unë e kamë blerë një xhemper, i kamë dhënë informata H. për person që kanë kryer vepra penale, ka qenë një rast një person ka kryer vjedhje, grabitje ka qenë shumë i rrezikshëm, dhe H. me ka than shko ka shkolla E. H. e shikoj 2-3 persona me mjekra që dyshohen se do të shkoj në luftë në S., që njërit prej tyre ka shkuar një here në S. është plagosur, ndërsa H. nuk e ka ditë që unë merrem me transport ilegal të mallrave, H. ka kërkuar prej meje me ja ble do libra në P. dhe nusen e vllaut ja kamë dërguar shpesh në Sh. për me ja paguar kabllovikun, gjatë intervistimi i lexohet traskriptat e bisedave të realizuara me Q.K. për pagese e kablloviku për H.K., nuk ju kujtohet, po ashtu deklaron se unë nuk kamë punuar me kontrabandim të mallrave, kamë shërbyer si taksist dhe për këtë shërbim ata më kanë paguar 10-20 euro, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-DHKO në Prishtinë me datë 24.01.2014, ka deklaruar se kam punuar për N.K. rregullisht në vitin 2011 dhe gjysmën e vitit 2012, po ashtu deklaron se ka ndodhur me dërgua një here mall nga H. E. në depo "Alpines", në F., ka ndodhur që e ka bërë përcjelljen e rrugës nga R. nga F. në H. të E. për arsye se nuk na jepeshin faktura firmat ku kemi blerë mall, me datë 18.08.2013, jam ndaluar nga policia e K. dhe më kanë konfiskuar duhan dhe më kanë thënë ta jep një dënim gjykata për mos deklarim të mallit dhe nuk më ka ardhur ai dënim, më pas deklaron se me kujtohet H. ish kanë me H. me ka ndalu në kufi dhe më ka thane thuaj I. e kie një ndales në kufi, unë i kam treguar I., i kamë treguar edhe K. K. ku i njëjtit i ka treguar Q., gjatë intervistimi i lexohet traskripta e datë 01.11.2013 e komunikimit me H.K., dhe komunikimet tjera, i njëjti deklaron se nuk kemi muajt me shku me vizitu axhën tim të sëmur sepse unë kam qenë i zënë i kam dërgua do pasagjer në F., më pas ka deklaruar se ja kam blerë H. tri libra në P. dhe për këto libra H. mi ka dhënë 38 euro, lexohet traskripta e komunikimit me K.K. ku i ka thënë se edhe librat e ati shoqit gjithsej 1773 euro, deklaron se nuk ju kujtohen, lexohet traskripta e komunikimit me K.K., Q.K., N.K. dhe me R.T., deklaron se nuk ju kujtohen.

Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit B.B. deklaratën e dhënë në procedura të më hershme ku ka deklaruar se për R.T. ka transportuar mall prej viti 2013, kam punuar për N.K. rregullisht në vitin 2011 dhe gjysmën e vitit 2012, ndërsa për K.K. nuk kam kam transportua vetëm kur ka pas nevoja me dërgua me kerr diku, gjithashtu as për I.A. nuk kam transportuar mall, unë nuk kam punuar me kontrabandim të mallrave, kamë shërbyer si taksist dhe për këtë shërbim ata më kanë paguar 10-20 euro, gjykata gjen se i njëjti deklaram është pjesërisht i bazuar se duke u bazuar në provat materiale i njëjti ka transportuar mall për të pandehurit N., K.K., I. dhe R., në pjesën e deklaratës se e njeh H.K. e kamë shok të fëmijërisë dhe se bashku me H. në vjeshtë të vitit 2013, në P. në "...", H. i ka blerë një pale çizme unë e kamë blerë një xhemper, H. ka kërkuar prej meje me ja ble do libra në P. dhe për këto libra H. mi ka dhënë 38 euro, i kamë dhënë informata H. për person që kanë kryer vepra penale, H. nuk e ka ditë që unë merrem me transport ilegal të mallrave, gjykata e gjen si deklaram të bazuar për arsye se edhe vet i pandehuri H. në mbrojtjen e tij e konfirmon se B. e ka shok të fëmijërisë, duke u bazuar në raportin e përgjimi në kemi kuptuar se i pandehuri H. me të pandehurin B. kanë shkuar në P., i pandehuri H. ka blerë një pale çizme si bisedon me vallaun e tij për mesë telefon e njofton, nuk përmend që mi ka pagua çizmet i pandehuri B., vetëm se i pandehur B. në vazhdimësi ka komunikua me të pandehurin I. që e ka djalë të tezes duke i than po thotë ky shoqi ...pa qenë në dijen i pandehuri H., i pandehuri B. ka pasur për qëllim të përfitimi për veti nga këta të pandehurit I.A. dhe Q.K., ndërsa sa i përket blerjes së librave këtë rrethanë e ka konfirmuar edhe dëshmitari A. H. që ka sqaruar për gjykatë se ka qenë prezent kur i pandehur H. ja ka dhënë shumën e parave prej 38 euro të pandehurit B. për blerjen e librave, ndërsa deklaram që i ka informuar policin për vepra penale gjen mbështetje edhe në mbrojtjen e të pandehurit H. si dhe në dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje penale si H.B. dhe A. H., andaj gjykata gjen se i njëjti deklaram është pjesërisht i bazuar, ndërsa në pjesën që mohon në kryerjen e veprimeve kriminale gjen mbështetje në provat materiale, pasi që i pandehur B.B. ka për qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale Kontrabandim me mall.

I pandehuri R.T., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mos deklarohet, ndërsa në mbrojtjen e tij, gjatë shqyrtimit gjyqësor të më hershëm ka deklaruar se i njeh të pandehurit , shumicën i njoh nga shkolla, pasi që jemi si gjenerata të përafërta dhe i kam njohtë, nuk kam njohuri me çka janë marr këta personat, ndërsa unë jam marr me tregti e kam pasur një lokal të pijeve me shumicë dhe pakicë edhe tani e kam atë lokal, kemi pasur leje edhe për shitjen e mallrave tjera por që kryesisht jemi marr me pije, kanë persona këtu nëse kanë ardhur tek lokalimi kanë ardhur me u furnizua me pije, ndërsa biznes me ta nuk kam pas, e njoh Q.K. se i njëjti e ka kryer shkollën në H. të E., po ashtu edhe fëmijët e tij e kryejnë shkollën në H. të E., për arsye se në fshatin ... nuk ka shkollë, e njoh B.B. si taksist dhe me sa më kujtohet e kam thirr shumë herë për me dërgu nënën time te mjeku pasi që unë kam qenë i zënë, më pas deklarohet se unë e kam pasur veturë të markës "Mercedes", me targa ... dhe nuk më kujtohet se e kamë dërgua ndonjëherë B.B. me veturën e lartcekur për me marr mall në F. K., ndërsa K. K. dhe Q. K. nuk kanë prur mall tek lokalimi, i njoh B.S., H.K. dhe S. B. si polic, pasi që unë e kam lokalin para kuzhinës ku drekojnë policia dhe 2 - 3 vetura të policisë vijnë para lokalit gjithmonë pasi që drekojnë aty afër, ndërsa në aktakuzë që jam nuk e di ka, dysh, diçka për kontrabandim, unë në atë kohë derisa kam qenë në paraburgim e kam pas një kredi dhe atë ma ka pagu gruaja, unë nuk kam pas asnjë villë, as tokë, as pushime, e kam shtëpinë që ma kanë rregulluar vëllezërit që jetojnë jashtë, nuk kam çka të shtoj, vetëm mbështetem tek zoti dhe qëndroni pranë deklaratave të dhëna më parë, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë policisë së Kosovës-DHKO-Prishtinë me datë 09.01.2014, ka deklaruar se numrin e telefonit ... e posedon që 10 vite, e njoh I., Q. dhe K. të njëjtit janë nga fshati ...-M., motra ime është e martuar me djalin e mixhes Q., e njoh K.K.,

B.B.n dhe N.K., unë pasi e kamë depon kur janë i zënë i thirri personat e lartcekur për më ma vozit kombin, po ashtu gjatë verës kur kanë pasur nevojë kanë ardhur tek unë kanë punuar nga pak, B. kur ja kanë dhanë kombin ka bartur gypë, shakt, punë ndërtimtari ma shumë, çka ka pasur nevojë, ndërsa Q., K., I. dhe B. kanë blerë mall në P., F., janë ndalë tek unë si tek një mik pastaj kanë shkuar në drejtim të Sh., dhe nuk kamë përdor ndonjë objekt të shtëpisë si magazine për mallin e tyre, ndërsa here pas here kamë punuar me këpucë kur kam gjetur artikuj të mire dhe me çmim të lire, gjatë deklarami të njëjtit i lexohen traskriptet e përgjimit të komunikimeve me B.B., i njëjti deklaroi se si transportues i mallit për ata person punoj që një vitit ja sjell mallin në H. të E., dhe nuk me kujtohet arsyeja e kontrollimi të rrugës për të arritur në H. të E., ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta si në deklaratë-mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit R.T. të dhënë shqyrtimit gjyqësor, ku ka deklaruar se i njeh shumicën të pandehurve nga shkolla, nuk kam njohuri me çka janë marr këta personat, e njoh B.B. si taksist, e kamë dërgua ndonjëherë B.B. me veturën për me marr mall në F. K., ndërsa K. dhe Q., nuk kanë pru mall tek lokali imë, ndërsa të pandehurit K.K., B.B. dhe N.K., kur janë kanë i zënë i kam thirri personat e lartcekur për më ma vozit kombin, andaj gjykata gjen se i njëjti deklarim është plotësisht i pa bazuar, kundërthënës, i pa qartë që mohon në kryerjen e veprimeve që gjen mbështetje në provat materiale, me deklarim të tillë i pandehur R.T.n ka për qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale Kontrabandim me mall.

I pandehuri T.C., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mos deklarohet, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-DHKO në Prishtinë me datë 14.02.2014, ka deklaruar se posedon numrin e telefonit ..., më tepër se 5 vite, e njoh I.A. kemi raporte farefisnore dhe e kam shoqëri me të, e njoh K.K. nuk kam shoqëri me të, me asnjërin nuk kamë biseduar as një here për kontrabandim të mallit në vijë të gjelbër, i njoh R. T., B.B. dhe K.K. si qytetar të H. i E., nuk e njoh N.K. dhe B.S., me pas ka deklaruar se e kamë një kali që e përdor për bartjen e druve, lartësia kufitare e vijës së gjelbër K.-M. me shtëpinë time është 3 km, gjatë intervistës i lexohen traskriptat e komunikimit të datës 10.10.2013 me I.A., deklaroi se nuk ju kujtohen, i lexohen traskriptat e komunikimit me Q.K. dhe K.K., deklaroi se nuk ju kujtohen dhe e mohon në vazhdimësi se nuk ka bërë kontrabandim ilegal të mallit me kali në vijën e gjelbër kufitare.

Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit T.C. të dhënë në polici ku ka deklaruar e njoh I.A. dhe K.K., mohon në vazhdimësi se nuk ka bërë kontrabandim ilegal të mallit me kali në vijën e gjelbër në kufi, andaj gjykata gjen se i njëjti deklarim është plotësisht i pa bazuar, që mohon në kryerjen e veprimeve që gjen mbështetje në provat materiale, në raportet e përgjimeve, me deklarim të tillë i pandehur T.C. ka për qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale Kontrabandim me mall.

I pandehuri N.K., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mos deklarohet, ndërsa në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-DHKO në Prishtinë me datë 14.01.2014, e cila deklaratë është lexuar në cilësinë e provës materiale ka deklaruar se jetoj në fshatin ..., Komunë e H. E., kamë një lokal me tekstil "...", në qytet e H. E., unë e posedoj numrin e telefonit ..., më tepër se 10 vite, posedon veturën e markës "Jetta", me targa ..., ngjyrë hirtë, një kohë kamë pas punëtorin tim B.B., i njoh Q.K. dhe I.A.n jetojnë në fshatin ...-M., jemi në raporte

farefisnore, kamë komunikim me ta si raporte shoqërore por dhe me biznes, ndërsa njerëzit e Q. vin marrin mall tekstil në lokalin tim me së shumti 2 herë në javë, e njoh K.K. është vllau i Q. kam më pak kontakt me të, nuk i njoh K.K., T.C., B.S., ndërsa H.K. e njoh si figure, ndërsa R.T. e di që e ka një lokal të pijeve ku blej nga njëherë pije nuk e njoh më shumë, me pas ka deklaruar se lokalin time e furnizoj me mall nga tregu në P. dhe gjithëherë kur blej mall e marr edhe faktuarën dhe e barti me veturën time ose me taksì, dhe 80% të rasteve kamë bartur mall me faktur dhe kamë vepruar sipas ligjit, ndërsa më ka ndodhur ndonjë here kur kamë bërë porosi nuk me kanë dhënë faktur dhe atë mall e kamë dërguar në lokalin tim në H. të E. dhe tri herë mu ka konfiskua mallin në mungesë të fakturave, e kamë thirr nga një here B. me ardh në P. me marr mallin, gjatë intervistimi i prezantohen foto e vëzhgimit si dhe i lexohen traskriptat e komunikimi me B.B., deklaroi se mallin e Q. e kamë lënë tek shtëpia e K. që gjendet përball shtëpisë së R.T. si dhe e kam shpraz në magacina të R., me pas ka deklaruar se obligimi im ka qenë ta transportoj mallin nga P.-H. të E., për një transport kamë marr 30 euro, vlera e mallit në veturë ka qenë 1000-1500 euro, kamë punuar afërsish 5-6 muaj për I.A. dhe Q.K., dhe transportus të mallit për ta kemi qenë unë, B., K., po ashtu deklaroi se mua më vjen keq që jam përfshirë në këtë rast por kushtet ekonomike më kanë bërë që të siguroj ekzistencën e familjes, premtoj se në të ardhmen nuk do ta bojë një veprim të tillë, ndërsa në deklaratën e dhënë në Prokurorin Speciale e Republike së Kosovës me datë 13.02.2014, ka deklaruar se dis qytetar M. kanë ardhur me taxi në F. K. kanë blerë mall atë mall unë e kamë ngarkua në veturë dhe e kamë dërguar sipas kërkesës së Q.K. në depot e K. dhe R.T. dhe ky transport ka filluar të bëhet në fillim të qershorit të vitit 2013, ku kam shkuar në P. dhe F. K. për mall me së shpeshti tri here në javë, një here sipas kërkesës së K.K. kam shkuar për mall në F. nga një depo e një personit e quajtur S. e kam marr duhanin në sasi prej 50-60 kg dhe e kam sjell në stacion e autobusëve në P., autobusi ka qenë me targa të N. P., duhanin e ka marr një person që folke në gjuhën Serbe emrin nuk ja di, i njëjtit mi ka dhënë 20 euro, dhe me vjen keq çka ka ndodhur kjo.

Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit N.K., ku ka deklaruar kamë një lokal me tekstil “...” në qytet e H. E., një kohë kamë pas punëtorin tim B.B., kamë punuar afërsish 5-6 muaj për I.A. dhe Q.K. si transportus të mallit për ta kemi qenë unë, B., K., po ashtu ka deklaruar se mua më vjen keq që jam përfshirë në këtë rast por kushtet ekonomike më kanë bërë që të siguroj ekzistencën e familjes, një here sipas kërkesës së K.K. kam shkuar për mall në F. nga një depo e një personit e quajtur S. e kam marr duhanin në sasi prej 50-60 kg dhe e kam sjell në stacion e autobusëve në P., autobusi ka qenë me targa të N. P., duhanin e ka marr një person që folke në gjuhën Serbe emrin nuk ja di, i njëjtit mi ka dhënë 20 euro, andaj gjykata gjen se i njëjti deklaram është plotësisht i bazuar, gjen mbështetje në provat materiale, me deklarim të tillë i pandehur N.K. pranon veprime e veprës penal Kontrabandim me mall, për të cilën akuzohet dhe ndjen keqardhje për atë që ka ndodhur.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat e propozuara nga Prokuroria, me pajtimin e palëve në procedurë janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve: H.B., A. H., N. D., B. L., E. M., B. H. dhe S. M., N. B. dhe S. D. të dhënë në seancën e të dhëna në shqyrtimit gjyqësor të më hershme, dhe në fazat e më hershme të kësaj çështje penale, si dhe në cilësinë e provave materiale janë administruar provat relevante të cekura në propozim të aktakuzës, që ju përkasin të pandehurve të lartë cekur, për veprën penale për të cilën akuzohen.

Gjykata konform nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të pandehurve, si dhe ato në favor

të tyre, duke i mundësuar të pandehurve dhe mbrojtëseve të tyre, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërjegjeje, i vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, ashtu që pas administrimit të provave vërtetoi këtë gjendje faktike.

Për të vërtetuar këtë gjendje faktike, gjykata në shqyrtim gjyqësor, ka bërë administrimin e provave të propozuara nga prokurori i shtetit, si me poshtë:

Analiza dhe vlerësimi i provave të administruara,

Dëshmitari H.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.01.2022 ka deklaruar punoj në polici që nga data 15.04.2002, në fillim kam punuar në stacionin policor në K., pastaj nga 2003-2005 në pikën kufitare në G., një vit kam punuar në piken kufitare në H. të E., nga 1 janari 2007 deri në vitin 2019 kam punuar në hetimet regjionale të Policisë Kufitare, tani punoj zyrtarë i inteligjencës në policinë kufitare të Kosovës, gjatë vitit 2010-2011 kam punuar hetues rajonal në DRPK, gjatë vitit 2011 kam punuar me H.K., me H. kemi qenë hetues rajonal DRPK dhe epror i joni ka qenë rreshter E.M., kemi qenë me H. në një njësit – një zyre, ndërsa herë pas here kemi punuar me ndërrime, herë na ka ra bashkërisht e herë jo, nuk më kujtohet data saktësisht me datë 01.11.2013, me urdhrin që e kemi marrë më kujtohet, kemi pas me i intervistua dy persona me emra I.A. dhe Q.K., atë ditë H. ka punuar paradite, kurse unë pasdite kam punuar, kam qenë vetëm në ndërrimin e pasdites sepse kolegu i pasdites ka qenë në pushim, atë ditë se bashku me H. me urdhrin e mbikëqyrësit i kemi intervistuar dy personat e lartcekur, fillimisht në ora 16:00, kur e kemi marrë detyrën, mbikëqyrësi më ka njoftuar se duhet me i intervistuar dy persona në çoftëse të njëjtit vinë në piken kufitare të H. të E., pasi që H. ka jetuar me shtëpi afër pikës kufitare që mos me i lëviz zyrtaret tjerë që kanë qenë me vendbanim më largët, ka qenë e domosdoshme me qenë H. për shkak të vendbanimit dhe i njëjti e ka urdhëruar edhe H. që të vjen me mua për me i intervistua këta persona, nuk na ka udhëzua eprori jon se në çfarë cilësie të dëgjohen, por vetëm jemi urdhëruar me i intervistua, ne si hetues i kemi pas dyshimet për një rast të hapur nga prokurori me NN, dhe dyshimet e tona i kemi pas që mund të jenë apo mos të jenë këta persona të dyshuar, për arsye se të njëjtit për të kaluarën kanë pas raste për kontrabandim, kanë qenë të vendosura kamerat në vi kufitare, kanë qenë të instaluar nëpër mal, aty e kanë kap një person me mall duke hy, një person i pa identifikuar i cili nuk ka mund me u identifikua në bazë të fotos, kamerat të cilat kanë qenë të instaluar ato foto kanë ardhë shumë me vonesë për arsye të teknologjisë, në këtë rast nuk ka mund me u kap ai person sepse me vonesë kanë ardhë fotot, na si hetues e kemi marrë lenden mirëpo aty nuk është kap as malli, as personi, as mjeti me te cilin e kanë bajt mallin që ka qenë kali, ne si hetues kemi mbledh prova për me identifikua at person edhe pse nuk kemi pas asgjë të konfiskuar, ne si hetues kemi dashtë për me e intervistua personat e dyshimtë që munden me qenë kryes të veprës, dëshmi nuk kemi pasur që është personi caktuar që e ka kryer atë vepër, mirëpo jemi nis me i intervistua personat që në të kaluarën kanë pas raste me kontrabandim të mallrave, ndërsa sa i përket këta dy persona, a kanë pasur raste të hapura për kontrabandim personalisht unë nuk kam pas ndonjë rast, por kam njohuri se ka pas raste të hapura për ta për kontrabandim të mallrave me sa më kujtohet tekstil të ndryshëm, veshmbathje, e di që janë persona të M., por munden me pas edhe shtetësi të K., më pas të njëjtit persona i ka ndaluar shefi i ndërrimit B. H. në pikë kufitare dhe na ka njoftuar se i ka ndaluar personat e lartcekur, kemi shkuar në piken kufitare së bashku me H.K. dhe i kemi marrë dhe i kemi sjellë te togjet patrulluese të vijës së gjelbër për me i intervistua pasi që në piken kufitare nuk ka pas vend të njaftueshëm për me i intervistua, ne pikë së pari e kemi praktikua se personat ti intervistojmë fillimisht verbalisht që me pas orientimin që në çfarë cilësie me i intervistua më pas, dhe pas bisedës ata persona në asnjë mënyrë nuk kanë pranuar se janë të involvuar në këtë vepër për rastin NN, po ashtu as ne nuk kemi pas asnjë dëshmi më të vogël

se ata kanë qenë të involvuar në këtë rast, na vetëm i kemi intervistua nëse mundemi me nxjerrë ndonjë informatë lidhur me rastin NN, dhe ne nuk i kemi marrë në pyetje në cilësi të dyshuarit por i kemi marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarit dhe qëndrimi i të dyve ka qenë që të njëjtit të merren në cilësi të dëshmitarit dhe nuk kemi kontaktuar më as me prokurorin, të njëjtën ditë në stacionin policor jemi njoftuar se nga hetuesit tjerë janë intervistuar edhe persona tjerë të dyshuar për këtë rast, me sa di unë T. T. ka qenë ndërrimin e paradites, ka intervistua dikën por kënd e ka intervistua nuk e di, nuk më kujtohet se kush nga ne te dy, H. dhe unë ju kemi parashtrua pyetje I. dhe Q.K., dhe nuk më kujtohet që H. ka komunikua me eprorin ton apo prokurori në çfarë cilësie të dëgjohej persona e lartcekur, ndërsa pas intervistimit personat i kemi liruar në procedurë të rregullt dhe nuk më kujtohet se ku kemi shkua, e njoh personin B.B. nuk më kujtohet për atë ditë se e kemi takuar këtë person, mirëpo ka ndodh që ndonjëherë jemi takuar me këtë person ka pas raste të hapura me kontrabandim të mallrave nga njësitë jonë, dhe nuk e di sa raste i ka pas i njëjti më pas dëshmitari ballafaqohet me deklaratën e dhënë në polici datë 13.01.2014, në pyetjen në polici intervistimi i I.A. dhe Q.K. në çfarë cilësie janë pyetur, ju jeni përgjigjur...kështu na ka urdhëruar prokurori, cila është e vërteta nuk më kujtohet që H. më ka thanë që të intervistohet në cilësi të dyshuarve për arsye se nuk kemi pas asnjë provë të vetme në këtë rast konkret. Sa më kujtohet e kemi kryer intervistimin dhe e kemi lajmëruar rreshterin, as ditët në vazhdim nuk kemi pas mospajtime as vërejtje lidhur me deklarin e personave sa i përket cilësive. Më pas deklaroi se kamë njohuri se B.B. është merre me kontrabandimin e mallrave, unë personalisht B. nuk e kam njohur, por unë kam njohuri se H. është në lidhje familjare me B., në vitin 2013 vazhdimisht ka qenë person i njohur, mirëpo ne kemi pas edhe informata prej B. për kontrabandim të mallrave nga persona të ndryshëm na ka informuar neve zyrtarëve policor H. dhe mua për çdo informatë të kundërligjshme që ka pas për qytetaret e rajonit ku jetojmë ne. Më pas deklaroi unë me H. jemi marrë vesh që të shkëmbejmë telefonat dhe unë e kam marrë nga H. telefonin e markës Samsung, nuk më kujtohet X sa ka qenë, ndërsa ja kam dhanë H. telefonin tim Iphone ka qenë më i lirë se sa samsungu dhe ja kam dhanë edhe 70 € pare, mbes në tërsi pran deklaratave të dhëna më pare, ndërsa në deklaratën e dhënë me datë 29.05.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se me datë 01.11.2013, kam marr një urdhëresë nga rreshteri E. M. që në ndërrimin e pasdites prej orës 16:00 deri në ora 00:00, që nëse ndalohen dy persona Q.K. dhe I.A. duhet të intervistohen të njëjtit, pasi që unë kam qenë në ndërrim si hetues i vetëm pasi që hetuesi R. M. kolegu im ka qenë në pushim vjetor nuk na lejohet intervistimi i personave pa prezencën e ndonjë hetuesi tjetër, andaj është dashur të jetë prezent polici H.K., pasi që ne kemi pas nga prokuroria urdhëresë me shkrim për grumbullimin e informatave për rastet e hapura të pa zbuluara NN, në orarin tim të pasdites unë personalisht nuk jam konsultuar me prokurorin por nëse kisha gjetur ndonjë prove të dyshimta gjatë intervistimit ishim konsultuar me prokurorin, unë nuk e di që dikush ka pasur konsultime me prokurorin atë ditë gjatë ndërrimit tim dhe nuk më kujtohet që H.K. ka thënë diçka në lidhje me prokurorin dhe kur i kemi intervistuar këta persona në cilësi të dëshmitarit nuk kemi gjetur asnjë element që këta janë kryes të veprave penale dhe për këtë arsye ne nuk e kemi njoftuar dhe nuk jemi konsultuar me prokurorin, pas intervistimit të dy personat e lartcekur së bashku me H. kemi shkuar në një lokal për darkë që quhet "...", derisa kemi qëndruar në lokal ka ardhur personi B.B. dhe H. ka biseduar për të shkuar për të vizituar një të sëmure, ne kemi kuptuar që i sëmuri nuk gjendet në shtëpi dhe nuk kemi shkuar, pas 3 – 4 minutave të qëndrimit të B. në tavolinën tone me insistimin tim B. është larguar nga tavolina për arsye se ka të kaluar kriminale dhe se unë e kam ndaluar B.B. dhe nuk më kujtohet a është ndaluar për veprën shmangie nga tatimi apo për veprën tregtia e ndaluar por të njëjtin e kanë ndaluar edhe kolegë të tjerë, unë e kam ditur që B.B. dhe H.K. kanë pasur lidhje familjare, po ashtu ka deklaruar se në periudhën kohore gusht apo shtator të vitit 2013, H.K. ia kam dhënë një telefon të tipit "Iphone 3" dhe 70.00 euro para dhe e kam marr telefonin e tipit "Samsung S" ku H. prej fillimit që e ka poseduar telefonin Samsung ia ka dhënë një kolege e K. dhuratë, i njëjti gjatë deklaramit është ballafaquar me deklaratën e

tij në polici ku ka deklaruar se “intervistën e kam kryer në cilësi të dëshmitarit, pas konsultimit me kolegun H.K. i cili më ka thënë se prokurori ka thënë që të intervistohem në këtë cilësi”, dëshmitari deklaron se nuk më kujtohet se a është bash ashtu sepse para se të intervistohen me shkrim në kemi biseduar me personin I.A. dhe Q.K., jemi konsultuar me H.K. me cilën cilësi të merren në pyetje I. dhe Q. pasi që nuk kemi pas asnjë dyshim më të vogël lidhur me rastin NN, andaj e vërteta është ajo që e them në këtë shqyrtim të sotëm, gjatë intervistimit të personave të lartcekur unë i kam marr pyetje ndërsa H. ka përpiluar procesverbalin, i njëjti është ballafaquar me deklaratën e tij në polici ku ka deklaruar se “nuk e di kush ja ka dhënë telefonin H.K., dëshmitari sqaron për gjykatën se e vërteta është ajo që e them sot që H. e ka marr telefonin nga një kolege e K. si dhuratë” më pas deklaron se kam qenë në dijeni që persona të paidentifikuar kanë sjell informata anonime për H.K. dhe për të tjerët pranë stacionit policor dhe unë mendoj se ka mund të ndodh prej personave që nuk na kanë dashtë të mirën apo që i kemi penguar në kryerjen e veprimeve të tyre të ndaluara, ndërsa pjesën tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoriatit policor të Kosovës (IPK), me datë 23.01.2014, ka deklaruar se për I.A. dhe Q.K. kolegun H.K. më ka thënë ka thënë që të intervistohen në cilësi të dëshmitarëve sepse kështu na ka urdhëruar prokurori. Po ashtu ka deklaruar se I.A. dhe Q.K. që i kemi intervistua me kolegun H.K. sipas informacioneve kanë qenë shefat e kontrabandës, po ashtu ka shtuar H.K. ia kam dhënë një telefon të tipit “Iphone 3” dhe 70.00 euro, para dhe e kam marr telefonin e tipit “Samsung S”, dhe nuk e di ku e ka marr telefoni “Samsung S” H., ndërsa pjesën tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur të sinqertë, deklaron se me urdhrin e mbikëqyrësit E. M. unë së bashku me H. kemi pas me i intervistua dy persona me emra I.A. dhe Q.K., nuk na ka udhëzua eprori jon se në çfarë cilësie të dëgjohen të njëjtit persona për një rast të hapur nga prokurori me NN, dhe dyshimet e tona i kemi pas që mund të jenë apo mos të jenë këta persona të dyshuar, pasi që kanë qenë të vendosura kamerat në vi kufitare të instaluara nëpër mal, aty e kanë kap një person me mall duke hy, një person i pa identifikuar i cili nuk ka mund me u identifikua në bazë të fotos, na si hetues e kemi marrë lëndën mirëpo aty nuk është kap as malli, as personi, as mjeti me te cilin e kanë bajt mallin që ka qenë kali, ne pikë së pari e kemi praktikua se personat ti intervistojmë fillimisht verbalisht që me pas orientimin që në çfarë cilësie me i intervistua më pas, dhe pas bisedës ata persona në asnjë mënyrë nuk kanë pranuar se janë të involvuar në këtë vepër për rastin NN, po ashtu as ne nuk kemi pas asnjë dëshmi më të vogël se ata kanë qenë të involvuar në këtë rast, na vetëm i kemi intervistua nëse mundemi me nxjerrë ndonjë informatë lidhur me rastin NN, dhe qëndrimi i të dyve ka qenë që të njëjtit të merren në cilësi të dëshmitarit dhe nuk kemi kontaktuar më as me prokurorin, gjykata gjen se i njëjtit ballafaqohet me deklaratën e dhënë në polici me datë 13.01.2014, në pyetjen në polici intervistim i I.A. dhe Q.K. në çfarë cilësie janë pyetur, ju jeni përgjigjur...kështu na ka urdhëruar prokurori, cila është e vërteta, dëshmitari sqaron për gjykatën se nuk më kujtohet që H. më ka thanë që të intervistohet në cilësi të dyshuarve për arsye se nuk kemi pas asnjë provë të vetme në këtë rast konkret, gjykata gjen se e njëjta deklarata gjen mbështetje në provat materiale si në raportin e përgjimeve të realizuar në mesë të pandehurit H.K. dhe udhëheqësi të tij dëshmitarit E. M., si dhe në mbrojtjen e të pandehurit H. që ka deklaruar se ska pas as një prove të vetme që I.A. dhe Q.K. të n dëgjohen në cilësi të dyshuarve, ndërsa pjesën e deklaratës që i pandehuri H.K. ia kam dhënë një telefon të tipit “Iphone 3” dhe 70.00 euro para dhe e kam marr telefonin e tipit “Samsung S”, ku H. prej fillimit që e ka poseduar telefonin “Samsung” ia ka dhënë një kolege e K. dhuratë, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se nuk e di ku e ka marr H. telefoni, dëshmitari H. sqaron për gjykatën se e vërteta është ajo që e them në këtë shqyrtim të sotëm gjyqësor që H. telefonin “Samsung” ia ka dhënë

një kolege e K. dhuratë, gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale që gjen mbështetje në provat material.

Dëshmitari A. H. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.01.2022 ka deklaruar se që nga data 12.01.2004, punoj zyrtarë policor në kufi në K., prej vitit 2011 kam punua në njësitin për hetime regjionale në K., tani punoj pranë stacionit policorë në K., unë i njoh H.K., B.S., S. B., mirëpo vetëm me H.K. kam punua, kemi qenë të barabartë fillimisht kemi punua si ekip pastaj më vonë tani jemi ndarë, më kujtohet i kemi pas 4 raste dhe i kemi nda të 4 rastet, mu personalisht, H.K., T. T. dhe H. B., kanë qenë raste me NN persona, në ato raste dyshohet në bazë të kamerave të regjistrimit të vendosura në vijën kufitare janë kap disa imazhe të paqarta por shihet që është një person, në bazë të atyre i kanë hap 4 raste kundër NN personave si fillim kemi ngrit kallëzim penal kundër NN personit për kalim ilegal apo kontrabandim, pastaj na kanë ardhur urdhëresa të prokurorisë për 4 raste me zhvillua hetimet, me marrë në pyetje të dyshimtë, nuk kemi pas persona të identifikuar, tek rasti NN kemi marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, për arsye se nuk kemi pas prova se këta kanë qenë kontrabanduesit apo që kanë mundur me krye ndonjë vepër penale, nëse nuk kemi prova duhet me marrë në pyetje si dëshmitarë e jo në cilësi të akuzuarit, mirëpo nëse më vonë na dalin prova atëherë në konsultim me prokurorin e marrim në pyetje si të akuzuar, gjatë marrjes në pyetje nuk ka pas kurrfarë lëshimi dhe gjithçka ka shkua në bazë të rregullave si është dashtë me i marr në pyetje si dëshmitarë për me mbledh prova, pasi që urdhëresa e prokurorisë ka qenë me grumbullua informata me qëllim të identifikimit të kryesve të veprave penale, sa më kujtohet mua në konsultim me prokurorin të 4 rastet i kemi mbyll me raport të veçantë. Me pas deklaron se të akuzuarin B.B. e njoh, kemi pas informatë që bart mallrat dhe që është një lloj taksisti, te unë personalisht nuk e kam hetuar për ndonjë rast mirëpo e kemi has në transport ilegal të mallrave, zakonisht ka transportua tekstil, këpucë, po ashtu B.B. na ka ndihmua me informata të kundërligjshme, po ashtu i njoh Q.K., N.K., K.K. si emër, kam punua në pikë kufitare në H. të E. i njofton personat që kanë pasur kalime në kufi, me pas deklaron se janë në njohuri që H. e ka porositë dike për me ja blerë do libra në P., me emër se di kënd mirëpo e di që pare ka dhënë dhe i ka pagua ato libra, sa pare i ka dhënë nuk e di, kur i ka dhënë paret për libra unë kam qenë prezent, ndërsa në deklaratën e dhënë me datë 23.04.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se e njoh Q.K., K.K. kamë pas njohuri se merren me kontrabandim të mallit por unë personalisht nuk e kam hetuar as një rast të tyre, K. e kemi hasur disa her duke transportuat mall nga K.-M. por gjithherë e ka pas dokumentacionin në rregull, e njoh I.A. edhe për të njëjtin nuk ka pasur rast që është zënë në kryerjen e veprës penale, deklaron se e njoh N.K. si transportues të mallit e nuk e njoh qe merret me kontrabandim të mallit, me pas ka deklaruar se me datë 01.11.2013, në ora 12:20 min kemi marr në pyetje në cilësi të dëshmitarit personat H.N., Naim Bardhi me vonë i kemi intervistua I.A. dhe Q.K., po ashtu ka deklaruar se ka njohuri që H. i e ka porositë B.B. n për me ja blerë do libra në Prishtinë të fakultetin Juridike sepse i njëjti ka qenë student, e di që ja ka dhënë B. t paret për libra unë kam qenë prezent ka qenë shuma prej 37 euro, për veç kësaj nuk ka pas ndonjë raste tjetër që H. ka kërkuar diçka tjetër nga B., pasi që H. ka qenë një zyrtar policor si punëtori më i mire në rajon dhe kamë njohuri se e kanë gjelozuar kolegët dhe kanë dhen informata të pa vërteta te komandanti i policisë, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoratit policor të Kosovës (IPK), me datë 29.01.2014, ka deklaruar se e njeh R.T. se ky person merret me kontrabandim të mallit, por në seance e shqyrtimi gjyqësor të datës 23.04.2015 ka deklaruar se personalisht nuk e kama hetuar as një rast të tij, e njoh N.K. si transportues të mallit për Q.K., K.K. dhe I.A., ka pasur 3 raste të hapura për vitin 2011-2012 për kontrabandim të mallit apo kalim ilegal, por unë personalisht nuk e kama hetuar as një rast të tyre, e njoh B.B. si transportues të mallit që punon për Q.K., K.K. dhe I.A., çdo here e kemi ndaluar me H., e që nga viti 2012 ka qenë si bashkëpunëtor i joni na ka ofruar informata për personat që njihen si kërcënim për shoqërinë,

kontrabandim me emigrant , personat që e kanë përdorur si transit Kosovën, por vlen të ceket se ne nuk kemi toleruar as një lehtësim kur të njëjtin e kemi zënë në ndonjë veprim të kundërligjshëm, zakonisht kemi dal me B. unë dhe shoku im A. T., rreth orës 8, 9 dhe 10 e mërkurës në disa lokale në restorante dhe lokalet publike në K., i njëjti njoftohet se në të njëjtën datë dhe të njëjtën kohë se ka qenë me B., për sms B. i ka dërguar K.K. citim” Ai shoqi po kërkon diçka ekstra për Bajram”, i njëjti deklaron se nuk ka lidhje me mua ajo punë, me pas ka deklarua se me sa më kujtohet kemi komunikuar me prokurorin kujdestar dhe me shefin, prokurori na ka thane se Q. dhe I. mi marr në pyetje në cilës të dëshmitarëve, në pyetje i kanë marrë në orarin e pasdite H.B. dhe H.K., e kemi marr në pyetje në cilësi të dëshmitarit personat H.N. i njëjti në deklaratën ka pranuar se ka bartë mall për personat Q.K. dhe I.A., me kalim e tij por nuk i kujtohet data dhe nga këta paguhet 12 euro, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, ku deklaron se kemi hapur katër raste me NN persona, pastaj na kanë ardhë urdhëresat të prokurorisë për grumbullimin e informatave me qëllim të identifikimit të kryesve të veprave penale, i kemi nda, mu personalisht, H.K., T. T. dhe H. B., pasi që në ato raste dyshohet në bazë të kamerave të regjistrimit të vendosura në vijën kufitare janë kap disa imazhe-foto të paqarta por shihet që është një person, në bazë të atyre fotove i kanë hap katër raste kundër NN personave, me datë 01.11.2013, në ora 12:20 min kemi marr në pyetje në cilësi të dëshmitarit personat H.N., N.B., derisa sa H.N. në deklaratën e tij ka pranuar se ka bartë mall për personat Q.K. dhe I.A., me kalim e tij por nuk i kujtohet datat dhe për këto transporte paguhet 12 euro, me vonë i kemi intervistuar I.A.n dhe Q.K.n, sa më kujtohet mua në konsultim me prokurorin rastet i kemi mbyll me raport të veçantë, për arsye se nuk ka pas prova të mjaftueshme për me akuzua dikën, gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit se në mungesë të një prove të vetme katër raste NN, janë mbyllur me raport të veçanta, pasi që dëshmitari H.N. në deklaratën e tij ka pranuar se ka bartë mallë për personat Q.K. dhe I.A., me kalim e tij por nuk i kujtohet data që të njëjtat data nuk janë kanë të njëjta me datat kur janë bërë fotot nga kamerat përgjatë kufirit, në mungesë datës definitive është intervistuar në cilës të dëshmitarit, në pjesën e deklaratës se e njoh N.K. dhe B.B. si transportues të mallit, kanë transportua mallë për Q.K., K.K. dhe I.A., i njëjtit deklarim gjen mbështetje në provat material siç janë raportet e përgjimeve për të pandehurit e lartcekur që e mbështetin këtë aktakuzë, në pjesën e deklaratës se B.B. na ka ndihmuar në dhënie të informacione të kundërligjshme mua dhe H., çdo here e kemi ndaluar B. kur kam qenë me H. vlen të ceket se ne nuk kemi toleruar as një lehtësim kur të njëjtin e kemi zënë në ndonjë veprim të kundërligjshëm, zakonisht kemi dal me B. unë dhe shoku im A. T., rreth orës 20:00, 21:00 dhe 22:00 e mërkurës në disa lokale në restorante dhe lokalet publike në K., dëshmitari njoftohet se në të njëjtën datë dhe të njëjtën kohë se ka qenë me B., një sms B. i ka dërguar K.K. citim ”Ai shoqi po kërkon diçka ekstra për B.”, në rastin konkret gjykata vlerëson në këtë çështje penale në raportet e përgjimeve sms që ka komunikua ia pandehur B. me të pandehurin K. dhe I. ju ka referua gjithëherë po thotë ky shoqi- e në rastin konkret sipas pretendime të prokurori shoqi ka qenë H., në këtë rast gjykata gjen që shoqi sipas të pandehuri B. ka qenë edhe dëshmitari A., që vihem tek një konkludim se i pandehuri B. për të përfituar për vete i ka përdorur thëniet po thotë ky shoqi pa e cek emrin se për kënd bëhet fjalë, andaj duke i referuar sms së lartcekur dëshmitari A. ka sqarua për gjykatën se nuk ka lidhje me mua ajo punë, andaj gjykata dëshminë e dëshmitarit e vlerëson si dëshmi objektive, reale dhe të sinjertë.

Dëshmitari N. D. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.01.2022, ka deklaruar se punoj në policinë e Kosovës nga shtatori i vitit 2000, në patrullën e H. të E., gjatë vitit 2010-2011 kam punua në vinë e gjelbër në H. të E., kam pas përgjegjësi si udhëheqës i ndërrimit, kohë pas kohe, i njoh H.K., S. B. dhe B.S.. Me B.S. po dhe H.K. kam punua më herët, këta kanë punua në njësi

tjera dhe i kam njohët, ndërsa S. e kam dit që është polic mirëpo se kam njohur skam pas kurrë far kontakti, gjatë kohës që kam punua me B. unë kamë qenë udhëheqës i tij gjithçka ka qenë në rregull nuk kam vërejt parregullsi, për marrjen në pyetje të personave të caktuar konsultohemi dhe me mbikëqyrësit më të lartë dhe me policët në rast dhe bashkërisht i bëjmë pyetje, s'jemi të veçantë, dikush e merr në pyetje me mire dikush më pak dhe vendosim bashkërisht kush me marr në pyetje, sa i përket personave të akuzuar në këtë rast K. K. e njoh se e kam pas një rast më herët me të, është dyshua me kontrabandë me mallra për tjetër rast, asaj kohe zakonisht janë kontrabandua tekstil, duhan, këpucë, në shumicën e rasteve janë bartur me mjete të vogla si vetura dhe me kuaj, nuk e njoh Xh.R. Për rastin që jem sot nuk kemi ndërmarr hetime me urdhëresa të prokurorisë, nuk kam marr në pyetje askënd dhe nuk kam marr asnjë veprim në kuadër të detyrës zyrtare sepse nuk kam pas kompetenca, ka qenë kompetenca e inspektorati policorë, pasi që kam qenë në pushim vjetorë gjatë kohës kur ka ndodhur ky rast me NN persona, ndërsa në seance e shqyrtimi gjyqësor të datës 23.04.2015 ka deklaruar se e njoh një K. mbiemri n nuk ja di, pas shikimi në sallë të K.K., dëshmitari sqaron se nuk është nuk është ky K. që e njoh, i njëjti ballafaqohet me deklaratën nga IPK me datë 04.02.2014, "kemi qenë të njoftuar nga toger se kush janë të dyshuarit për kontrabandim me mallra ka qenë edhe K.K.", dëshmitari me lejen e gjykatës i shikon të gjithë të akuzuarit prezent në sall e drejton dore nga K. K. ndërsa të tjerët nuk i njoh që janë marr me kontrabandim të mallit, me pas deklaroi se H. K. ka qenë i lënduar nga eproret për punën që e ka kryer, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoratit policor të Kosovës (IPK), me datë 04.02.2014, ka deklaruar se kemi qenë të njoftuar nga toger se kush janë të dyshuarit për kontrabandim me mallra ka qenë edhe K.K., po ashtu nuk ka pas njohuri as nga B.S. as kërkesa nga qytetaret që me datë 28-29.11.2013, që dikush është në gjuetinë në vijë të gjelbër në ora 00:00, pasi që nga data 10.12.2013 kamë qenë në pushime vjetor dhe kur jam kthyer kishte ndodhur ky rast.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, që deklaroi se i njoh H.K., S. B. dhe B.S., pasi që H. K. ka qenë i lënduar nga eproret për punën që e ka kryer, pas që i shikon të gjithë të pandehurit prezent në sall, e drejton dore nga K.K. ndërsa të tjerët nuk i njoh që janë marr me kontrabandim të mallit, nuk ka pas njohuri as nga B.S. as kërkesa nga qytetaret që me datë 28-29.11.2013, që dikush është në gjuetinë në vijë të gjelbër në ora 00:00, gjykata gjen se dëshmia këtij dëshmitarit është objektive, reale dhe e sinqertë.

Dëshmitari B. L. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.01.2022, ka deklaruar se si zyrtar policorë në policinë e Kosovës kam punua që nga viti 2002, vijën e gjelbër, në vijën kufitare patrullues në H. të E., po ashtu gjatë vitit 2013 kamë punuar në vijën e gjelbër në policinë kufitare, polic patrullues, detyrat e mija në vijën e gjelbër kufitare kanë qenë kontroll e vijës kufitare gjatë kufirit jo në pikat kaluese por jashtë pikave kaluese, kryesisht puna jonë ka qenë parandalimi i të gjitha veprave penale që kryhen gjatë kalimit të kufirit, po ka pas raste që kanë dal dhe kafshë këtej kufirit, sidomos tek pjesa e U. së G. që quhet, më pas ka deklaruar se i njoh të pandehurit H.K., B.S. dhe S. B., me të pandehurin S. B. kam punua në vitin 2003-2006 në stacionin policorë në K., në vitin 2013-2014 nëse s'gaboj kam punua me të pandehurin B.S. n kemi bërë patrulla të përbashkëta 3-6 muaj, ndërsa të pandehurin H.K. e njoh vetëm si zyrtarë hetues në regjionin e lindjes, personat që janë të përfshirë në aktakuzë i njoh vetëm si emra, nuk më kujtohet që kam pasur ndonjë rast me ta, me të pandehurin B.S. gjatë punës me të nuk kam pas asnjë vërejtje në punën e tij, sepse i ka krye të gjitha punët që i janë dhënë atij në kohën e patrullimit, qëndroj pran deklaratave në polici dhe në gjykatë, ku në seance e shqyrtimi gjyqësor të datës 23.04.2015 ka deklaruar se me datë 29.11.2013, nuk më kujtohet a kam qenë në patrullë në vij të gjelbër me të pandehurin B., pasi që me të pandehurin B. kemi qenë në patroll prej 20-30 herë, dhe nuk kam qenë në dijeni se ndonjë person ka qenë për gjueti në vi të gjelbër për

arsye se gjueti bëhet ditën e jo natën pasi që edhe vetë jam gjuetar, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoratit policor të Kosovës (IPK), me datë 04.02.2014, ka deklaruar se shefi ndërrimit me datën 29.11.2013, nuk më kujtohet saktësisht ka qenë A. A. ose N. D., njëri nga këta të dy ka qenë që i ka përcaktua detyrat, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, që ka deklaruar se me datë 29.11.2013, nuk më kujtohet a kam qenë në patrullë në vij të gjelbër me të pandehurin B., pasi që me të pandehurin B. kemi qenë në patrullë prej 20-30 herë, dhe nuk kam qenë në dijeni se ndonjë person ka qenë për gjueti në vi të gjelbër për arsye se gjueti bëhet ditën e jo natën pasi që edhe vetë jam gjuetar, gjykata gjen se dëshmia e kti dëshmitar nuk gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit B. S. që ka deklaruar se atë natë kam qenë i shoqëruar me B. L., i njëjti ka qenë shef i patrullës, ai ka qenë në njohuri që i pandehuri K.K. ka dal për grill në atë zonë, gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale që gjen mbështetje në provat materiale.

Dëshmitari E. M. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.04.2022, ka deklaruar prej vitit 2010 jam në njësinë e hetimeve të Policisë Kufitare në cilësinë e mbikëqyrësit të cilën pozitë e mbaj edhe tash, kompetencat e mbikëqyrësit të hetimeve janë menaxhimi i lëndëve të cilat ngarkohet policia kufitare në këtë rast si dhe mbikëqyrja e hetuesve të cilët janë të caktuar në njësinë e hetimeve, unë kam pas 5 polic që kam pas në mbikëqyrje, mesa më kujtohet mua në pjesën e Gj. kam pasur policin I. H. dhe J. B., në pjesën e K. kam pasur policin R. P., T. T., H.B., H.K. dhe A. H., me datë 01.11.2013, kam caktuar detyrë H.K. dhe H. B., kanë qenë disa raste të cilat janë hap më herët pikërisht për rastin që jam thirr si dëshmitarë të cilat në kohën e hapjes së këtyre raste janë iniciuar me disa kamera eksperimentale në teren të cilat lanë qenë të vendosura në disa shtigje që kemi menduar që shfrytëzohen nga kontrabanduesit, pikërisht nga ato kamera janë hap 4 raste me kryes të panjohur NN, kamerat kanë qenë në atë mënyrë të vendosura që u dashtë me shku me marr kamerën me e pru në stacion dhe me i nxjerr imazhet që i ka fotografua, imazhet kanë qenë shumë të dobëta pasi që ka qenë natë, mirëpo nga patrullat e policisë që i ka vendos kamerat është thirr Prokurori Kujdestar i PTH - F. dhe i njëjti ka urdhëruar që hapen raste për secilin imazh, për secilin rast ka ngarkuar policët hetues të cilën kanë bërë kallëzim penal ndaj personave NN, më pas kemi pranuar nga një kërkesë për mbledhje të dëshmive nga PTH në F., prapë ju kam dhanë hetuesve dhe i kam angazhuar në teren për grumbullimin e informatave të njëjti kanë dal në teren dha janë mundu me i gjet të dyshimtit, hetuesit i kanë pas disa informacione dhe i kanë marr në pyetje disa persona, emrat nuk më kujtohen krejt por e mbaj mend se kanë qenë 4 persona, pas mi përmendet emrat po janë intervistuar I.A. dhe Q.K., çdo herë kur hetuesi e merr ndonjë person në rastet kur personal janë NN, merren në pyetje në cilësinë e të dyshuarit, mirëpo në momentin që nuk mundemi me gjete asnjë dëshmi edhe unë jam kontaktuar atë ditë përmes telefonit edhe i kam pyetur a është fotografia që është nxjerr nga kamera a identifikohen personat që i keni marr në pyetje, apo keni ndonjë dëshmi tjetër që mundeni me inkriminu si të dyshuar, përgjigja e tyre ka qenë jo nuk kemi mundësi dhe nuk kanë pas asnjë dëshmi që i ka inkriminuar personat e lartcekur që të 4 dhe në këtë rast të 4 janë intervistuar në cilësi të dëshmitarëve, për arsye se në data bazat tona nëse e shtinë në cilësi të dyshuar je i obliguar që të bësh edhe kallëzim penal ndaj tyre, dëshmitari është ballafaquar me deklaratën e dhënë në shqyrtimin e mëhershëm gjyqësor të datës 29.05.2015, në faqen e 6, rreshti i 6 nga fundi i faqes “theksoj se unë ju kam urdhër që në fillim që para se të

dëgjohe këta persona të dëgjohe në cilësi të dyshuarve, mirëpo policët është dashur me kontaktua me mu por edhe me prokuroren se në cilën cilësi ti marrim këta persona, por a kanë... por gojarisht më ka thënë se e kanë ftuar prokuroren se kanë biseduar me të por me mua nuk kanë kontaktuar, dëshmitari sqaron për gjykatën se për këtë rrethanë nuk kam njohuri vetëm e di se më kanë kontaktuar në telefon dhe ju kam thënë se a mundeni me i identiku se a janë të njëjtit persona me fotografinë që e keni bërë nga kamerat, pasi që zakonisht policia kontaktojnë e prokurorë por nuk më kujtohet saktë se çfarë ka thënë H.I, nuk ipet urdhër nga mbikëqyrësi për arsye se secili zyrtar policor i ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta, e në rastin konkret kur kanë vërejtur se nuk ka asnjë provë janë marr në cilësi të dëshmitarëve siç e ceka me lartë, të njëjtit janë liruar pas intervistimit, është bërë raport plotësuar i kallëzimit penal dhe i është dorëzuar prokurorit kompetent në F., ku të njëjtit e mbikëqyrin procedurën e hetimit, personalisht për mua skanë qenë të njohur mirëpo hetuesit nga informacionet e veta kanë pas informacione për I.A. dhe Q.K. janë të përfshirë në veprime inkriminuese atë arsye ata janë ndaluar në cilësinë e të dyshuarve, në rastin NN, në bazë të përvojës sime nuk ka pas shkelje edhe po të kishte shkelje do të reagohte prokuroria, në kohën sa kam qenë mbikëqyrës i H.K. i njëjti ka qenë një ndër zyrtarët me të mirë hetues i njësitit tim po ashtu i njëjti ka marr disa mirënjohje edhe nga drejtoria pasi që ka qenë vet iniciator i kapjes së kontrabandës në kufi, më pas deklaroi se kamerat se kanë qenë eksperimentale në vijë të gjelbërt në kufi dhe nuk kanë ditë as prokurorët se çka me veprua, ne i kemi njoftuar se ka hy dikush në mënyrë ilegale në kufi, vet prokurorët na kanë udhëzuar me hap rastin e që më vonë ka ndodh e njëjta gjë, na kanë thënë se duhet të largohen këto kamera për arsye se nuk mund në vazhdimësi me hap raste dhe mos me identifikua asgjë, më vonë Policia e Kosovës ka bërë kontratë me IPKO-në dhe kamerat që kanë fotografuar në kohë reale kanë ardhur fotografitë përmes emailit, dhe në këto raste patrulla ka mund me intervenua menjëherë dhe me kap kryesit e veprës penale dhe për këtë arsye mendoj se është mbyllur rasti NN në mungesë dëshmie, kamera janë vendos nga togje patrulluese që është stacion për mbikëqyrjen e kufirit dhe zakonisht vendosen në rrugët malore që mendohet që kontrabanduesit i shfrytëzojnë ato rrugë, pasi që në ato rrugë kalohet me këmbë, me kuaj dhe në mënyra të ndryshme, në seance e shqyrtimi gjyqësor të datës 29.05.2015 ka deklaruar se unë kam pas një telefonat nga H.K. dhe e ka pyetur për me marr leje që me kontaktua me piken kufitare mi ndalu disa person që kanë të bëjnë me katër rastet N.N, të cilat raste janë hapur nga togjet patrulluese të vijës së gjelbër, dhe unë e kamë lejuar që H. të thirr pikën kufitare me telefon që ti ndaloj ata persona kur kalojnë piken kufitare, pas ndalimet të personave unë kamë kontaktuar me H. dhe e kamë pyetur se a ka ngjashmëri të personave me fotot e kamerave që janë bërë në piken kufitare i njëjtit thotë se fotot janë shumë të dobëta dhe kanë kërkuar që të njëjtit të dëgjohe në cilësi të dyshuarve, mirëpo më vonë pasi që janë intervistuar dhe pasi që i kanë marr ato dy deklaratat e kamë kuptuar se nuk ka pas as një dyshim që të merren në cilësi të dyshuarve dhe kamë urdhëruar që të njëjtat deklaratat me raport të plotësues ti dërgohen te prokurori në F., prokurori i ka pranuar të njëjta deklaratat pa vërejte, se në praktik kemi pas raste kur prokurori i ka kërkuar 2 deri 3 herë që mi marr në pyetje personat e dyshuar, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoratit policor të Kosovës (IPK), me datë 23.01.2014, ka deklaruar se me sa më kujtohet ata kanë biseduar me H.B. dhe i kanë intervistuar persona e dyshuar, por personat e dyshuar nuk kanë pranuar që kanë qenë të implikuar në rast dhe janë liruar me urdhër të prokurorit.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, ku sqaron për gjykatën se me datë 01.11.2013, ju kam caktuar detyrë H.K. dhe H. B., janë hap katër raste të panjohur NN, duke u bazuar nga fotot e marr të disa kamera eksperimentale në teren të vendosura në disa shtigje që kemi menduar që shfrytëzohen nga kontrabanduesit, andaj nga patrullat e policisë që i ka vendos kamerat është thirr Prokurori Kujdestar i PTH - F. dhe i njëjti ka urdhëruar që hapen raste për secilin imazh, për secilin rast ka ngarkuar policët hetues të cilën kanë bërë kallëzim penal ndaj personave NN, më pas kemi pranuar nga një kërkesë për mbledhje të dëshmive nga PTH në F., prapë ju kam dhanë hetuesve dhe i kam angazhuar në teren për grumbullimin e informatave, të njëjti hetuesit i kanë pas disa informacione dhe i kanë marr në pyetje disa persona, emrat nuk më kujtohen krejt por e mbaj mend se kanë qenë 4 persona, janë intervistuar I.A. dhe Q.K., unë jam kontaktuar në telefon nga i pandehuri H. edhe e kam pyetur a është fotografia që është nxjerr nga kamera a identifikohen personat që i keni marr në pyetje, apo keni ndonjë dëshmi tjetër që mundeni me inkriminu si të dyshuar, përgjigja e tyre ka qenë jo nuk kemi mundësi të bëjmë identifikim në fotot dhe nuk kanë pas asnjë dëshmi që i ka inkriminuar personat e lartcekur, andaj në të 4 rastet NN janë intervistuar në cilësi të dëshmitarëve, dhe ka urdhëruar që të njëjta deklarata me raport të plotësues ti dërgohen te prokurori në F., prokurori i ka pranuar të njëjta deklarata pa vërejte, se në praktik kemi pas raste kur prokuror ka kërkuar 2 deri 3 herë që mi marr në pyetje personat e dyshuar, po të kishte shkelje do të reagonte prokuroria, *me pas jemi udhëzuar nga prokuroria që duhet të largohen këto kamera për arsye se nuk mund në vazhdimësi me hap raste dhe mos me identifikua asgjë*, gjykata e vlerëson se në bazë të fotove të marr nga kamerat eksperimentale në vazhdimësi nuk ka mujtë të identifikohet asgjë ngjashëm si në 4 rastet NN, andaj dëshmia e këtij dëshmitari gjykata e vlerëson si objektive, reale dhe të sinqertë që gjen mbështetje në provat material dhe në mbrojtjen e të pandehurit H.K.

Dëshmitari B.H. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.04.2022, ka deklaruar se gjatë viteve 2010 kam punuar në pikën kufitare në H.të E., kam qenë si mbikëqyrës i ndërrimit, i kam njohur të pandehurit H.K., B.S. dhe S. B., të njëjtit kanë punuar në rajonin e lindjes, i pandehuri H. mesa më kujtohet ka qenë hetues i rajonit të lindjes që i përket H. të E., ndërsa unë kam qenë në pikën kufitare të H. të E., nuk më kujtohet a kam komunikuar me të pandehurin H. me datë 01.11.2013, ballafaqohet me deklaratën e datës 19.03.2014, në faqen e dytë të procesverbalit, ju në pyetjen se “Kush ka lajmëruar për ti ndaluar I.A. dhe Q.K. të ndalin dhe të informohen hetuesit e rajonit të lindjes në K. ju jeni përgjigjur “H.K. më ka thirr në telefon dhe më ka thënë se kur të vijnë I.A. dhe Q.K. ti ndalim dhe”, dëshmitari sqaron për gjykatën se po masi kam thënë ashtu, ashtu është pasi që I.A. dhe Q.K. kanë qenë persona të njohur se janë banor afër pikës kufitare në fshatin ..., dhe masi na ka thënë i pandehuri H. se të njëjtit duhet me u ndalu ne i kemi ndalu, pra i kanë ndalu zyrtarët e kontrollit kufitar, nuk më kujtohet biseda me të pandehuri H., vetëm se më kujtohet që është kërkuar nga ana ime që ata persona të ndalohen, ballafaqohet me deklaratën e datës 19.03.2014 në polici në faqen e tretë në pyetjen se “a keni ditur arsyen e ndaljes së tyre, a të ka thënë H. se a janë dëshmitarë apo të dyshuar për ndonjë rast” përgjigja juaj ka qenë “H.K. më ka thënë se ata persona duhet të ndalen se duhet të intervistohen në cilësinë e personave të dyshuar”. dëshmitari sqaron për gjykatën se po është e vërtetë ajo çka kam thënë siç deklarova edhe më lart qëndroj pranë atyre deklaratave, me pas ka deklaruar se H.K.

ka qenë njëri ndër policët me të mirë në rajon ka pas shumë raste dhe ka zbuluar shumë raste kriminale, po ashtu i pandehuri B.S. sa ka qenë në mbikëqyrjen time nuk ka pas asnjë shkelje nga ana e të pandehuri B., ka qenë një ndër policët më të mirë, ndërsa në seance e shqyrtimi gjyqësor të datës 29.05.2015 ka deklaruar me datë 01.11.2013, më ka kontaktuar i pandehuri H.K. në telefon dhe ka kërkuar që të ndalohen personat I.A. dhe Q.K. nëse vin në pikën kufitare, nuk ma ka treguar arsye e ndalimit, e as në çfarë cilësie do të n dëgjohen këta dy persona, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta me deklaratën e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë policisë së Kosovës-DHKO-Prishtinë me datë 19.03.2014, ka deklaruar se i pandehuri H.K. më ka thane se ata persona të ndalen se duhet të intervistohen në cilësi të dyshuarve.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, ka deklaruar se me datë 01.11.2013, më ka kontaktuar i pandehuri H.K. në telefon dhe ka kërkuar që të ndalohen personat I.A. dhe Q.K. nëse vin në pikën kufitare, nuk ma ka treguar arsye e ndalimit, e as në çfarë cilësie do të n dëgjohen këta dy persona, gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektivë, reale dhe të sinqertë.

Dëshmitari S. M. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.04.2022, ka deklaruar e kam një objekt që e kem leshu me qira në vitin 2013, e ka marr N. L., në atë objekt ka pasur këpucë me shumicë dhe po kam pas kontratë dhe e ka paguar me rregull qiranë, ndërsa vend parkingun e kam lëshuar me qira për një person ama emri nuk më kujtohet, vetëm më kujtohet se mi ka dhanë 100 euro për qira në muaj ka qenë me një veturë e markës “Pikap”, i njëjti e ka lanë veturën aty dhe kohë pas kohe ka ardh e ka marr, qëndroj pranë deklaratës të dhënë në polici, atëherë e kam pas me të freskët ngjarjen tani nuk me kujtohen detajet, pasi që dëshmitari kthehet nga salla që të bëjë identifikimin e të pandehuri K. K., deklaroi se nuk e njoh, e njoh I., ndërsa të pandehuri tjerë nuk i njoh, pasi që N. e njoh përmes I., pasi që i njëjti përpara e ka pas të njëjtin objekt me qira dhe kur e ka lëshuar e ka pru N., nuk më kujtohet saktë por ka qenë periudha menjëherë pas luftës N. ka qenë me qira një kohë të gjatë, ka bajt mall me shleper, ndërsa K.K. nuk e di çfarë kohëzgjatje e ka lanë veturën me qira te unë, dikun afërsisht ka qenë më shumë se 6 muaj, ndërsa N. dhe K. kurrë nuk i kam pa bashkë, nuk kanë qenë qiraxhi të mi në të njëjtën kohë, në ditën kur ka ndodh kontrolli i policisë, K. përpos veturës ka pas mall edhe në oborr, ndër strehë, malli të cilin e kanë marr policia ka qenë në shup të druve dhe ka qenë i K., ndërsa në deklaratën e dhënë pranë policisë së Kosovës-DHKO-Prishtinë me datë 23.12.2013, ka deklaruar se e njoh K.K. e ka kërkuar nga unë që tja lëshojë vendin me qira, dhe kemi arritur marrëveshje në muajin majtë të vitit 2013, për shume prej 50 euro në muaj ku ai e bien mallin atu së paku 2-3 herë në javë, janë paketa dhe qese të zeza sa kam muajt me pa ka pas këpucë, dhe malli që është konfiskuar nga policia në podrum ka qenë i K.K., atu mall binin dhe dy apo tre persona dhe nuk ja di emrat, pasi që unë kam pas punë vetëm me K. n e jo me ta.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, që ka deklaruar se e njoh I., ndërsa të pandehuri tjerë nuk i njoh, pasi që N. e njoh përmes I., pasi që i njëjti përpara e ka pas të njëjtin objekt me qira dhe kur e ka lëshuar e ka pru N. me qira në vitin 2013 për një kohë të gjatë, i njëjti ka bartur mallë –këpuca me shlipera, ndërsa në pjese e deklaratës se nuk e njoh K.K. ndërsa qëndron pran deklaratës në polici që ka deklaruar se K.K. nuk e di çfarë kohëzgjatje e ka lanë veturën me qira te unë, dikun afërsisht ka qenë më shumë se 6 muaj dhe kemi arritur marrëveshje në muajin majtë të vitit 2013, për shume prej 50 euro në muaj, ku ai e bien mallin atu së paku 2-3 herë në javë,

si paketa dhe qese të zeza sa kam muajt me pa në to ka pas këpucë si dhe malli që është konfiskuar nga polica në podrum ka qenë i K.K., atë mall binin dhe dy apo tre persona dhe nuk ja di emrat, gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitari dhe gjen se dëshmitar ka lëshuar lokalim me qira të pandehurit N. si dhe një pjesë të shupës për veturën e të pandehurit K., andaj gjykata dëshmi e dëshmitarit të lartcekur e gjen si të sinqertë, objektive, reale që gjene mbështetje në provat materiale.

Dëshmitari N. B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.05.2015 ka deklaruar, se të pandehurit I.A. dhe K.K. i kam kushëri të afërt dhe atë jemi në 3 - 4 breza, e njoh të pandehurin K.K. dhe e njoh H.N., pasi që unë me profesion jam vozitës i kamionit kam transportuar mall prej qytetit të Sh. në drejtim të H. të E., ndërsa nuk kam transportuar asnjëherë mall për I.A. dhe K.K., më kujtohet se kam dhënë deklaratë në polici dhe jemi dëgjuar në të njëjtën kohë me N., por se N. ka qenë në një dhomë tjetër e unë në një dhomë tjetër, kur i është lexuar deklarata H. N. nga ana e policit ka qenë dera hapur dhe kam dëgjuar se është përmendur emri I. dhe nuk kam njohuri se H. ka bartur mall për K.K. dhe I.A., pas të njëjtës përgjigje prokurori e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë me datë 27.01.2014 në polici, në faqen e dytë, reshti i parafundit në pyetjen e policit dëshmitari ka pranuar se H. punon për I. dhe Q., dëshmitari përgjigjet se unë nuk e kam ndryshuar deklaratën të cilën e kam dhënë në polici, po ashtu deklaroi se nuk ka njohuri se K.K. dhe I.A. janë marr me kontrabandim malli apo me ndonjë vepër tjetër, po ashtu e njofton gjykatën se në ditën kur është marr në pyetje në polici ka qenë prezent i pandehuri H.K. dhe nga i njëjti nuk jam njoftuar për deklaratën e dhënë nga H.N., por siç e cekta edhe më lart se H.N. e ka lexuar deklaratën me zë, dera zyrës ka qenë e hapur dhe unë e kam dëgjuar se çka ka lexuar, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoratit policor të Kosovës (IPK), me datë 27.01.2014, ka deklaruar se me datë 01.11.2013, janë intervistuar për kontraband në piken kufitare nga i pandehuri H.K. i cili ka qenë me një police tjetër nuk ja di emrin dhe unë ju thash se nuk më interesojnë këto pune se unë 5-6 vite unë voziti me kamion dhe nuk me interesoj pune e tjera, atë ditë është marr në pyetje edhe kojshia ime H. N., dhe kur ju ka lexua deklarata ka qenë dera hapur dhe e kam dëgjuar se ka deklaruar se ban mall për I. dhe Q., dhe unë me pas i kamë njoftuar të njëjti si ka deklaruar H. me arsyen se të njëjtit të paraqiten në polici për me shikuar se çka është në pyetje, ndërsa në deklaratën e dhënë pranë policisë së Kosovës-NJHR Lindje, me datë 01.11.2013, ka deklaruar në cilësi të dëshmitarit për rastin N.N.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, që ka deklaruar se më kujtohet se kam dhënë deklaratë në polici dhe jemi dëgjuar në të njëjtën kohë me N., por se N. ka qenë në një dhomë tjetër e unë në një dhomë tjetër, kur i është lexuar deklarata H. N. nga ana e policit ka qenë dera hapur dhe kam dëgjuar se ka deklaruar se ban mall për I. dhe Q., dhe unë me pas i kamë njoftuar të njëjti si ka deklaruar H. me arsyen se të njëjtit të paraqiten në polici për me shikuar se çka është në pyetje, nga e njëjta deklaratë gjykata vlerëson se të pandehuri I. A. dhe Q. K. nuk kanë qenë të njoftuar vetëm nga i pandehuri B.B. që të paraqiten në polic sipas kërkesës së të pandehurit H.K., por dëshmitari N. i ka njoftuar të pandehurit I. dhe Q. për përmbajtjen e deklaratës së dëshmitarit H., të njëjti kanë qenë të përgatitur dhe nuk kanë pranuar asgjë në lidhje me atë që ka thënë dëshmitari i H., dhe sqaron për gjykatën se në ditën kur është marr në pyetje në polici ka qenë prezent i pandehuri H.K. dhe nga i njëjti nuk jam njoftuar për përmbajtjen e deklaratës e dhënë nga H. N., por të njëjtën vetë e ka dëgjuar në rrethanë të lartcekura, andaj gjykata gjen se nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorisë se i pandehuri H.K. ju ka ndihmuar të pandehurit I.A. dhe Q. K. dhe i ka intervistuar në cilësi të dëshmitarëve në rastet NN, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale që gjene mbështetje në provat materiale.

Dëshmitari S. D. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.05.2015 ka deklaruar, se i njeh të gjithë të pandehurit që janë prezent në këtë çështje penale në veçanti R.T. e kam kojshi, unë merrem me tregti e kam shitoren ushqimore në H.të E. ku jam pronar i asaj shitore, të pandehurit K.K. dhe I.A. i njoh se janë myshteri të dyqanit tim kur kanë pas nevojë kanë ardhur në dyqan, po ashtu edhe të pandehurin S. B. ka qenë myshteri i imi, por ka ndodhur se a kërkuar edhe para nga unë kur atij ju kanë nevojitur, është e vërtet se S. B. ja kam dhënë 20.00 euro pasi që i njëjti mi ka kërkuar, por ka ndodh edhe më përpara ja kam dhënë nga 20.00 euro hua dhe në fund të muajit mi ka kthye, ballafaqohet me deklaratën e dhënë në polici me datë 24.01.2014, në faqen e dytë të deklaratës, ju jeni përgjigjur se fillimisht ka ardhur S. dhe ka kërkuar nga unë ami 20.00 euro, se I. më ka thënë që ti marr te ju, ju jeni përgjigjur unë mendova se S. po më rren sepse edhe I. disa herë i kam dhënë para por nuk mi ka kthyer dhe është dashur si me zor me ja nxjerr paratë e mia e pastaj thirri K.K. dhe më tha jepja i kallxova se veç paratë e bukës i kam dhe pasi që K. ka qenë myshteri më i mirë unë ja dhashë paratë S.i dhe të njëjtën ditë K. mi ka kthyer 20.00 euro që ja dhashë S., ndërsa sa i përket se të hollat ja ka kthyer K. e jo S.i dëshmitari sqaron se K. më tha me ja dhanë, se ti kthej por çka kanë bërë S. dhe K. mes veti unë nuk e di, më pas ka deklaruar se unë të pandehurin S. B. e njoh qe 10 vite, ka ndodh që i pandehuri S. B. ka kërkuar para nga unë, të njëjtat mi ka kthyer, asnjëherë smë ka mbetur borxh dhe ato para nuk i ka lypur si polic por mi ka lypur si myshteri dhe si qytetar i E. H., ndërsa në deklaratën e dhënë pranë Inspektoratit policor të Kosovës (IPK), me datë 24.01.2014, ka deklaruar se unë e përdor numrin e telefonit ..., qe 10 vite, i lexohet traskripti i bisedës me K.K., deklaroi se ju kujtohet biseda, se ka ardhur S. më ka thënë ami 20 euro se I. me tha mi marre, unë mendova që S.i po më rrenë se I. disa her mi ka marr para nuk mi ka kthye është dashtë si me zorë mi nxjerr parat e mia, pastaj më thirri K.K. dhe me tha jepja, pasi që K. ka qenë myshteri ma i mire unë ja dhashë parat S., dhe të njëjtën ditë K. mi ka kthyer 20 euro që ja dhashë S.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, ka deklaruar se të pandehurit K.K., I.A. dhe S. B. i njoh se janë myshteri të dyqanit tim kur kanë pas nevojë kanë ardhur në dyqan, ka ndodh që i pandehuri S. B. ka kërkuar para nga unë, të njëjtat mi ka kthyer, asnjëherë smë ka mbetur borxh dhe ato para nuk i ka lypur si polic por mi ka lypur si myshteri dhe si qytetar i E. H., ka ndodhur një herë ka ardhur i pandehuri S. më ka thënë ami 20 euro se i pandehuri I. me tha mi marre, unë mendova që S. po më rrenë se i pandehuri I. disa her mi ka marr para nuk mi ka kthye është dashtë si me zor mi nxjerr parat e mia, pastaj më thirri i pandehuri K.K. dhe me tha jepja, pasi që i pandehuri K. ka qenë myshteri ma i mire unë ja dhashë parat të pandehurit S.it, dhe të njëjtën ditë i pandehuri K. mi ka kthyer 20 euro që ja dhashë të pandehurit S.it, si janë marrë vesh ata une nuk e di, andaj gjykata vlerëson se i pandehuri S. e njeh dëshmitarin S. që 10 vite, dhe nuk është hera e pare që ka marrë pare hua nga i njëjtit, ka marr edhe disa here tjera para dhe parat gjithherë ja ka kthyer dëshmitarit S., ndërsa gjykata nuk gjen mbështetje në provat material për parat e marr në vlerë prej 20 euro ku i pandehuri S. ja merr dëshmitarit S., të njëjta para ja kthen brenda ditës i pandehuri K., pasi që nuk vërteton pretendime e prokurorisë ka marrë ryshfet, sepse për marrje e ryshfeti janë të përcaktuar elemente e veprës penale, që në rastin konkret as që ekzistojnë andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë.

Provat

Gjykata vlerëson se Aktvendimin e Doganës të Kosovës 04.2.3.1/167, të datës 10.03.2012, për të pandehurin I.A., është përgjegjës sepse me datë 30.03.2012, nuk ka paraqitur për ç doganim

mallin-mbathje të ndryshme për femra dhe meshkuj në sasi prej 229 palë, në vlerë prej 1,300 euro, pran zyrës doganore të H. i E., mirëpo nga ana policisë në magjistralen K.-F. është ndaluar vetura me targa ..., të cilën e drejtonte N.K. dhe pas kontrolli është hasur mall pa dokumentacion, andaj komision për kundërvajtje doganore i shqipërohet gjobë në shumë prej 5.000.00 euro. Aktvendimi i Doganës së Kosovës dhe 04 - 2.3.1/534 të datës 30.08.2012, për të pandehurin I.A. është përgjegjës sepse me datë 27.07.2012, Policia e Kosovës –Stacion policor në vijë të gjelbër pas ndalimi të veturës së markës “Golf II” me tabela ..., të cilën e drejtonte I.A. dhe pas kontrolli është hasur duke kontrabandu mall nga M. në K., mbathje të ndryshme në sasi prej 79 palë, në vlerë prej 680.00 euro, pa dokumentacion, me çrast ka kryer kundërvajtje doganore i shqipërohet gjobë në shumë prej 380.00 euro. Aktvendimi i Doganës së Kosovës 04.2.3.1/521 të datës 05.08.2011 për të pandehurin B.B., është përgjegjës sepse me datë 05.07.2011, në magjistralen H. i E.-P. pas ndalimi të veturës së markës “WV –pick-up”, me tabela ..., të cilën e drejtonte i njëjti , dhe pas kontrolli është hasur duke kontrabandu mallë mbathje të ndryshme për femra dhe meshkuj, në vlerë prej 684.00 euro, pa dokumentacion, me çrast ka kryer kundërvajtje doganore, i shqiptohet gjobë në shumë prej 5.000.00 euro, në bazë të lartcekurave gjykata gjen se për të pandehurin I.A. kanë transportuar mall të pandehurit N.K. dhe B.B.

Vlerësohet raporti informues i DHKO në Prishtinë për leximin e SMS hyrje – daljeve të numrit ... për të pandehurin B.B., të datës 07.08.2013, me transkripte, nga transkriptet lidhur me komunikimet telefonike është vërtetuar se i pandehuri B.B. në raportet informuese për leximin e SMS të datave 06.08.2013, 07.08.2013, në nr. telefonit të tij ... dhe ..., kemi të bëjmë me shitëblerjen e mallit veshjet dhe duhan, si dhe lexohet raporti informues i DHKO për leximin e SMS hyrje – daljeve të numrit ..., të pandehurit B.B., të datës 07.08.2013 me transkriptet, nga provat e mbledhura nga transkriptet lidhur me komunikimet telefonike, është vërtetuar se i pandehuri B.B. në nr. telefonit të tij ... dhe ..., vërtetohet se ai ka pasur komunikime me numrat të ndryshëm të telefon që nuk është bërë identifikimi se kush i ka përdor ata numra, por gjykata vlerëson se krejt përmbajtja e komunikimit ka qenë lidhur porosit, sasinë, ngarkimin dhe me shitblerjen e mallrave si veshmbathjeve dhe duhan.

Nga raporti informues i DHKO për leximin e SMS hyrje-daljeve të numrit ..., për të pandehurin I.A. të datës 15.08.2013, me transkriptet të cilin janë bashkangjitur për periudhën kohore prej datës 01.08.2012 deri me datë 25.07.2013, vërtetohet se ka pasur komunikime me numrat të ndryshëm të telefon që nuk është bërë identifikimi se kush i ka përdor ata numra, por gjykata vlerëson se krejt përmbajtja e komunikimit ka qenë lidhur me shitblerjen e mallrave si veshmbathjeve dhe duhan.

Në raportin informues të DHKO për leximin e SMS hyrje – daljeve të numrit ... për të pandehurin K.K., të datës 15.08.2013, me transkriptet për periudhën kohore prej datës 01.08.2012 deri me datë 25.07.2013, vërtetohet se ka pasur komunikime lidhur me shitblerjen e duhanit, por edhe komunikim i datës 07.02.2013, rreth orës 14:36, me numrin e tel ...,citon ,”shko hjeke duhani te shtëpia ime se polici jam, që sipas shkresave të lëndës këtë numër e posedon R.T., gjykata vlerëson se bëhet fjalë në ditën e ndalimit-arrestimit të pandehurit R., si dhe bashkëpunimin e të pandehurit R. me të pandehurit K.K. lidhur me kontrabandimin e duhanit.

Nga raporti informues i DHKO për leximin e SMS hyrje-daljeve të numrit ... për të pandehurin R.T. të datës 15.08.2013, me transkriptet për periudhën kohore prej datës 01.08.2012 deri me datë 25.07.2013, vërtetohet se ai ka pasur komunikime lidhur me shitblerjen e duhanit, por edhe komunikim të datë 07.02.2013, rreth orës 14:36, me numrin e tel ..., me të pandehurin K.K., që citon „shko hjeke duhani te shtëpia ime se polici jam”, ka pasur komunikime me numrat të ndryshëm të telefon që nuk është bërë identifikimi se kush i ka përdor ata numra, por gjykata vlerëson se krejt përmbajtja e komunikimit ka qenë lidhur me shitblerjen e mallrave.

Nga raporti i vëzhgimit i DHKO, të datës 11.11.2013, me foto të pandehurve: B.B., N.K. dhe K.K., për intervalin kohor për datat 10.10.2013, 24.10.2013, 28.10.2013, 04.11.2013, dhe 06.11.2013, të cilat janë bashkangjitur foto e pikës së L. (te pulat), ku të pandehurit dërgojnë mall, si në fotot e të pandehurve B.B., N.K., duke ngarkuar mall në veturat e tyre në zonën industriale në tregun e F. K., në faqen 10 shihen edhe veturat e të pandehurve K.K. dhe B.B. duke shkarkuar mall në kompaninë „...”, në faqen 12 i pandehuri B.B. duke shkarkuar mall në firmën „...” në F., ndërsa me datë 06.11.2013 të pandehurit K.K. dhe B.B. kanë qenë në F. duke shkarkuar mallë, në faqen 15 shihen fotot e të pandehurit B.B. duke shkarkuar mall në firmën „...” në F., gjykata vlerëson se të pandehurit K.K., B.B. dhe N.K. në vazhdimësi kanë bartë mallra të kontrabanduar dhe kanë shpërndarë në firmat e lartcekura.

Nga raporti i vëzhgimit i DHKO, i datës 25.11.2013, për intervalin kohor për datat 11.11.2013, 12.11.2013, dhe 15.11.2013, me foto të pandehurve K. K., I.A., K.K. dhe B.B., të cilët janë bashkangjitur edhe foto nga vendi i quajtur “te pulat”, ku të pandehurit K.K. dhe I.A. kanë shkarkuar mallin, pastaj fotot në të cilën është vetura me mall te depo, në rrugën „...” në F., foto e të pandehurit K.K. duke shkarkuar mall në depo F.9, vetura e të pandehurit B. në Gj. duke dërguar mallin e kontrabanduar nga M., F 11, ku është paraqitur vetura pas shkarkimit të mallit dhe takimi i të pandehurve në „...” në Gj., shtëpia dhe oborri i të pandehurit Xh.R., ku të pandehurit K.K., I.A., B.B. etj dërgojnë mallin, gjykata vlerëson se të pandehurit K. K., I.A., K.K. dhe B.B., në vazhdimësi kanë bartë mallra të kontrabanduar nga M.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin K.K. të datës 02.10.2013, transkriptet rezulton se i pandehuri me datë 18.09.2013 ka komunikuar tri herë me të pandehurin B.B., nga të cilët vërtetohet se bëjnë vëzhgim dhe i tregojnë njëri tjetrit për rrugën, se a ka polic a jo, a ka vetura të dyshuara, nga biseda e datës 27.09.2013, K.K. i tregon B. se policia është te ura e K., në bisedën e dytë B. i tregon se e kanë ndalë policia e kanë vërejt se ka mall në kombi, gjykata gjen se në këto transkripta shumica e komunikimit në mes të pandehurve të lartcekur janë biseda që i tregojnë njëri tjetrit për rrugën se a ka polic a jo, me qëllim të kontrabandimit të mallrave pa dokumentacion.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin R.T. të datës 02.10.2013, nga transkriptet i pandehuri me datë 27.09.2013, bisedon lidhur me 20 pako me mall që vjen nga H. Më datë 30.09.2013, bisedon për shpërndarjen e mallit 16 pako. Më datë 01.10.2013, komunikimi është për kontrabandim e malli nga K.-M., për 1.400 kuti me mall për firmën “Studenti” në F. Më datë 02.10.2013, komunikimi është për 4 pako me mall. Më datë 27.09.2013, në ora 10:52:38, komunikon me një person me emrin H. i ka thënë R. “sot fola me

B. ama harrova mi kallxu qe edhe te B. nja 5 kutia”. Me datë 30.09.2013 në ora 17:45:14, zhvillohet biseda mes R. dhe personit PPM – B. dhe ky i thotë R. B. jam, R. i thotë 16 të A., 5 te M. Me datë 01.10.2013, në ora 17:15:28, i pandehuri R. dhe një person nga M. bisedojnë, ku PPM i thotë R. se shko te “Studenti” për pare me i pru me një lloj pagese nëse donë me ja pru kutit, ku PPM thotë se nëse ti bi 22 nga 0.80 cent, a nëse ti bi 18 nga 1 euro dhe R. e pyet se sa i ka te “Studenti”, PPM i thotë dikun 1.400. Me datë 02.10.2013, në ora 17:01:40, një PPM i thotë R. “hej nja 4 kutia i ki mall këtu bre”. Me datë 03.10.2013, në ora 14:00:00, B. i thotë R. nja 10 paketa i kam te “Studenti” dhe 2 paketa te “Aurora”, 2 paketa te “Euro Star” , 2 paketa te “Mantia” për kontraband në M. Në ora 15:09:08, R. i thotë një personi PPM “Eurostar i ki 2 copa edhe te L. mos harro, PPM “se jam tu e prit te B. tu i ba do gati”, R. “kush”, PPM” te “Mania”. Në ora 13:58:54, PPM i thotë R. “ee a e qove ata nja 10 paketa mi marr për te ktu te Studenti”, gjykata vlerëson se në bazë të këtij raportit të pandehurit B. dhe R. në vazhdimësi ka shitë, blerë , shpërndarë, transportuar mallra me persona të pa njohur.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin B.B., të datës 14.10.2013, nga transkriptet për intervalin kohor prej datës 17.09.2013 deri me datë 30.09.2013 i pandehuri bisedon lidhur me kontrabandimin e mallit si këpuca, duhan, kafe, tekstil etj dhe pastaj transportimi i mallit në F., K. dhe Gj., i pandehuri B. në këtë periudhë kohore ka pasur biseda me të pandehurin N.K. i quajtur “Daj”, me të cilin kanë kontrabanduar mallin, gjithashtu i pandehuri B. ka pasur komunikime edhe me të pandehurin R.T., nga të cilat rezulton se kur e ngarkon mallin në veturat e tyre, e përcjellin rrugën e njërit tjetrit për shkaqe sigurie mos po ndalohen nga policia, gjithashtu ndodhë ti ndërrojnë veturat gjatë transportimit të mallit të kontrabanduar, kështu me datë 20.09.2013, në ora 18:43:38, R. e pyet B., a i ke kqyr në fletore sa turra i kena me data 17,18,19, duke i thënë “a jena kanë dy herë a tri herë”, B. i thotë “se di kqyri ma vonë”. Me datë 23.09.2013, B. i thotë R. se i kanë marr 27 paketa te “Studenti”, edhe te Sh. paska diçka. Me datë 23.09.2013, në ora 16:13:12, R. i thotë B. “u mush te S. edhe u mush nja plot valla. Të njëjtën ditë në ora 16:56:45, B. i thotë R. se “hajt n’tunell jam veç tu dal prej tunellit hajt. I pandehuri B. në këtë periudhë kohore komunikon edhe me të pandehurin K.K. me nofkën “...” lidhur me transportimin e mallit në F., K., Gj. dhe anasjelltas, gjykata gjen se të pandehuri e lartcekur gjatë rrugës përcjellin njëri tjetrin, kur janë ngarkuar me mall të kontrabanduar, me datë 24.09.2013, i pandehuri B. kontakton të pandehurin Q.K., i tregon se ku ka pako me mall, i pandehuri Q. kërkon sqarim nga i pandehuri B. se ku dhe qysh e ka dërguar mallin, gjykata gjen se i pandehuri B. ka transportua mallra edhe për të pandehuri Q. (që gjendet në arrati).

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin I.A., të datës 02.10.2013, nga transkriptet për periudhë kohore prej datë 17.09.2013 deri me datë 02.10.2013, rezulton se ka komunikuar me të pandehurin K.K., K.K., B.B. lidhur me kontrabandimin e duhanit, si dhe vështrimin dhe vëzhgimin gjatë gjithë kohës të rrugës dhe kufirit, hyrje dhe dalje të kufirit, transportet e mallit nga H. E. për K., F. dhe Gj., gjatë kësaj kohe i pandehuri I. komunikon edhe me të pandehurin T.C. lidhur me transportimin e mallit përmes malit, nga komunikimet mes të pandehurve I. dhe B.R. (që gjendet në arrati), të datës 27.09.2013, në ora 09:42:19, 28.09.2013, në ora 13:12:13 dhe 08:56:18, rezulton se ata bisedojnë lidhur me mallin, me ç’ rast I. ia jep numrin e telefonit te cili person me marr mallin, me datë 27.09.2013, në ora

09:42:11, i pandehuri B.R. i thotë I. “shko te kombi merri paketa këta (mallin) i len “te pulat” dhe “nuk e di kur për porosinë tjetër veç i thotë po duke me dal mi marr apet te Q.”. Nga komunikimi i datës 28.09.2013, në ora 13:12:13, rezulton se të pandehurit I.A. dhe B.R. bisedojnë lidhur me të holla dhe I. i thotë “jo, jo sjam kanë mi marr jo”, ndërsa B. përgjigjet “kqyr merri te Q. i kum que”, ku Q. është i pandehuri Xh.R. Me datë 30.09.2013 në ora 08:59:08, i pandehuri B. i dërgon nr. të telefonit ..., që i pandehuri I. për me kontakti një person i caktuar nga B., në bazë të raportit të lartcekur gjykata vlerëson se i pandehuri T.C. ka bartë kontrabandu mallra me kali për gjatë vijës kufitare sipas kërkesës së pandehurit Imer, po ashtu nga ky raport gjejmë se sipas mbrojtje së pandehurit Xh.R. kemi kuptuar se B. R. është kushërinë i tij dhe nuk ka njohuri se i njëjti çka punon, ndërsa Q. është vëllai i tij, dhe ka sqarua asnjëherë nuk kam bërë marrëveshje me as një person për me pru mall në oborrin e shtëpisë së tij dhe me marr malli dhe nuk ka njohuri për veturën që kanë hyr në oborrin tij në bazë të fotove të vëzhgimit të vlerësuar më lartë nga gjykata, andaj gjykata gjen se në bazë të këtij raporti të përgjimeve i pandehuri Bajram ka kërkuar nga i pandehuri I. që mallin ta dërgoj te Q.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin I.A., të datës 21.10.2013, nga transkriptet për periudhën kohore prej datës 02.10.2013 deri më datë 17.10.2013, ka pasur komunikime me të pandehurit K.K., K.K., B.B., T.C. dhe Q.K., ashtu që i pandehuri K.K., me datë 05.10.2013 në ora 21:06:59, e pyet I. “a ka najsen për Gj.” kurse I. përgjigjet “për sonte jo”. Me datë 07.10.2013 në ora 09:48:34, K.K. e pyet I. “sa copa i ke ngarku”. Me datë 07.10.2013, në ora 18:08:49, K.K. e pyet I. “a ka najsen për sonte”, kurse I. i përgjigjet “ta kqyri se di a ka ardh Q. mos po bjen najsen”. Biseda mes të pandehurve I.A., K.K. dhe B.B. prej datës 02.10.2013 deri me datë 17.10.2013, ka qenë kryesisht lidhur me kontrabandimin e mallrave. Me datë 10.10.2013 në ora 20:48:12, I. komunikon me T.C. dhe I. e pyet “a ka najsen” dhe T. i thotë se “policia i ka zëmë kuajt” dhe I. e pyet se “a tonet apo të juvet”, T. i thotë “t’juvet”, në ora 20:53:20, I. i thotë T. se “7 - 8 mijë euro kanë hupë me këtë rast, gjykata gjen se i pandehur T. e njofton të pandehurin I. se nga policia ju kanë zënë kuajt se bashku me mall, që kanë qenë duke kontrabandu mallra në mënyrë ilegale.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin K.K. të datës 21.10.2013, nga transkriptet për periudhën kohore prej datës 02.10.2013 deri me datë 17.10.2013, ka komunikuar me K.K.n, nga të cilat vërtetohet se ata kontrabandojnë mallin nga M. në K. dhe anasjelltas dhe gjatë kontrabandimit të mallit përcjellin rrugën, me datë 04.10.2013, në ora 09:32:06, K.K. i thotë K.K. se “hajde te kufiri se e kam me i ngarkua për te R.”, të njëjtën ditë në ora 14:29:10, K. K. i thotë K.K. “qoe te dyqani edhe paketën a po ma bjen te S.”, gjykata gjen se të pandehurit K.K. dhe K.K. kanë kontrabandu mallra dhe të njëjtit mall e kanë dërguar në depo te i pandehuri R. si dhe në shupen-mbulojen te dëshmitari S., ku sipas dëshmisë së njëjtit dëshmitar ka sqarua se i pandehuri K. K. e ka lanë me qira një veturë së bashku me mall, ku mallin e binte ai edhe dy persona tjerë nuk ja di emrin, si dhe i ka vendos disa paketa nërstre, e kanë parë se kanë qenë këpuca dhe ju kanë konfiskuar nga ana e policisë pas kontrollit.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin R.T. të datës 18.10.2013, nga transkriptet për periudhë kohore prej datë 02.10.2013 deri me datë 17.10.2013, ka pasur komunikime me të pandehurit I.A. dhe K.K., me datë 08.10.2013, gjatë bisedës I. i

tregon R. se e kanë zënë një kali me dy qese të mëdha të zeza në mal në vijën e gjelbër kufitare, me datë 08.10.2013, në ora 12:29:04, PPM i thotë R. “a bon naj turr”, R. përgjigjet “nuk e di”. Në ora 15:47:16, R. i thotë PPM se “boni nja 50 copa gati se qe po nisum”. Me datë 11.10.2013, në ora 17:55:49, K. K. i thotë R. “a ki shumë ti”, R. përgjigjet “kam, kam, full jam”, K.K. “po hajde po nisna se unë kam mas pakti”. Me datë 17.10.2013, në ora 12:52:39, R. i “sa copa janë”, PPM “16 paketa për M.”. Në ora 18:49:10, PPM “a ke pru nej nja”, R. “e kum pru nja full kështu edhe nja me bosa”, gjykata gjen se të pandehurit R.T., I.A. dhe K.K. në vazhdimësi merren me kontrabandim të mallrave dhe duhanit.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 21.10.2013, nga transkriptet në periudhën kohore 01.10.2013 deri me datë 17.10.2013, ka komunikuar me persona tjerë për kontrabandim mallrave.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 21.10.2013, nga transkriptet në periudhën kohore prej datës 01.10.2013 deri me datë 17.10.2013, ka komunikuar me të pandehurit K.K., R.T., Q.K., K.K., N.K. dhe I.A. Komunikimet mes të pandehurve B. L. dhe K.K. janë zhvilluar kryesisht lidhur me përcjelljen e rrugës, kur kanë pasur mall për transportim, nga bisedat mes të pandehurve B. dhe R. kuptohet se i pandehuri R. i jep urdhra të pandehurit B. si duhet të vepron, mirëpo të dy bashkëpunojnë kur kemi të bëjmë me transportimin e mallit, përcjelljes së rrugës për shkaqe sigurie, nga biseda telefonike mes të pandehurve B.B. dhe Q.K., rezulton se i pandehuri Q. kujdeset për mallin që do të transportohet nga M. në K. dhe anasjelltas. Nga bisedat telefonike mes të pandehurve B.B. dhe K.K. rezulton se transportojnë mallra të ndryshme: këpuca, duhan, tekstil etj, gjatë transportimit të mallit bëjnë vëzhgimet gjatë rrugës se a ka polic në rrugë. Nga komunikimet mes të pandehurve N.K. dhe B. L. rezulton se së bashku kanë sjell mall deri në treg të P., gjatë transportimit të mallit së bashku kanë përcjellë rrugën. Me datë 05.10.2013, në ora 13:12:28, të pandehurit B. L. dhe K.K. komunikon mes veti, dhe në pyetjen e B. ”çka ka të re”, K. përgjigjet “paketat i kam dy paketa edhe kejt duhan e kam q... nanën veç mos e bo zot me t’nal kejt duhan..”. Me datë 09.10.2013, në ora 23:44:01, B. bisedon me I.A., dhe I. e pyet B. “ ai murr 100 a ja qove”, B. përgjigjet “jo more si qova”, dhe gjatë bisedës I. i thotë “çka po nervozohesh he burrë unë jam shef... a po mendon se unë milionat jam tu i fitua”, gjykata vlerëson se i pandehur K. gjatë një transporti të mallit ka pas të kontrabanduar vetëm duhan, ndërsa të pandehurit tjerë të lartcekur kanë bërë kontrabandim me mallra sepse në vazhdimësi kanë përcjell rrugën se mos po ndalohen nga policia.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 05.11.2013, nga transkriptet në periudhën kohore prej datës 18.10.2013 deri me datë 02.11.2013, ka komunikuar me të pandehurin K.K. dhe nga këto biseda vërtetohet se i pandehuri B. i jep llogari të pandehurit K.K., se sa pako i ka të mallit ku me dërgua mallin. Me datë 20.10.2013, në ora 16:35:47, i pandehuri B. tregon të pandehurit K. a i ka sjellë 20 pako dhe i tregon se afër K. e kanë ndalur policia me radar. Me datë 23.10.2013, në ora 18:47:10, B. i thotë K. se R. ka pas edhe tekstil. Me datë 25.10.2013, i pandehuri K. ia ka përcjellë rrugën të pandehuri B. gjatë transportimit të mallit të kontrabanduar. Me datë 29.10.2013, në ora 10:15:05, R. i tregon I. “po katër edhe ja kum marr te ai 6”, I. “ehe veç pak 4”, R. “katër ja kum marr ni ven”. Me datë

01.11.2013, B. i tregon K.së se është në F. i ka 32 pako me kombi i ka sjellë në H. të E. dhe ata (mendohet sipas raportit policor për të pandehurit I.A. dhe Q.K.) duhet me shkuar me u lajmëruar, pastaj i ka thënë se sigurova punën me atë shoqin (mendohet sipas raportit policor për të pandehurin H.K.). I pandehuri B. ka komunikuar edhe me të pandehurin Q.K., kështu me datë 18.10.2013, Q. e pyet B. se a e ka sjellë qatë thesin mbrëmë, ndërsa B. i tregon se K. e ja marr mbrëmë. Në bisedën tjetër Q. i thotë “pse ke thënë se janë 36 pako, e këtu po dalin 39, kurse B. përgjigjet “nuk e di i kam shënuar në fletë, në mbrëmje të tregoj se mua veç 18 mi ka dhënë “Hiti”. Gjatë bisedës me të pandehurin N.K. me datë 21.10.2013, N. i tregon B. se një turr me mall që kanë për ta kontrabanduar është duke ja sjellë në F. dhe ka çizme, sandale dhe dy kese tekstil, me datë 24.10.2013, gjatë bisedës vërehej se është bërë përcjellja e rrugës, kur kanë qenë të ngarkuar me mall dhe se fshihen në mes të kamionëve ose pas kamionëve gjatë rrugës, me datë 26.10.2013, N. i thotë B. që me ardh në P. me marr mall, me datë 31.10.2013 në ora 14:36:15, 16:58:00 dhe 17:26:06, B. i thotë N. se “a ka vend për nja dy pako ka të vish nga P. me i marr në F., pastaj B. ia përcjellë rrugën N., me datë 18.10.2013, i pandehuri B. ka komunikuar me të pandehurin R.T., me ç’ rast R. i thotë B. që të shkon me marr kombin e R. dhe të niset për në F. me marr mall, B. i tregon se nja 6 copa i ka “Hiti”, 4 copa i ka H., i tregon se te “...”, vjen malli më vonë dhe R. i thotë se duhet me prit, me datë 30.10.2013, B. i thotë R. se “a më the me shku te “Riveri” dhe “Campioni” në F. me marr mall dhe i tregon se janë gjithsej 18 pako, me datë 31.10.2013, R. i thotë B. qe ta thirr Q. e le ti tregon se nja 30 thasë kanë qenë në M. dhe B. i thot i kamë treguar K., gjatë komunikimit me K.K. me datë 29.10.2013, B. e pyet K. se “a po mundësh me i marr të gjitha” dhe K. i thotë “jo, vetëm dy pako të mëdhaja më kanë mbetur” dhe B. i thotë “ok se po vi unë me i marr pra te S.”, gjykata gjen se më pas të pandehurit K.K., N.K. dhe B.B., nisen me vetura nga F. në drejtim të H. të E. për të kontrabanduar mallra.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 04.11.2013, nga transkriptet në periudhën kohore prej datës 18.10.2013 deri me datë 02.11.2013, ka komunikuar me persona tjerë të panjohur për kontrabandim të mallrave.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin H.K., të datës 07.11.2013, me transkriptet, ku kuptohet se i pandehuri H. me datë 01.11.2013, i njofton eprorët e vet se ka mi intervistua dy persona të dyshuar me emra I. A. dhe Q.K., si dhe për komunikimin me zyrtarin policor B. për ndalimin në kufi të personave të lartcekur, gjatë kontaktimi me eprorin e tij i thotë “mos po i hajn foret e po tregoj kush u kanë tu i bajë (mall në vijën e gjelbër kalim ilegal), në atë kohë, eprori i thotë “a ka fotografi diçka a janë fotografua, H. i thot., jo bre nuk ka kurrëgjë fotografi hiq, nuk vërehet asgjë hiq”, ku gjykata vlerëson se të njëjtën rrethanë e ka pohuar edhe i pandehuri H. në mbrojtën e tij si dhe dëshmitari E. M. mbikëqyrësi ti tij i dëgjuar në këtë çështje penale ka deklaruar të se ka qenë i njoftuar nga policia se fotot që janë bërë në vijën kufitare nuk është vërejtur asgjë, nuk ka mundë të identifikohet as një person.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin I.A., të datës 07.11.2013, nga transkriptet në periudhën kohore prej datës 18.10.2013 deri me datë 02.11.2013, ka komunikuar me të pandehurit K.K., K.K., B.B., N.K., B.R., Q.K. Me datë 18.10.2013, në ora 00:43:21 dhe 02:49:39, i pandehuri I. bisedon me të pandehurin K.K. lidhur me transportimin e mallrave në depot, kështu i pandehuri I. e dërgon mallin në depon e të pandehurit R.T., kurse i

pandehuri K.K. në depo te K., nga bisedat me datë 22.10.2013, rezulton se ata duhet te ja dërgojnë 26 kese duhan në Gj. të pandehurit B.R., nga bisedat me datë 23.10.2013, ora 00:10:50, 00:25:54, 00:31:11, 09:12:36, 10:23:25, 18:02:58 dhe 22:07:30, rezulton se ata kanë kontrabanduar mallin nga M. në K. në orët e hershme të mëngjesit dhe bisedat e mëvonshme kuptohet se e kanë dërguar mallin në F. me katër vetura, nga biseda e datës 26.10.2013, në ora 09:14:34 dhe 22:50:12, mes të pandehurve I. dhe T.C., rezulton se i pandehuri I. bisedon me të pandehurin T. për 200 euro që i ka thënë të pandehurit T. dikujt të ia jep për ti nxjerrë kuajt që ia kanë zënë me mall të kontrabanduar, i pandehuri I. i thotë mos u ngut me i dhanë paret se kuajt janë në D. Me data 24.10.2013 dhe datë 28.10.2013, i pandehuri I. përsëri ka pasur biseda me të pandehurin B.R. lidhur me shitblerjen e duhanit të kontrabanduar, gjykata vlerëson se në raportin e lartcekur kuptohet se i pandehuri B.R. kushërini i të pandehurit Xh.R., ka kontaktuar me të pandehurit I.A. lidhur me shitblerjen e duhanit të kontrabanduar, planifikoj se duhet te ja dërgojnë 26 kese duhan në Gj. te i pandehuri B.R.

Nga transkriptet që janë bashkangjitur raportit të datës 21.11.2013, e pranuar në prokurori me datë 25.11.2013, (ceket data e pranuar në prokurori për arsye se e njëjta datë është konsiderua si datë e raportit), rezulton se i pandehuri I.A. me nr. të telefonit të tij ..., në periudhën kohore prej datës 03.11.2013 deri me datë 15.11.2013, ka komunikuar me të pandehurin K.K. dhe me datë 03.11.2013, nga këto biseda kuptohet se i pandehuri I. ka transportuar pizhame në sasi prej 1.370 palë, me datë 06.11.2013, të pandehurit I. dhe T.C. bisedojnë për të kontrabanduar mallra në rrugë të ndryshme ilegale, i pandehuri I. përmend ai alternativ që mallrat të kontrabandohen nëpër Lyboten, por i pandehuri T. nuk pranon duke i arsyetuar se tereni i shtirë, me datë 13.10.2013, i pandehuri Q.K. i thotë të pandehurit I. “a me nis T. e katër kuaj të ngarkuar me mallra, gjykata gjen se në vazhdimësi të pandehurit I. A., K.K. dhe T.C. janë marr me kontrabandim të mallit nga M. për në K., në rrugët ilegale përgjatë vijës së gjelbër kufitare ku transporti është kryer me kuaj nga i pandehuri T.C.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin K.K., të datës 08.11.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.11.2013, me transkriptet për periudhën kohore prej datës 18.10.2013 deri me datë 02.11.2013, ka komunikuar me të pandehurin B.B.n në lidhje me vëzhgimin dhe kontrabandimin e mallrave, me datë 21.10.2013, ka komunikuar me të pandehurit R.T. ku i pandehuri K. i tregon për rrugën dhe i thotë një herë le të rrinë se një kerr shkoj teposht, gjykata gjen se gjatë përgjimeve ka komunikuar edhe me persona tjerë të pa njohur lidhur me kontrabandim të mallrave.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin R.T., të datës 11.11.2013, me transkripte në periudhën kohore prej datës 18.10.2013 deri me datë 02.11.2013, pranuar në prokurori me datë 12.11.2013, rezulton se me data 19 dhe 22.10.2013, komunikon me të pandehurin K.K. në lidhje me vëzhgimin dhe kontrabandimin e mallrave, me datë 29.10.2013, ka komunikuar me të pandehurin I.A. bisedoj për marrjen e paketave në vendet e ndryshme, gjykata vlerëson se po ashtu gjatë përgjimeve ka komunikuar edhe me persona tjerë të pa njohur për kontrabandim të mallrave.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin K.K., të datës 18.11.2013, i pranuar në prokurori me datë 25.11.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 03.11.2013 deri me datë 16.11.2013, ka komunikuar me një person PPM me datë 08.11.2013 dhe K. e pyet atë se “a mos e pe veturën 5-she”, kurse PPM i thotë “jo veç 6-qe, ish kanë tu shku, ku sipas vlerësimi të gjykatës 5-she dhe 6-she janë vetura “Golf” e Policisë me targa civile.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin R.T., të datës 20.11.2013, pranuar në prokurori me datë 25.11.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 03.11.2013 deri me datë 16.11.2013, ka komunikuar me të pandehurit K.K. dhe K.K., gjykata gjen dhe vlerëson se biseda ka të bëjë me vëzhgimin e rrugës nga policia për kontrabandimin e mallit, dhe mshefja e mallit në vendet e caktuar pastaj përcjellja për destinacionin e caktuar.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 19.11.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 03.11.2013 deri me datë 15.11.2013, ka komunikuar me të pandehurin K.K. me datë 06.11.2013, me ç’ rast K. e thirr B. dhe i thotë se ato 10 paketa dhe dy kese me tekstil i dërgon te “...”. Me datë 15.01.2013, në ora 15:27:23, Q.K. i thotë B. “a e ki numrin e “...” dhe sa paketa i ka” dhe B. i thotë “hajt”, Q. i thotë B. “nëse i ka për një kerr shko merrri” dhe B. i thotë “hajt”. Me datë 06.11.2013, R.T. i thotë B. se te Xh. janë pak dhe te S. janë do 4 copa dhe 8 te njeri dhe këqyr se mos po merr edhe H. naj kundër, të pandehurit e cekur në këtë raport kanë komunikuar për kontrabandimin e mallrave.

Nga raporti i vëzhgimit i DHKO të datës 02.12.2013 për periudhën kohore nga data 16.11.2013 deri më 01.12.2013, me foto të pandehurve B.B., K.K. dhe H.K.. Nga raporti i vëzhgimit me data 16.11.2013, 01.12.2013, 02.12.2013, të cilët janë bashkangjitur edhe foto, shihet K.K. te “...” në Gj. me një person PPM, të cilët kanë qenë në Gj. dhe kanë dërguar mall, kurse te “...” shihen duke dal dhe duke hypë në veturë. Me datë 18.11.2013, janë foto te “...” dhe “...” në F., ku shihet B.B. së bashku me një PPM duke shkuar te “...”. Me datë 21.11.2013, janë foto te “...”, pastaj takimi mes B.t dhe H.K.t, foto 11. Shihet H.K. duke e shikuar nga jashtë brendësin e kombit, i njëjti e ka pohuar edhe në mbrojtjen e tij se ka takuar të pandehurin B. në tregun në F. K.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 09.11.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 01.12.2013, i pandehuri B.B. me datë 21.11.2013, i tregon R.T. se 100 pako me mall, pako 12-she ishin te firma “...”, e R. i thotë “eja pim kafë shkojmë më vonë i marrim”. Në ora 09:37:10, B. bisedon me R. për 1000 palë këpucë dhe e diskutojnë për çmimin. Në ora 09:39:17, B. i tregon R. se 490 palë këpucë janë të 19 euro, pastaj R. bisedon me pronarin e “...” dhe janë dakorduar për me transportu mallin, për një palë këpucë 1 euro. Në ora 08:32:22 dhe 09:00:06, pronari i “...”, i trego B. se i ka gati 100 pako, 12 duhet me i dërgua, veç kërkon me ia bë gati dhe me i dërgua më shpejt ngase ka me i marr paratë, gjykata gjen se në të gjitha këto biseda flitet për ngarkim mallit përcjellje të rrugës dhe dërgim e mallit deri në H. të E.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., të pandehurin N.K., të datës 03.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me 30.11.2013, rezulton se me datë 18.11.2013, në ora 12:46:48, një person PPM - Nderimi i thotë N.K. “ai Sh. i G. i ka 2 kese te unë mos harro me ardh me i marr poshtë te dera”. Me datë 26.11.2013, në ora 12:52:54 PPM i thotë N. “hazder i ki te S. 4 kese 800 euro i ki”. Me datë 29.11.2013, në ora 11:06:05, një person i thotë PPM i thotë N. “Kemqja 16 k 2600 vl te kinezi”. Me datë 22.11.2013, në ora 19:31:40 PPM i thotë N. “Kemqja 14 kese vl 1920 e. R. 6 kese vl. 1220 e. I. 3 ks 445 e. Me 25.11.2013, në ora 18:01:33, N. i thotë Q.K. se “F. 1 ks. 1440. M. 8 KS 3 nalt vl 780 eu. K. 8 ks 1500 merja 371 eu unë kam garant R. 21 ks 4 nalt vl 5730 eu, gjykata gjen se të pandehurit e cekur në këtë raporte merren me transportin e mallrave.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin Q.K., të datës 03.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 30.11.2013, i pandehuri Q. ka komunikuar me të pandehurit K.K. dhe K.K. , gjykata gjen se biseda ka të bëjë me vëzhgimin e rrugës nga policia për kontrabandimin e mallit, i pandehuri Q.K. ka komunikuar me të pandehurin N.K. , biseda ka të bëjë me për kontrabandimin e mallrave, ndërsa komunikimi me të pandehurin T.C. është se i njëjti barte mall ilegalisht me kali përgjatë vijës së gjelbër kufitare nga M.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin I.A., të datës 03.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 30.11.2013, ka komunikuar me të pandehurit K.K. me datë 16.11.2013, në orët (10:25:00, 10:29:36, 10:41:43, 10:37:25, 11:13:57, 21:02:56, 22:18:47, 23:19:09), nga këto biseda mesë të pandehurve I. dhe K. konfirmohet kontrabanda për Gj. e njëkohësisht edhe në pikën kufitare si dhe bëhet vështrimi i rrugës. Me datë 22.11.2013, në orën (22:27:44), në këtë bisedë K. i tregon I. se gjendet lartë dhe se është duke e pritur T., i tregon se një kali e kanë nisë për kontrabandë me mall. Me datë 25.11.2013, në orën (11:24:41), në këtë bisedë I. i tregon K. se ju është lajmëru Rr. dhe i ka thënë se për 1000 kg duhan me ja transportuar prej Sh. në E. H., nëse pranon 50 cent kg, ti lajmërohet. Në ora 11:26:56, K. i kthen sms I. “i thuaj 60 cent deri te shpia e Rr.”, I.A. nga numri i tij ..., telekomunikon me numrin ..., K. K. Me datë 16.11.2013, në orët (10:18:33, 10:21:14, 10:35:01, 11:19:26), në bisedën e parë dyshohet se të pandehurit e lartcekur e kanë lënë kombin te P. poshtë dhe çelësat e tij i ka lënë brenda, e gjithashtu dyshohet se policia është afër kombit. Me datë 20.11.2013, në orët (13:50:16, 15:28:22, 15:37:26), biseda e parë konfirmon rastin që i kanë zënë të pandehurit B.B. dhe K.K. te guri i shpëmë, kurse i pandehuri K.K. ja konfirmon se po shkon me marr ndonjë informatë në polici te një shok i tij. I pandehuri I.A. nga numri i tij ..., telekomunikon me numrin ..., të pandehurin B.B. ka pas këto telekomunikime të rëndësishme. Me datën 16.11.2013, në orët (10:27:09, 10:34:41, 10:38:03, 20:44:53, 22:17:11, 23:20:18), në bisedat e paradites kanë komunikuar për përcjellje mos është ndonjë e veturë e policisë dhe kush po i pret ndërsa është e sigurt se ka pas mallra të kontrabanduara të ngarkuar. Në bisedat e pasdites B. i tregon I. se i ka thanë ai shoqi (polici), se deri në ora 11:00, muj me punu nuk ka asnjë problem por pas orës 11:00, nuk munden me punu, gjykata gjen se në këtë raporte nuk është interpretim se ai shoqi është i pandehur me emër të caktuar vetëm ceket se është policë, po ashtu nga ky raport gjejmë

se të pandehurit e cekur janë marrë me kontrabandimin e duhani nga Maqedoni për në Kosovë në mënyrë ilegale.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin T.C., të datës 03.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 30.11.2013, rezulton se me datë 23.11.2013, në ora 23:15:51, i pandehuri T.C. komunikon me të pandehurin Q.K. lidhur me kalimin e kufirit përmes malit me kuajt të ngarkuar me mall, dhe T. i thotë “po do me thonë ni kal osht kah tetë ni kal o kah non”, Q. “tridhetë e pesë i kam atje dy kual te poshtë”. Me datë 26.11.2013, në ora 19:06:25, Q. i thotë T. “a po nishesh me katër”, T. “me sa”, Q. “me katër prej atje nat”. Me datë 30.11.2013, në ora 19:02:57, K.K. i thotë T. “nja 26 copa duhan pastaj edhe do për punë tjera i kie”, gjykata gjen se i pandehuri T. në vazhdimësi bartë mall, duhan me kuaj përgjatë pikës kufitar ilegalisht, me kërkesë e të pandehurve K. dhe Q.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B., të datës 04.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 30.11.2013, i pandehuri me datë 20.11.2013, komunikon me numër të tel ... e kontakton H. K., i njëjti i thotë B. se jemi tu të përcjellë në teren, me datë 29.11.2013, B. e pyet H. për qata sot, dhe H. i thotë ta shohim bahet, gjykata gjen se nga përmbajtja e bisedës nuk kuptohet se për çka bahet fjalë.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin K.K., të datës 10.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 01.12.2013, rezulton se me datë 24.11.2013, në ora 18:12:06, i pandehuri K.K. i thotë K.K. “a kena me shkue për Gj.”, K.K. i përgjigjet “po po por edhe në F. kena me shkue se tu ardh osht ai prej Sh.”. Me datë 26.11.2013, në ora 22:49:14, K.K. i thotë K.K. se “policia e kanë zanë një kal me mall”. Me datë 02.12.2013, në ora 10:06:45, K.K. e pyet K.K. “a e ki numrin e atina duhanin qe ja qojshmi në P.”, gjykata gjen se të pandehurit K.K. dhe K.K. në vazhdimësi kontabandojn duhan.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit 044-227-743, të pandehurin R.T., të datës 10.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 01.12.2013, nga transkriptet, rezulton se i pandehuri R.T. me datë 11.11.2013, në ora 19:35:37, i thotë B. “te B. sa copa i ke mar be”, B. “5 edhe 8=13”. Me datë 02.12.2013, në ora 10:50:14, R. i thotë B. “hej Studenti me thirri edhe Hiti dhe veç e merr kombin”. Me datë 21.11.2013, në ora 22:37:49, R. bisedon me K.K. lidhur me 15.000 euro, me ç’ rast K. i thotë “hajt se kqyri mos ta nin ty”, gjykata gjen se të pandehurit e lartcekur kanë komunikuar për kontrabandimin e mallrave.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin K.K., të datës 10.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 12.12.2013, nga transkriptet në periudhën kohore nga data 15.11.2013 deri me datë 01.12.2013, rezulton se i pandehuri K.K. me datë 16.11.2013, në ora 10:57:26, 11:12:09, 11:32:56, 12:30:37, 17:17:49, ka komunikuar me të pandehurin B. lidhur me kontrabandimin e mallit për në Gj. duke i treguar njëri tjetrit sa a ka

kontroll policore rrugës, po ashtu i tregon B. ku me shkarkua mallin. Me datë 21.11.2013, K. e pyet B. ku je dhe ai përgjigjet se “është duke shkuar në F. me kombi sepse kanë me i marr nja 1,200 pare te “...” në F. dhe me i sjell në H. të E. Me datë 16.11.2013 në ora 10:13:04, 10:45:17, në bisedën PPM e pyet K. sa a jeni nis me ardh në Gj. dhe K. i thotë jemi duke u ngarkuar. Në bisedën dytë PPM i thotë dërgojnë ju mallin atje “te pulat” në Gj. dhe thirreni atë gruan aty ju jep paret se unë nuk jam atu bon vaki dhe nuk mundemi mu taku. Në vendin “te pulat” në Gj. është shtëpia e të pandehurit Xh.R. dhe në oborrin e të pandehurit K.K. etj, sjellin mallin – duhan, gjykata gjen se komunikimi i të pandehurit K. me personi PPM –i panjohur që i thotë “ thirreni atë gruan aty ju jep paret se unë nuk jam atu bon vaki dhe nuk mundemi mu taku”, nuk dihet kush është ky person ,me qenë se e kanë dërgua mallin te pulat në oborr e të pandehurit Xh. R. ndërsa personi në komunikim ka qenë i pa njohur-i pa identifikuar sipas këtij raporti.

Nga raport informues i DHKO lidhur me të pandehurin B.S. të datës 23.12.2013, me transkriptet, përdor numrin e telefonit ..., dhe komunikon me të pandehurin K.K. në numër të telefonit ..., me datë 29.11.2013, në ora (00:04:46, 00:29:03, 00:30:26, 00:30:50, 00:32:10, 00:38:16, 00:39:13, 00:40:40, 00:43:27, 00:45:01, 01:47:06, 12:32:46), gjatë tërë kohës ka shkëmbim të sms-ve në mes të PPM dhe K., ku PPM i thotë se “unë jam nalt me kerr dhe vazhdo” kurse K. i thotë “ok se po shkoj ma nalt. Në bisedën e fundit K. i tregon se është duke ardhur nga Gj. dhe PPM i thotë se “unë jam në S.” dhe Kardia i thotë “a po takohemi qaty ku pimë kafe atë ditë” dhe PPM i thotë ”ani”. Me datën 14.12.2013, në ora (18:04:16), B. i tregon K.së se është duke u bërë gati për të shkuar në punë dhe shihemi sonte kah ora 12:00 ose 01:00 (pas mesnate). Me datën 14.12.2013, në ora (20:17:58), B. i thotë se “a nuk po munesh me dal aaa”, dhe “unë jam te B. (restorant)2, dhe K. i thotë “për 3 minuta jam aty”. Me datë 17.12.2013, në ora (12:03:17), i dërgon një sms K. nga numri ..., (zyrtarë të policisë), dhe i shënon “të lutem më thirr”. Me datë 17.12.2013, në ora (12:03:17), K. e thirr dhe B. i thotë “pse nuk më thirre në atë numrin tjetër Z-Mobile” dhe “dërgomi 2 euro se nuk kam me të thirr në atë numër”, K. i thotë se “jam në Gj. dhe ka të kthehem të takoj”. Me datë 17.12.2013, në ora (12:37:18), K.K. ia dërgon një sms I.A. dhe i shënon numrin ..., epja 50 euro. Me datë 17.12.2013, në ora (15:05:54), K. i tregon se ka ardhur në E. H. dhe së bashku me B. e lajme me u taku te B., gjykata gjen se i pandehuri B. në cilësi të personit zyrtar ka keqpërdorur detyrën zyrtare për përfitim për tjetrin ashtu që me datë 29.11.2013 ka komunikuar përmes sms me të pandehurin K. të njëjtit i ka mundësuar kontrabandim me mall në mënyrë ilegale.

Nga raport informues i DHKO lidhur me të pandehurve K.K., I.A. dhe B.R. të datës 23.12.2013, ku në të njëjtën datë rreth orës 09:30 minuta, përmes masave të fshehta është kuptuar se të pandehurit I. A. dhe K.K. gjenden në Kosovë dhe se do ta kryejnë një kontabandim malli, nr.25 për P. dhe 25 për Gj., ku të njëjtit kanë takuar të pandehurin T.C. dhe kanë bërë ngarkesën me mall dhe më pas nga H.i E. janë nisur katër vetura të cilat i kanë vozitur të pandehurit B.B. dhe I.A. me veturën e markës “Golf”, ngjyrë e kaltër e mbyllët me targa ..., më pas i pandehuri K.K. me veturën e markës “Golf”, ngjyrë e kaltër e mbyllët me targa ... Vetura të cilat e kishin ngarkesën ishte vetura e të pandehurit K.K. e markës “Vento”, me targa ..., dhe vetura e të pandehurit K.K. e markës “Golf”, ngjyrë e kaltër e mbyllët me targa ... Gjatë përcjelljes së të njëjtave vetura, një nga veturat vërejt se është në përcjellje të policisë dhe të njëjtat tenton që t’iu shmangen policisë, po me urdhër të policisë ndalohen të njëjtat, fillimisht i pandehuri I.A.

më pas edhe i pandehurit K.K. ku në veturë kishte një sasi të duhanit prej 250 kuti, pas ndalimit të dyshuarve të lartcekur nga ana e policisë, dhe pas kontrollit të njëjtëve ju sekuestrohen automjetet si dhe malli i kontrabanduar.

Vlerësohet vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve të sendeve për të pandehurin B.R. të datës 23.12.2013, sekuestrohet një copë letra në të cilën letër janë cekur disa emra dhe shuma të parave, një telefon i markës “Nokia”, ngjyrë hiri me numër të valës ..., një telefon i markës “Nokia”, ngjyrë hiri me numër të Serbisë ..., vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve për të pandehurin I.A. të datës 23.12.2013, i sekuestrohet një pasaportë e M. me numër serik ..., një pasaportë e M. në emër të vëllait të tij me numër serik ..., një librezë e veturës me numër ..., një telefon i markës “Nokia”, ngjyrë të zezë me numër të valës ..., edhe një telefon i markës “Nokia”, ngjyrë të bardhë me numër ...

Vlerësohet raporti informues i DHKO për sekuestrimin e veturës për të pandehurin B.B., si dhe vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve të tij të datës 23.12.2013, po të njëjtën datë në bazë të urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me datë 20.12.2013, pas një kontrolli të realizuar në shtëpinë e të pandehurit B.B., kemi gjetur se i pandehuri B.B. me të parë policinë kishte dal nga dritarja e dhomës së tij dhe ishte arratisur, e vlerësuar në bazë të shikimit vizuel nuk kishte sasi të paketuara me mall të kontrabanduar në shtëpinë e tij, kemi biseduar me vëllain e B. me emrin B. L., i njëjti ka pranuar që të sjell në stacionin policor veturën e markës “Pasar”, me ngjyrë vishje metalike me targa ..., që është në pronësi të pandehurit B.B., të njëjtit i kemi lëshuar vërtetim për sekuestrim të veturës, çelësin me alarm dhe librezën e veturës me numër ... Në vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve të tij të datës 23.12.2013, është sekuestruar përkohësisht vetura e markës “Pasar”, me ngjyrë vishje metalike me targa ..., çelësi i veturës me alarm dhe librezë e veturës me numër me numër Nr. ..., që është në pronësi të B.B.

Vlerësohet raporti i DHKO mbi kontrollin e shtëpisë së të pandehurit T.C. dhe procesverbal mbi kontrollin e personit dhe banesës, të datës 23.12.2013, po të njëjtën datë në bazë të urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me datë 20.12.2013, pas një kontrolli të realizuar në shtëpinë e të dyshuarit T.C. në rrugën “...” p.nr, tek i dyshuar është konfiskuar një telefon celular i markës “Nokia”, me një sim kartelë.

Vlerësohet raporti i kontrollit i DHKO për të pandehurin R.T., procesverbal mbi kontrollin e personit dhe banesës, dy vërtetime për sekuestrim të përkohshëm të gjësendeve dhe foto-dokumentacioni, në bazë të urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me datë 20.12.2013, pas një kontrolli të realizuar në shtëpinë e të dyshuarit R.T., i njëjti nuk ka qenë në shtëpi, dhe pas kontrollit në garazhën e tij janë sekuestruar tri paketime me nga 12 palë këpucë, një fletore shënimesh NTT “...”, 2013, ngjyrë e zezë, një kupon me numër ..., lista të ndryshme me emra të firmave dhe numra të telefonave, një faturë me numër ..., si dhe një qese e vogël e dyshuar me substancë narkotike e llojit “marihuanë”, e cila është gjendur në veturën furgon pronë e R.T., ndërsa në vërtetimin për sekuestrim të përkohshëm të gjësendeve i datës 23.12.2013, janë sekuestruar përkohësisht një pako me këpucë numër 51, një pako me këpucë N46A.

Vlerësohet mendimi i Doganës së Kosovës - Sektori i Vlerës për përcaktimin e vlerës doganore 03.4.8.356, të datës 24.12.2013, rezulton se vlera e mallit të sekuestruar (mbathje) me rastin e bastisjes së shtëpisë së dëshmitarit S. M. nga F., është 1,480.00 euro, dhe këto mallra kanë qenë pronë e të pandehurve I.A. dhe K.K.

Vlerësohet raporti informativ i Doganës së Kosovës - Sektori i Kontrollit pas-importuese nr.04.3.3/875 të datës 24.12.2013, lidhur me depon e shtëpisë së S. M., pas një kontrolli afër kompanisë “...” në rrugën “...”, në F., në afërsi të saj ka qenë një depo e vogël, pronar i shtëpisë është S. M., i njëjti deklaroj se malli që është në atë depo është i të pandehurit K.K., i njëjti mall është sekuestruar përkohësisht.

Vlerësohet raporti informues i DHKO për të pandehurin N.K. të datës 24.12.2013, skica e veprimeve të pandehurve që i është bashkangjitur kërkesës të DHKO të datës 26.12.2013, është konstatuar se në të njëjtën datë nuk është bërë kontrolli i shtëpisë së të dyshuarit N.K., duke u bazuar në informatat nga masa e fshehtë është kuptuar se i njëjti në atë moment nuk gjendet në shtëpi, dhe duke dashur se ky i dyshuar të mos kuptoj se policia ka prova materiale të mos arratiset pasi që i njëjti për momentin është në arrati, ndërsa sa i përket skica e veprimeve të pandehurve që i është bashkangjitur kërkesës të DHKO të datës 26.12.2013, është përkohësisht një skicë nga ana e zyrtarëve policor për përshkrimin e roleve të dyshuarve në këtë çështje hetimore penale.

Vlerësohet raporti informues i DHKO për sekuestrim të përkohshëm të datës 26.12.2013, me foto-dokumentacion, ku është konstatuar se janë sekuestruar katër vetura të dyshuarve si në vijim: vetura e të pandehurit I.A. e markës “Golf”, ngjyrë e kaltërt e mbylltë, me targa ..., si dhe foto të veturës, vetura e të pandehurit K.K. e markës “Golf”, ngjyrë e kaltër e mbylltë me targa ..., ku në të kishte një sasi të duhanit prej 250 kg, si dhe foto të veturës, vetura e të pandehurit K.K. e markës “Vento”, me targa ..., ku në kishte sasi të duhanit prej 250 kuti duhan si dhe foto të veturës dhe mallit, vetura e markës “Pasa”, me ngjyrë vishje metalike me targa ..., që është në pronësi të pandehurit B.B., si dhe fotot e veturës. Gjykata vlerëson se konfiskimi i veturave të lartcekura është bërë për arsye se gjatë zbatimit të masave të fshehta të përgjimit dhe vëzhgimeve të njëjtat vetura janë përdorura për bartjen e mallrave të kontrabanduara.

Vlerësohet raport informues i DHKO lidhur me të pandehurin N.K. të datës 31.12.2013, dhe vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve për të pandehurin N.K., në këtë raport është konstatuar se me datë 09.01.2014, i pandehuri N.K. është paraqitur në mënyrë vullnetare pranë Stacionit Policor, i njëjti sipas urdhrit të prokurorit është ndaluar dhe nga i njëjti është sekuestruar një telefon i markës “Nokia 6300”, me numër të kartelës vala ..., me numër serik ..., është lëshuar vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

Vlerësohet raport informues i DHKO për të pandehurin R.T. i datës 09.01.2014 i pranuar në Prokurori me datë 10.01.2014, me foto, ku me datë 23.12.2013, rreth orës 12:15, në bazë të urdhërësës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me datë 20.12.2013, pas një kontrolli të realizuar në shtëpinë e të dyshuarit R.T., zyrtarët policor kanë konstatuar se R. nuk gjendet në shtëpi, e kanë bërë identifikimin e numrit të telefonit ..., të cilin numër e ka përdor R.T., dhe e

kanë njoftuar përmes telefonit R. se gjendemi në shtëpinë e juaj për të kryer një kontrollë, R. është përgjigjur se “kontrolloni çka të doni sepse momentalisht nuk gjendem në shtëpi, por në D.”, ku në bazë të masave të përgjimeve është konstatuar se abonenti i atij numri të telefonit gjendet në qytetin H. të E., dhe në bazë të informatave të marra i njëjti ka angazhuar edhe persona tjerë të afërm që ta përcjellin situatën nga afër.

Vlerësohet vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të gjësendeve për të pandehurin R.T. të datës 09.01.2014, sekuestrohet kombi me targa ..., ..., çelësin e veturës me alarm, librezën e veturës ..., një telefon i markës “Nokia”, me sim ... Imel ... Gjykata vlerëson se konfiskimi i kombit së lartcekur është bërë për arsye se gjatë zbatimit të masave të fshehta të përgjimit dhe vëzhgimeve i njëjti kombi është përdorur për bartjen e mallrave të kontrabanduara.

Vlerësohet raport i DHKO për vlerën e materialit të sekuestruar të datës 13.01.2014, se me datë 23.12.2013, gjatë realizimit të planit operativ janë sekuestruar gjësende të ndryshme me vlerë. Në flagrancë janë kap 500 pako duhan që llogaritet të jenë (500 kg duhan), kjo sasi e duhanit është sekuestruar në dy vende të ndara (Gj. dhe P.).a. Në Gj. janë sekuestruar duhani në veturën e të pandehurit K.K., 250 pako kuti duhan dhe dy veturat janë njëra e të pandehurit K.K. dhe tjetra e të pandehurit I.A. b. Në P. nga i pandehuri K.K. është sekuestruar sasi prej 250 pako - kuti duhan dhe vetura e tij në të cilën kishte duhanin. c. Veturë tjetër është sekuestruar edhe vetura të pandehurit B.B.t, kjo veturë është sekuestruar sepse edhe më parë nga vëzhgimet se është përdorë për kontrabandë me mallra. d. Veturë tjetër që është sekuestruar është kombi “...”, parë nga vëzhgimet se është përdor për kontrabandë me mall. e. Te depo fiktive të cilën edhe pronari në intervistën e tij e ka deklaruar se është e të pandehurit K.K., janë sekuestruar 876 palë mbathje të ndryshme.1. 500 kg duhan, vlera e tyre sipas mendimit të sektorit të vlerës pranë doganave është 2,041.00 €, vlera e duhanit në total.2. Vetura e të pandehurit K.K. “...”, viti i prodhimit 1998, 1.9 dizel, me targa ..., në vlerë 888 €. 3. Vetura e të pandehurit I.A. “...”, viti i prodhimit 2002, 1.9 dizel, me targa ..., në vlerë 1,900 €. 4. Vetura e të pandehurit K.K. “...”, viti i prodhimit 1996, 1.9 dizel, me targa ..., në vlerë 1,084 €. 5. Vetura e të pandehurit B.B. “...”, viti i prodhimit 1994, 1.9 dizel, me targa ..., në vlerë 780 €.6. Vetura e të pandehurit R.T. “...”, 2.2 dizel, me targa ..., në vlerë 1,100 €. 7. Në depo fiktive të pandehurit K.K. në F., në rrugën “...”, janë sekuestruar rreth 876 palë mbathje të ndryshme, dhe vlera totale është 1,480 €. Sqarim: Pika 1, vlera totale në euro e gjësendeve të sekuestruara që është kap në flagrancë është 9,273 €, vlera është fleksibile edhe mund të rritet. I. Malli i cili konsiderohet se është i kontrabanduar përfshi të gjitha kompanitë në të cilat është zbatuar urdhëresa për kontrolle në vlerë totale është rreth 11,000 palë, vlera totale është rreth 17,500 €. II. Mall për të cilin konsiderohet se kompanitë tek të cilat është bërë kontrolli duke ju shmangur tatimit të brendshëm dhe i kanë shkaktuar dëm buxhetit të shtetit të Kosovës rreth 111000 palë mbathje, vlera totale në të holla është rreth 53,472 €.

Vlerësohet raport informues i DHKO lidhur me sekuestrimin e veturës së të pandehurit N.K. të datës 15.01.2014, me foto dhe vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve të datës 15.01.2014, i dyshuari N.K. me datë 15.01.2014, është paraqitur në Stacionin e H. i E., aty ju sekuestrohet vetura e markës “...” me targa ..., ngjyrë hiri, ..., çelësin e veturës, librezën e veturës ..., të njëjtit ju ka lëshuar vërtetim për sekuestrim të përkohshëm. Gjykata vlerëson se konfiskimi

i veturës së lartcekur është bërë për arsye se gjatë zbatimit të masave të fshehta të përgjimit dhe vëzhgimeve të njëjta vetura është përdorura për bartjen e mallit të kontrabanduar.

Vlerësohet raporti i DHKO të datës 21.01.2014, me dokumentacione përkatëse, i pandehurit R.T. ka ndërmarrjen tregtare NT "...", me numrin e biznesit 70221270, në detaje i bashkëngjiten të gjitha dokumentit e firmës, i pandehuri N.K. ka ndërmarrjen tregtare NTP "...", me numrin e biznesit ..., në detaje i bashkëngjiten të gjitha dokumentit e firmës.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ... për të pandehurin N.K. të datës 03.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, transkriptet që janë bashkëngjitur raportit rezulton se i pandehuri N.K. me datë 03.12.2013 në ora 14:27:23 ka komunikuar me një person PPM i cili i ka thënë "Dajo 1000 e te A. e ki speaking (anglisht e folne). Me datë 10.12.2013 në ora 16:33:19 një PPM komunikon me N., PPM "kqyr M. i ja dhanë 250 killa për mue e nesër ti bin ata nesër bini veç qomi atje poshtë a u ba". Nga këto komunikime vërtetohet se ata kanë biseduar lidhur me duhanin e kontrabanduar. Me datë 17.12.2013, në ora 09:20:45, N. "i ki do sene qetu n'F. K. a munesh me ardh me i marr", PPM "çka", N. "diqka prej Sh. a ki porosit met pru". Me datë 03.12.2013 në ora 18:40:57, N. komunikon me Q.K. "K. 13 kese te djet R. 10 kese vlera 1,800 euro, N. 10 kese vl 1,000, I. 4 kese te djet Sh. 17 kese - 10 nalt vlera 3820 euro". Të njëjtën ditë në ora 18:40:59, N. përsëri komunikon me Q. "M. 3 thasë vl 510 euro". Me datë 04.12.2013, në ora 17:49:45, N. komunikon me Q. "Z. 10 pak vlera se di, Sh. 10 kese te djet T200, 2 kese vl 500 euro". Me datë 05.12.2013, në ora 19:59:55, N. komunikon me Q. "R. 2 ks 480 e I. 1 pak 273 e Sh. 50 thasë 16 janë nalt". Me datë 11.12.2013 në ora 16:58:09, Q. e pyet N. se sa paketa i ka marr N. i thotë 7 paketa po ishin të mdhaja dhe nja e K. është". Me datë 03.12.2013, në ora 13:13:33, N. i thotë një PPM "vallahi qe veç sa ska mri njeri te ti me i marr 5 kutia aty", gjykata vlerëson se i pandehuri N.K. ka transportuar mall ilegalisht për të pandehurin që gjendet në arrati Q.K., të njëjtin e ka njoftuar për dërgesat dhe vlerën e mallrave.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin Q.K. të datës 24.12.2013, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, në periudhën kohore prej datës 30.11.2013 deri me datë 28.12.2013, ka komunikuar me të pandehurin N.K., biseda ka të bëjë për kontrabandimin e mallit, pasi që i pandehuri N. është punëtor i të pandehurit Q. që e banë mallin e kontrabanduar nga M. dhe e shpërndan në K., në qytetet si P., F. si dhe te personat e ndryshëm, i pandehuri Q.K. ka komunikuar me të pandehurin T.C., i njëjti barte mall ilegalisht me kali nga M., dhe i pandehuri Q. i tregon se kur ka ma kaluar kufirin, po ashtu i pandehuri Q. K. komunikon edhe me të pandehurin I.A., gjykata vlerëson se biseda ka të bëjë me për kontrabandimin e mallit me kuaj në vijën e gjelbër kufitare në mënyrë ilegale.

Raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin R.T., të datës 10.01.2014, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, në periudhën kohore prej datës 01.12.2013 deri me datë 23.12.2013, nga transkriptet që janë bashkëngjitur rezulton se me datë 14.12.2013, në ora 19:23:43, R.T. komunikon me K.K., K. çka me i thanë 50 paketa te Roma a i ke marrë a jo, R. jo more qfari për pak shkoj se edhe Q. tha se çmimi i dobët tha leje krejt kaja nanën, K. po po amo Q. ja paska dhanë 3000 euro garanci në Sh. me ti lyp mallin, R. kujna ja paska lanë, K. ati të R. ja paska lanë, R. çka me bo, K. hajt se shkon nesër me i marr pra. Me

datë 21.12.2013 në ora 21:00:47 komunikon R. dhe K.K. lidhur me 120 kg e duhanit të kontrabanduar. Të njëjtën ditë në ora 21:44:53, komunikon R. me I.A., gjykata gjen se komunikim bëhet lidhur me ngarkimin e mallrave të kontrabanduar, si dhe mënyrën e përcjelljes së mallit.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin K.K. të datës 10.01.2014, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, nga transkriptet që janë bashkangjitur rezulton se i pandehuri K.K. në periudhën kohore prej datës 01.12.2013 deri me datë 23.12.2013, ka pasur komunikime me të pandehurit R.T., K.K., I.A. dhe disa persona PPM, përkitazi me mënyrën e kontrabandimit të mallrave, ikjen nga policia, ku duhet të dërgohet malli.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B. të datës 23.01.2014, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, në periudhën kohore prej datës 01.12.2013 deri me datë 24.12.2013, nga transkriptet që janë bashkangjitur raportit rezulton se i pandehuri B.B. me 21.12.2013 në ora 21:40:14, ka komunikuar me të pandehurin I.A., me ç' rast B. i thotë I. a me shkarkuar a me prit dhe I. i thotë me prit se kemi me shkuar atje, pra në Gj. me dërgua duhan. Të njëjtën ditë në ora 23:18:03, nga komunikimi mes të pandehurve B. dhe R.T. rezulton se edhe R. ka dërguar mall të kontrabanduar në Gj. Me datë 23.12.2013, në ora 13:48:20, i pandehuri Xh.R. i thotë të pandehuri B. se “unë jam nga Gj. ai qe po vini te unë dhe tregoi ati koleges tënd se mua më ka hy policia dhe mos të gabon me ardh”, gjykata vlerëson se i pandehuri Xh. e njofton të pandehurin B. në sms e lartcekur dhe kërkon që të mos shkojn tek ai, andaj gjykata me edhe me largët në detaj i ka vlerësuar rrethanat të njëjta për të pandehurin Xh.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin I.A. të datës 23.01.2014, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, në periudhën kohore prej datës 01.12.2013 deri me datë 24.12.2013, nga transkriptet që janë bashkangjitur raportit ka pasur komunikime me të pandehurit T.C., K.K., B.B., N.K., B.R., B.S., R.T. Gjykata gjen se nga komunikimet mes të pandehurve I. dhe T. vërehet qartë roli i të pandehurit T. i cili së bashku me disa persona të tjerë ka kontrabanduar mall në dy drejtime nga K. në M. dhe anasjelltas përmes vijës së gjelbër me kuajt. Me datë 14.12.2013 në ora 11:57:37, dhe 17.12.2013, në ora 12:22:25, I. ka komunikuar me B.R. lidhur me shitblerjen e duhanit të kontabanduar, me ç' rast B. i tregon “une a e di ku jam te kjo shpia kha ku hishmi kanihere si ta kaloish kishën po qe jam nis për anejna ku po ki qef mu zatat”. Me datë 20.12.2013, në ora 09:34:40, I. komunikon me K.K., me ç' rast I. i thotë K. “hajde te R. edhe ngarkojmë qat duhan 20-20 jan”. Me datë 22.12.2013, në ora 17:28:36, te dytë komunikojnë lidhur me një turr “200 a e ke pas 20 copa”, kurse B. përgjigjet “o krejt në rregull e di unë ata”, gjykata vlerëson se të pandehurit e cekur në këtë raporte janë marrë në vazhdimësi me kontrabandimin e mallrave dhe duhanit.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin T.C. të datës 28.01.2014, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, rezulton se i pandehuri T.C. në periudhën kohore prej 01.12.2013 deri me 23.12.2013, ka komunikuar me të pandehurit Q.K., K.K. si dhe me persona të tjerë, gjykata vlerëson se nga këto komunikime vërtetohet kontabandimi i mallrave të pandehurve iu është bërë si punë rutinore, janë përmendur edhe lokacionet ku kontrabandohet malli. Nga këto prova rezulton se personat janë të pandehurit I.A.,

Q. dhe K.K., pastaj të pandehurit të tjerë K.K., B.B., N.K. dhe R.T., transportojnë mallin e kontrabanduar në Prishtinë, Gj. dhe F.

Nga raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin K.K. të datës 29.01.2014, e pranuar në prokurori me datë 04.02.2014, rezulton se i pandehuri K.K. në periudhën kohore prej datës 01.12.2013 deri me data 23.12.2013, ka pasur komunikime me të pandehurit B.B., I.A., N.K., Q.K., B.R., Xh.R. Me datë 08.12.2013 në ora 10:13:35, K. komunikon me B.R. dhe K. i thotë “te Q. qe e kena marr, te Q. a o i joti” (kemi të blejmë me Xh.R. është cekur në raporte), ndërsa sipas vlerësimit të gjykatës i pandehuri Xh. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se personi me emrin Q. është vëllau tim, ndërsa personi me emrin B. e kamë kushëri, më pas B. “qashtu, Q. veç veç”. Të njëjtën ditë në ora 10:47:36, B. i thotë “aha e po hajde po t ‘priti te ...-ja”, në ora 11:27:28, B. i thotë K.së se është te ...-ja, K. “e po njeri kerr ka shku te pulat, unë po shkoi atje pra te ajo shpija atje”. Në ora 11:31:28, B. i thotë “mas qatina kerrit t ‘bardhë aaa, qe po une qe po vj”. Me datë 23.12.2013, janë dy komunikime mes të pandehurve K.K. dhe B.R., në ora 12:05:25, me ç’ rast bisedojnë dhe që të takohen për 3 minuta te ...-ja në Gj. dhe në ora 12:13:47, që të takohen në parkingut te ...-ja. Nga komunikime mes të pandehurve K. dhe B. gjykata gjen që të dy komunikoj në lidhje me kontrabandimin e mallit, dhe i pandehuri B. kërkon nga i pandehuri K. që malli të dërgohet te Q. Me datë 21.12.2013, në ora 22:43:52, komunikon mes pandehurve K. me Xh.R. dhe K. i thotë “aga Xh. a je n’shpi”, Xh. “po”, K. “ngo njani qe vjen i pari” dhe “mos t’marri vesh se çka kam unë”, Xh. “u kry”, K. “hajt veç shkarkoi edhe ec hajt”, Xh. “hajde u kry”, nga ky përgjim gjykata gjen se i pandehuri K. e njofton të pandehurin Xh. për dërgim të mallit, ndërsa se a është në njohuri i pandehuri Xh.ë se i pandehuri K. dhe të pandehurit tjerë merren me kontrabandimn e mallrave po ashtu gjatë vlerësimi të gjitha raporteve të përgjimeve, në as një raporte nuk ka kontakt komunikim mes të pandehurit Xh. me të pandehurit B.B., I.A., N.K., Q.K. dhe K.K., që porosit ndonjë mall nga të njëjtët, transporton apo kontrabandën mall, sipas vlerësimit malli i dërguar nga i pandehuri K. te i pandehuri Xh. është bërë me kërkesën e B.-kusherini i të pandehurit Xh.R.

Lexohet raporti i përgjimit ligjor i DHKO ndaj numrit të telefonit ..., për të pandehurin B.B. të datës 04.02.2014, nga transkriptet që janë bashkangjitur raportit të datës rezulton se i pandehuri B.B. në periudhën kohore prej datës 01.12.2013, deri me datë 23.12.2013, ka pasur shumë komunikime me të pandehurit të tjerë si dhe me persona të tjerë, gjykata gjen se nga këto prova vërtetohet se i pandehuri B. gjatë muajit dhjetor të vitit 2013, ka qenë shumë i përfshirë në kontrabandimin e mallrave dhe duke i dërguar ato në Prishtinë, Gj., F., K. dhe H. të E., ndërsa pas bastisjes me 23.12.2013, i pandehuri B. ka pasur kontakte me të pandehurit R.T. dhe Q.K., duke i njoftuar njëri tjetrin se çka ka ndodh, ku janë kapur të pandehurit K.K., I.A. etj, me këtë rast i pandehuri Q. disa herë i thotë të pandehurit B. që të thirr atë shoqin (pra H.K.), de ta pyet se çka ka ndodhur, i pandehuri B. i thotë se një herë ka tentuar me thirr më herët por ja ka ndal telefonin, gjithashtu i pandehuri B. e njofton të pandehurin N.K. se si kanë ndodhur gjërat dhe që mos të vjen me marr mall në H. te E., por ta lenë veturën dikun në F. dhe pastaj të vjen me një veturë tjetër.

Nga raporti i vëzhgimit i DHKO të datës, 30.12.2013, për intervalin kohor për datat 18.12.2013 dhe 23.12.2013 me fotografi, i cili është dërguar në prokurorie me datë 11.02.2014, në raportin

e vëzhgimit janë bashkangjitur edhe foto ku në F-1, shihet shtëpia e të pandehurit Xh.R., ku të pandehurit K.K., I.A., B.B. dhe K.K. kanë sjellë mall - duhan. F-2, vetura e K.K. e parkuar te shtëpia e lartcekur. F-3, K.K. duke e shkarkuar duhanin në atë shtëpi. F-6, në të njëjtin vend ka shkua edhe vetura e dytë të cilën e ka drejtuar i pandehuri K.K. dhe edhe nga kjo veturë është shkarkuar mall-duhan në atë vend. Në f-21, është vetura e K.K. në të cilën janë zënë 250 pako duhan me datë 23.12.2013, të destinuara për të pandehurin B.R., gjykata gjen se i pandehuri B. e ka porosit duhanin nga të pandehurit e cekur në këtë raporte, ndërsa sa i përket të pandehurit Xh. në as një raporte të përgjimeve nuk është i përfshirë në porosi e mallit, në transportin e mallit, vetëm që këto fotot dëshmojnë se e kanë dërguar mallin në oborrin e shtëpisë së tij, gjykata vlerëson se ky mall është dërguar sipas kërkesës së pandehurit B. Në F-24 dhe F-25 shihet duhani në fjalë. Në F-26, është vetura e të pandehurit K.K. në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë, me rastin e marrjes 250 kg duhan nga vetura e tij si dhe autobusi me targa e NP, ku ka qenë duke u shkarkua duhani.

Vlerësohet raporti informues i DHKO të datës 04.03.2014, për rastet ku janë marrë me kontrabandim të mallrave dhe janë zënë në flagranc nga zyrtaret doganor, për të pandehurit pranë Doganës së Kosovës: I.A., dy raste 2012- YE 278, 2012-YE-085, N.K. dy raste 2011-YE -337, 2012 - YE-075, B.B. 2011- YE – 278, malli ka qenë këpuc, tekstil, pleh artificial, ku të njëjtëve ju është shqiptuar gjoba, ku të njëjta vendime janë vlerësuar në detaje me lartë nga ana e gjykatës.

Vlerësohet Raporti i Ekspertizës nr. AKF - 2014-0001 të datës 31.01.2014, në bazë të vendimit për angazhimin e ekspertit PPS.nr.53/13, të datës 10.01.2014, Agjencia e Kosovës për Forenzikë – Laboratori për Ekzaminimin e Kompjuterëve, nr. AKF-2014-0001 me 31.01.2014, ka marr Raportin e Ekspertizës, për telefonat celular dhe Sim kartelat për të pandehurit: H.K., I.A., K.K., B.B., K. (Q.) K., K.K., N.K., T.C., B.S., B.R. dhe R.T. Nga ekzaminimi në fjalë rezulton se i pandehuri B.R. ka pas të regjistruar numrin e telefonit të I.A. dhe K.K., me të cilët ka pasur komunikime, gjykata vlerëson se i pandehuri B. është kushërini i të pandehurit Xh., andaj i pandehuri B. siç e vlerësuam edhe me lartë ka komunikuar me të pandehurit I.A. dhe K.K. ku ka porositur duhan dhe ju ka thënë te dërgoj te Q., ndërsa i pandehuri I.A. ka pasur numrat e telefonave të pandehurve: T.C., R.T., K.K., Q.K. B.B., K.K., N.K. dhe numrat e pronarëve të disa firmave, gjykata gjen se i pandehuri Imer nuk ka pas numrin e telefon të pandehurve H.K., B.S., S. B. siç pretendon prokuroria, ku sipas raporteve të përgjimeve i pandehuri K.K. i shkruan sms të pandehurit I.A., me përmbajtje “numrin e telefonit të pandehurit B.S. jepja këtij 50 euro”, gjykata vlerëson se në bazë të vlerësimit të raporteve të përgjimeve as një herë nuk kanë pasur kontakt telefonik mes veti të pandehurit I. dhe B., si dhe as kontakt në mesë të pandehurve I. dhe H., ndërsa i pandehuri K.K. me përjashtim të numrave të pandehurve të tjerë, ka pas të regjistruar në telefonin e tij me emër mbiemër numrin e H.K., gjykata vlerëson se nuk është as një pretendim i prokurori që i pandehuri K.K. ka pas komunikim përmes telefonit me të pandehurin H.K. po ashtu edhe gjatë vlerësimit të raporteve të përgjimeve nuk ka pasur komunikim në mes tyre, ndërsa tek i pandehuri K.K. figurojnë numrat e telefonave të pandehurve të tjerë por edhe numrat e pronarëve të firmave në F. Te i pandehuri N.K. ka poseduar numrat e të pandehurve të tjerë, si dhe të pandehurve Q.K., T.C. dhe R.T., ndërsa numri i firmës “...” ka qenë i regjistruar në telefonin e R., gjykata vlerëson raportin e ekspertizës dhe gjen se të pandehuri e lartcekur kanë

pas kontakte telefonike në vazhdimësi duke u bazuar në raportet e përgjimeve të vlerësuara me lart , me çka në vazhdimësi janë marr me kontrabandimin e mallrave.

Vlerësohen deklaratat e të pandehurve K.K. dhe B.B. të datës 20.11.2013, që i janë bashkangjitur kallëzimit penal të paraqitur nga Policia Kufitare Rajonin Lindje në K., nr. 2013-YE-270 të datës 22.11.2013, të njëjta deklaratat janë vlerësuar më lartë te mbrojtja e të pandehurve të njëjtë.

Vlerësohet i gjithë dokumentacioni për firmën “...” e të pandehurit N. L., duke përfshirë edhe transkriptet, gjithashtu nga transkriptet që janë bashkangjitur lëndës rezulton se të pandehurit B.B., komunikon me të pandehurin Q.K., i njëjti i thotë B. a e din se kush ka mall, B. i thotë e di se kush ka mall, ka F., B., H. te A. ka. Vlerësohet i gjithë dokumentacioni për firmën “...” e të pandehurit I.A., nga transkriptet që janë bashkangjitur lëndës rezulton se të pandehurit B.B., komunikon me të pandehurin R.T. , i njëjti i thotë B. mos të ka thirr naj kushë, B. i thotë se 6 paketa dhe tri janë kanë te “...” para dy ditësh, gjykata vlerëson se të pandehurit B. dhe R. kanë marr mall në firmat e lartcekura.

Vlerësohet shkresë nga Dogana e Kosovës -Sektori për Procedura dhe Këshilla, në përgjigje nr.07.1/1274/2014 të datës 02.05.2014, nga i cili rezulton se subjekti që merret me tregtimin e duhanit duhet të pajiset me licencë përkatëse nga MTI-ja për ushtrimin e veprimtarisë, që do të thotë se asnjë subjekt vendor apo i huaj nuk mund të tregtojë duhan apo produktet e tij pa u pajisur me licencën përkatëse. Ky mendim ka mbështetje sipas neneve 16,17 dhe 21 të Ligjit për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (Nr.04/L-041 të datës 21.10.2011) , pastaj sipas nenit 9 nënpar. 9.3 të Ligjit për Duhan (Nr.02/L-36 të datës 03.10.2005) si dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2013, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2013, për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për subjektet që merren me tregtinë e duhanit, të datës 11.06.2013. Nga kjo rezulton se për eksportim apo importimin e duhanit kërkohet leje e posaçme nga organi kompetent, gjykata vlerëson se të pandehurit T.C., R.T., K.K., Q.K., B.B., K.K., N.K. kanë kontrabanduar duhan në mënyrë ilegale pa leje të posaçme të organeve kompetente.

Vlerësohet raporti përmbledhës i hetimeve financiare i përpiluar nga SHFI-DHKO në Prishtinë, nr.2014-DHKO/SHIF-02-8/687 të datës 08.05.2014, rezulton se vlera e mallrave të kontrabanduar e cila është vërtetuar në bazë të transkripteve e komunikimeve telefonike mes të pandehurve, është 108,820.50 euro. Mirëpo, sipas konkludimit sasia e mallrave të kontrabanduar është më e madhe se vlera e cekur në këtë raport, ngase sipas SMS-ve ka sasi të mallit pa përcaktimin e vlerës.

Vlerësohet se sipas urdhëresës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, PPrKr.nr. 204/2013, të datës 20.03.2014, polici hetues pranë SHIF-DHKO, me datë 5.04.2014, ka përpiluar raportin përmbledhës i zbulimit i të dhënave financiare për të pandehurit: I.A., K.K., H.K., T.C., B. R., K. (Q.) K., B.S., R.T., B.B. dhe K.K., nga ky raport rezulton se nuk është zbuluar ndonjë parregullsi financiare nga të pandehurit e lartcekur.

Vlerësohen Raportet e Doganës së Kosovës-Zyra e drejtorit të përgjithshëm të datës 13.05.2014, të pranuar në prokurori me datë 14.05.2014, për të pandehurin A.K., R.T., lidhur me mallin që është gjetur në depon e dëshmitarit S. M., duhanin që është marr te ...-ja në Gj. dhe në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë si dhe mendimet për përcaktimin e vlerës doganore dhe kalkulimin e detyrimeve doganore. Nga raportet e Doganës së Kosovës - Zyra e drejtorit të përgjithshëm, të datës 13.05.2014, vërtetohet se vlera e mallit që është gjetur në depon e të pandehurit R.T. (36 palë mbathje) është 108.00 euro, kurse shmangia nga obligimi doganorë është 29.8 euro. Vlera e mallit e të pandehurit K.K. që është gjetur në depon e dëshmitarit S. M. (592 palë) është 1,480.40 euro, kurse shmangia nga obligimi doganor është 408.59 euro. Vlera e mallit (250 kg duhan) që është marr në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë nga i pandehuri K.K. është 800.00 euro, kurse shmangia nga obligimi doganor është 8,920.80 euro. E njëjta vlerë dhe shumë është përcaktuar edhe për të pandehurin K.K. lidhur me duhanin që është marr në Gj. te ... Nga dy mendimet për përcaktimin e vlerës doganore dhe kalkulimin e detyrimeve doganore nga Dogana e Kosovës, nr. 03.4.8 Nr. 354 dhe 03.4.8 Nr. 355, të datës 24.12.2013, rezulton se totali i detyrimeve për të pandehurit e lartcekur është për çdo person veç e veç 8,920.80 euro.

Vlerësohet vlera e mallit në bazë të transkripteve të pandehurve: I.A., K.K., B.B. etj, nga raportet e Doganës së Kosovës- Zyra e drejtorit të përgjithshëm, të datës 13.05.2014, Sa i përket vlerës së mallit në bazë të transkripteve e komunikimeve mes të pandehurve, vlera totale e mallit në këto kесе dhe thasëve është 108,820.50 euro (faqe 12 e raportit), kurse shmangia nga obligimi doganor është 30,034.45 euro. Në bazë të SMS-ve që janë siguruar të dhëna lidhur me 218 kесе me mall, ku nuk është cekur vlera e mallit, por në bazë të vlerës mesatare, vlera e mallit e këtyre keksëve është 48,396.00 euro, kurse shmangia nga obligimi doganor është 13,357.29 euro. Sa i përket SMS-ve në bazë të cilës janë siguruar të dhëna lidhur me duhanin refuz, vlera totale e këtij duhani sipas vlerësimit të Doganës së Kosovës është 3,712.00 euro (3.2 euro/kg), kurse shmangia nga obligimi doganor është 41,392.51 euro. Sipas SMS-ve, ku janë të cekur 100 boksa cigare, taksa e akcizës dhe TVSH është 696.00 euro. Sa i përket SMS-ve lidhur me një sasi të mallit - këpuca, vlera 4,920 palt kufë këpucëve është 14,760.00 euro, kurse shmangia nga obligimi doganor është 4,073.76 euro, ku gjykata në bazë të provave materiale të vlerësuara një nga një, gjen se të pandehurit e lartcekur nuk kanë kaluar mall përmes doganës me dokument të rrejshëm apo ngjashëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, pra të pandehurit e lartcekur mallrat në vazhdimësi i kanë kontrabanduar përmes vijës së gjelbër të kufirit në mënyrë ilegale në mes M. dhe K. dhe anasjelltas, andaj në mungesë të provave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi ligjor

Sa i përket lirimit nga akuza si në dispozitivin të këtij aktgjykimi për të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K., pas procedimit të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata vlerëson se në veprimet e të pandehurve të lartcekur nuk manifesto hen elementet qenësore të figurës së veprës penale se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishin për të kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Vështruar nga cilësimi juridik i veprës penale, gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 318 të KPRK-së, kjo vepër penale ekziston kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit (paragrafi 1 i nenit 318), nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon tridhjetëmijë (30.000) Euro, (paragrafi 3 i nenit 318). Në rastin konkret nuk jemi në përmbushje të asnjërit nga këto elemente qenësore të kësaj vepre penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës, dhe atë për arsyet si në vijim:

Të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K., ngarkohet në aktakuzë se me veprimet inkriminuese, "Ne periudhën kohore prej vitit 2011 deri me 23.12.2013, të pandehurit e lartcekur se bashku edhe me të pandehurit Q.K. dhe B.R. të cilët gjenden në arrati, me qëllim që vetes apo personit tjetër ti mundësojnë shmangien nga pagesa e tarifave doganore apo tarifave të tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, në periudhën kohore në fjale, duke kontrabanduar mallin e cekur në pikën I. të dispozitivit si "*pas marrëveshjes paraprake në bashkëkryerje janë marrë me kontrabandimin e mallrave duke kaluar vijën kufitare në mes M. dhe K. dhe anasjelltas e duke shmangur kontrollin doganor, ashtu që në mënyrë të vazhdueshme kane bartur mallra dhe atë veshmbathje dhe duhan, ndërsa për eksportim dhe importim të duhanit dhe cigareve sipas ligjit kërkohet leje e posaçme*", me rastin e kontrabandimit të mallit kane bërë Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore në vlerë prej rreth **112,915.64 Euro**".

Gjykata fillimisht vëren se duke u nisur nga përshkrimi faktik i veprimeve për të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C., dhe N.K., nuk jemi në kushtet e kryerjes së kësaj vepre penale, në rastin konkret lidhur me të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K., në që në bazë të provave material, raporteve të përgjimeve të vlerësuara më lartë të pandehurit e lartcekur pas marrëveshjes paraprake në bashkëkryerje janë marrë me kontrabandimin e mallrave duke kaluar vijën kufitare në mes M. dhe K. dhe anasjelltas e duke shmangur kontrollin doganor, ashtu që në mënyrë të vazhdueshme kane bartur mallra dhe atë veshmbathje dhe duhan, ndërsa për eksportim dhe importim të duhanit dhe cigareve sipas ligjit kërkohet leje e posaçme, e me marrëveshje paraprake kane shitur veshë mbathje, duhan -cigare të kontrabanduar në firma të ndryshme në F., K., H. te E., P., Gj. e gjetiu, si dhe personave të ndryshëm, kurse firmave të pandehurve N.G. "...", G.Sh. "...", dhe A.K. "...", në F., vetëm mbathje, gjatë kontrabandimit të mallit nga të pandehurit I.A., Q.K., K.K. e T.C., i pandehuri R.T., e përcjell rrugën, mundëson shfrytëzimin e objektit në oborrin e shtëpisë se tij si depo për vendosjen e mallit të kontrabanduar dhe ofron logjistiken e veturave gjate transportimit të mallit, të pandehurit B.B., N.K. dhe K.K., kanë bartur mallin e kontrabanduar sipas kërkesës së K.K. dhe I.A., kane dërguar mallin në depon e R.T. apo në destinimin e caktuar, të pandehurit K.K. dhe I.A. me vetura të tyre mallin e destinuar për M. e kane dërguar te shtëpia e të pandehurit T.C., i cili ka transportuar mall me kuaj përmes malit nga M. në K. dhe anasjelltas, kurse vete i pandehuri K.K., përmes malit ka

transportuar mall me kuaj, ndërsa me datën 23.12.2013, rreth orës 12:00 ne Gj., në afërsi të objektit ..., të pandehurit K.K. dhe I.A., janë kapur në flagrancë duke ia shitur duhanin e kontrabanduar të pandehurit B.R., i cili gjendet ne arrati, në sasi prej 250kg, në vlerë 800.00 Euro, ndërsa në depon e shtëpisë së dëshmitarit S.M. në F., gjate kontrollit të datës 23.12.2013, janë gjetur mbathje në sasi prej 529 palë e destinuar për shitje ne vlere prej 1,480.00 euro, kurse të njëjtën dite gjate kontrollit te shtëpisë se të pandehurit R.T. dhe objektet përcjellëse, janë gjetur mbathje- këpuca 36 palë pa dokumentacion e destinuar për shitje ne vlere prej 108,00 euro, andaj duke bërë vlerësimin e veprës penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par 2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 317 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që duke kaluar vijën kufitare bartë mallra dhe shmang kontrollin doganor, ose kushdo që duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallrave dhe kalon vijën kufitare, (paragrafi 1 i nenit 317) si dhe kushdo që pa leje përkatëse, shmang kontrollin doganor dhe kalon vijën kufitare duke bartur mallrat, eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar, i kufizuar apo kërkon leje të posaçme nga organi kompetent, (paragrafi 2 i nenit 317), për të cilën veprë penale të pandehurit I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K. janë shpallur fajtor në gjykimin e më hershum, andaj gjykata gjen se nga veprimet e të pandehurve I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K., të vlerësuar më lartë nuk manifestohen elementet qenësore të figurës së veprës penale se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishin për të kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke pas parasysh se të pandehurit e lartcekur në as një rrethanë nuk kanë bart mallra që duke ju shmangien detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera te mallit siç pretendon prokuroria, pasi që të pandehurit e lartcekur mallrat në vazhdimësi i kanë kontrabanduar përmes vijës së gjelbër të kufirit, në mënyrë ilegale për ti kaluar në mes M. dhe K. dhe anasjelltas si veshmbathjet, duhan etj, ku në bazë të provave materiale të vlerësuar një nga një, asnjëherë të pandehurit e lartcekur nuk kanë kaluar mall përmes doganës me dokument të rrejshëm apo ngjashëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera te mallit, pra të pandehurit e lartcekur mallrat në vazhdimësi i kanë kontrabanduar përmes vijës së gjelbër të kufirit në mënyrë ilegale, andaj gjykata gjen se pas administrimit të gjithave provave në këtë çështje penale nuk është vërtetuar se të pandehurin I.A., K.K., B.B., R.T., T.C. dhe N.K., në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryer veprën penale Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, që ngarkohen me aktakuzë, gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorisë për të pandehurit e lartcekur, andaj në mungesë të provave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale, u vendos bazuar në nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 par.1 nen par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special

PS.nr.42/23, datë 25.10.2023

Numri i lëndës: 2019:081233
Datë: 03.11.2023
Numri i dokumentit: 04871717

Zyrtare Ligjore
Rilinda K.

Kryetarja e trupit gjykues – gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.